

90-VJETORI I LINDJES SË KADARESE

Me botuesin e gazetës ExLibris, Bujar Hudhrin, u takuam në konferencën kushtuar shkrimtarit Martin Camaj, në vitin e 100-vjetorit të lindjes së tij. “Çfarë ke në atë dosje?” - më pyeti miku im. “Ah, çfarë rastësie. Nga një ditar shumëvjeçar që kam mbajtur, kam veçuar copëza shënimesh për Ismail Kadarenë”. Ai më propozoi që t’i botonte në ExLibris. Ja ku janë...

Copëza shënimesh
për Kadarenë

Nga Namik Dokle

BUSTINA E KAMOMILIT
Félicette, Shqipëria,
Davosi dhe një portokall
Andreas Dushi (fq. 16)

SHËNIME MBI LIBRAT

Shënime për romanin “Klasiku V” i Ndue Dedajt
DËSHMI LETRARE E NJË
KOHE TRAGJIKOMIKE
Nga Frano Kulli (fq. 7)

“Klithma”, i autores Alketa Gashi Fazliu
“Klithma”, si dëshmi e
krimeve të pagjykuara
Nga Aleksandër Çipa (fq. 9)

“Poema e mungesës” e poetes Rita Petro, Albas
Vazhdimësia e imazheve pas
leximit të “Poemës së mungesës”
Nga Klevisa Bardeli (fq. 8)

Reflektime mbi “Mund të jetë si në fillimet e kohëve”
Poezia që na kujton fillimin:
Ndue Ukaj dhe koha e parë
Nga Rei F. Hodo (fq. 10)

Luçia Zorba Kalaj, “Veç drita s’paska mbarim”
Fryma profetike dhe
testamenti letrar nga Zef
Zorba tek Zorbnesha e re”
Nga Eduart Bardhi (fq. 11)

“Historia e novelës grafike dhe karikaturës
shqiptare”, i autorit Dr. Oltsen Gripshi
Studimor, i veçantë
dhe i domosdoshëm (fq. 12)
Nga Suzana Varvarica Kuka

PORTRETI I KADARESË
DHURATË E
MAESTRO KODRËS


Nga Visar Zhiti

Ja, një vizatim që ka kaluar nga një dorë në tjetrën, që sigurisht mban brenda vetes kohë dhe dëshmon, gati flet.... Është një skicë e Maestro Ibrahim Kodrës, portreti i shkrimtarit tonë Ismail Kadare...

(fq. 6)

Lea Ypi, “Të poshtëruar”, Duda
Këndvështrim ngasës
ndaj rrëfimit dhe
interpretimit të historisë
Nga Ali Aliu (fq. 15)

“Nuk ka asgjë
si mërzia që të të shtyjë
të shkruash”:
Një intervistë e rrallë
me Agatha Christie-n
e pakapshme
Greg McKevitt (fq. 22)



BIBLIOTEKË

- Hivzi Sylejmani (fq. 12)
Një gjeth e një njeri
Besa Kalaja (fq. 14)
Kthehet gjithmonë
Sylvia Plath (fq. 16)
Tulipanët
Përktheu: Qerim Raqi
Roland Gjoza (fq. 17)
Overtime
Konstantin Paustovski (fq. 18)
Kuzhinieri i moshuar
Përktheu nga rusishtja: Kosta Nake
Arben Meksi (fq. 19)
Karikatura e së shtunës

Veprat letrare në rrugën
e vështirë të lexuesit
Nga Granit Zela (fq. 14)

MBRETI? KU ËSHTË AI?

Ese nga Rudolf Marku (fq. 20)

Një profil i fotografit të njohur shqiptaro-kroat, Luka Mjeda
Mjeda i Zagrebit: “E bardha
dhe e zeza mbeten të bukura”
Përgatiti: Durim Taçi (fq. 21)

7 nëntor 1971

I tregova kryeredaktorit Minella Dalani një anekdotë për poezinë e sotme shqipe:

“Poezia e sotme shqipe ka tre poetë në zë. I. K., D.A dhe L.L.S. Kadareja ka hypur në një majë mali dhe rrुकullis gurë metaforash. Atë vetë nuk e sheh njeri dhe gurët s’mund t’i dallosh se ç’lloj janë... Veç zhurmën e rrुकullisjes e dëgjon kushdo. Dritëroi ka qëndruar në një brazdë ugari dhe po dredh një cigare me një fshatar. Duhani është i fortë dhe aroma e tij e mirë përzihet me erën e tokës. Llazar Siliqi ka hypur në ballkonin e një shtëpie dykatëshe dhe mban fjalime.”

Kryeredaktori qeshi dhe pastaj tha:

-I shpikni vetë ju, dhe pastaj ua vishni të tjerëve.

Kishte të drejtë.

19 maj 1973

Sot, në uzinën “Traktori”, u bë diskutimi për romanin e Ismail Kadaresë *“Dimri i vetmisë së madhe”*. Arsyeja pse u bë atje, me punëtorë dhe intelektualë të uzinës, është se aty Ismaili po bën stazhin e pranimit në Partinë e Punës. Romanin e kisha lexuar që në procesin e shtypjes, në boca. Por tani e rilexova librin e publikuar. Ndërkohë që lexoja romanin, lexoja edhe kritikën që botoheshin në shtyp; në “Zëri i Rinisë”, “Drita” etj. Duke e lexuar, anash bëra shumë shënime, në formën e replikave me ato kritika që kisha lexuar në gazeta, apo edhe ato të bisedave të shumta që bëheshin nëpër mjedise të ndryshme.

Që në krye të romanit kam shkruar:

“Romani shqiptar me densitetin më të madh.”

Dhe ja disa nga anëshënimet:

“Romanin po e lexoj përsëdyti dhe pas dy ditësh do të shkoj në një diskutim në uzinën “Traktori”. Ç’do të thonë punëtorët?...”

“Deri këtu asgjë shqetësuese. Asnjë arsye “për t’u revoltuar” Më tej?!”

“A nuk është ajo Shqipëria e vaditur me gjak?...”

“Pikëpyetje: 1. Paralelizmi midis filmit të plazhit të Besnikut dhe filmit të Enver Hoxhës.

2. Përse, sipas Xanit, Enveri ka një mërzi të madhe? “As pakënaqësi e prodhimit të keq (kujto grurin) as shtrembërime udhëzimi e bile as shkelje ligjëshmërie”

3. Pjesë e bukur, por më kujton diçka nga N. Ostrovski, “kur postjeri i vjetër shënon telegramin e vdekjes së Leninit.”

“A mund të ketë diçka fyese këtu, sidomos në fjalën e fundit?...” (ministër... istër... min... stër...)

“A është gruri gjëja kryesore, apo shfaqje konkrete e luftës ideo-politike?” “Me grurin armiqë janë munduar të na merrnin gjithçka tjetër. Ne u kemi dhënë përgjigjen e Sulos.”

“Gjithnjë ka njerëz që presin “kohë të vështira” (Që ata të rivlerësohen.)

“A mundet të mos ketë diçka simbolike në aparatën e kobaltit, në “Kronikën” e tij? Po çfarë pikërisht? Vetë Kadareja, kur e pyeta në një takim me ushtarët në Zall-Herr, tha: “kam dashur të them se në një spital është një aparat kobalti që shëron njerëz”. Vetëm kaq?!

“Me sa duket çdo gjë po qartësohet me Benin. Kur koha të thërrasë, edhe ai do të jetë në gjendje të bëhet si Kristaqi etj.etj.”

“Larg çdo skematizmi, por pa kapërcyer sensin e masës.”

Disa anëshënimë janë veç me pak fjalë:

“Bukur!”

“E mrekullueshme!”

“E thjeshtë dhe e madhërishte atmosfera”

Më tej:

“A mund të thuash se bëhet fjalë vetëm për grurë? Aspak jo! Fjala është për të fluturuar. Idiotët kot revoltohen me Ismailin! Ai di ç’thotë.”

Dhe aty ku Ismaili shkruan “E megjithatë s’është puna e grurit...” unë, duke polemizuar me “ca ideologë” që dërdëllonin për “polemika ideologjike e jo për grurë”, kam shënuar (faqe 114) “Epo ç’doni tjetër?! Nuk ka më shqip!”

Diku-diku:

“Ç’doni më tepër?”

“Ja, e gjitha!”

“Akoma më qartë!”

“Gjithçka është e qartë. Madje shumë e qartë!” “Deri tani... Ndoshta tani fillon dimri i romanit?!”

“Zgjimi i ëndrrave të botës së vjetër, i ëndrrës së përjetëshme të përmbykses dhe i pamundësisë së realizimit të kësaj ëndërre jepet shumë saktë. Ismail Kadareja hyn pikërisht në atë botë përplasjesh.”

Aty-këtu kam shënuar:

“E natyrshme.”

“Të nervozon! Nuk gjen mënyrë tjetër?!”

“Qerrata!” (Janë ato pasazhe ku Kadareja u jep frazave dykuptimësi.)

“Ç’do më shumë!”



NAMIK DOKLE

Copëza shënimesh për Kadarenë

Me botuesin e gazetës ExLibris, Bujar Hudhri, u takuam në konferencën kushtuar shkrimtarit Martin Camaj, në vitin e 100-vjetorit të lindjes së tij. “Çfarë ke në atë dosje?” - më pyeti miku im. “Ah, çfarë rastësie. Nga një ditar shumëvjeçar që kam mbajtur, kam veçuar copëza shënimesh për Ismail Kadarenë. Ai më propozoi që t’i botonte në ExLibris.

Ja ku janë...

“Bukur!”

I mbushur me këto, sot vajta në uzinën “Traktori”. Ismaili kishte pyetur Shpresa Kamanin: “A do të çoni njeri nga gazeta?” Dhe erdhi Shpresa te zyra ku punoja unë.

“E lexove romanin?” - më pyeti.

“Po.”

“Të pëlqeu?”

“Shumë.”

“Po atëherë pse rri? Pse nuk e mbron Ismailin?”

“Unë? Po si ta mbroj?”

“Shko në uzinën “Traktori”. Dëgjo punëtorët dhe shkruaj.”

“Po a ma botojnë?”

“Do ta botojmë.”

Dhe pastaj i kishte thënë Ismailit: “Do të dërgojmë një djalë të mirë që e do romanin e të do edhe ty.”

Këto m’i tregonte vetë Shpresa. *Ajo më tregonte se ato ditë Ismailit i bëheshin dhjetra telefonata e letra anonime me sharje e kërcënime. “A duhet të veprohet kështu me shkrimtarin tonë më të mirë?”*

Sulmet e ashpra kundër Ismailit nuk bëheshin vetëm në gazeta, por edhe në zyra të mëdha e të vogla. Nuk do ta harroj zërin dhe lëvizjen e kokës me inat bualli të një kolegu që më tha: *“U thye më në fund edhe qypi i Kadaresë!”*

Në këtë atmosferë dramatike unë shkova në uzinën “Traktori”. Takova Ismailin. Me të ishin Moikom Zeqo, Thanas Dino e një tjetër që nuk e njihja.

Diskutimi vazhdoi gjatë. Kur mbaroi, Ismaili më pyeti:

“Çfarë do të shkruash?”

“Do të pasqyroj me vërtetësi ato që u thanë, folën saktë dhe me shumë dashuri, më duket

mua, apo jo?” - i thashë.

“Po, po,” - tha ai dhe më kërkoi që fundin e shkrimit, lidhur me fjalën e tij përmbyllëse, ta bënte ai vetë. Ishte kënaqësi e madhe për mua, pa më shkuar në mendje se çfarë do të ndodhte më tej. Të nesërmen, kur po e mbaroja shkrimin, ai më dërgoi katër fletë e pak gjysmë A-4, të cilat i përfshiva në fundin e shkrimit.

Por peripecitë filluan të nesërmen, pasi e mbarova shkrimin. Duke shfrytëzuar mendimet më të mira të punëtorëve unë e mbroja romanin në aspektin themelor; në temën e tij qëndrore. Natyrisht edhe vërejtje kishte. Në atmosferën e atëherëshme rreth Ismailit, shkrimi im ishte nga më të mirët për romanin. Shpresa e pëlqeu. Po ashtu edhe Ibrahim (Ne të tre ishim adhuresit më të flaktë të Ismailit në redaksinë e gazetës “Puna”). Minella bëri ca shkurtime, ca rumbullakosje. Dhe kur unë prisja që shkrimi të nisej për në shtypshkronjë, pashë Minellën që zbriti në katin e tretë. U mblodh tërë Sekretariati i KQ të BPSH rreth shkrimit tim. Dhe vendosën: *të mos botohet!* Nga sa dëgjoja pëshpëritjet, Tonin Jakova, jo vetëm që kishte folur kundër romanit, por qe hedhur edhe kundër shkrimit e kundër meje. Pashë tërbimin e burokracisë kundër Ismail Kadaresë, i cili shkruante kundër vampirëve burokratë të pushtetit.

Ç’do bëhej me shkrimin?

Nuk e di se nga erdhi porosia: të çohet për botim në gazetën “Drita”. Kryeredaktor ishte Duro Mustafaj. Shkova në Lidhjen e Shkrimtarëve, ku ishin zyrat e gazetës “Drita”. Atje më priste Ismaili. E lexoi shkrimin dhe i pëlqeu. Ia çova Duros.

-Do ta botojmë me firmën tënde, - më tha ai.

-Porosia është ta botoni pa firmën time, - i thashë.

-Jo, do ta botojmë me firmë.

-Aq më mirë për mua, - i thashë. - Por me firmën time do të botohet pa i hequr e pa i shtuar asgjë nga ato që kam shkruar unë.

E lexoi.

-Kështu nuk e botoj, - tha Durua.

-Pse?

-Po ky është kundër artikullit që kemi botuar ne për romanin.

-Pastaj?

-Si, do t’i kthehem vetes unë?!

-Unë s’pranoj asnjë ndryshim, asnjë shkurtim dhe asnjë shtesë.

Durua mori Pipi Mitrojorgjin, Shef i sektorit të shtypit në KQ të Partisë. Ia shpjegoi mosmarrëveshjet tona. Më foli edhe mua, me ton mirëkuptues.

-Po të dojë Durua ta botojë siç kërkon ai, le t’i vejë emrin e tij. Unë firmos për ato që shkruaj unë, - i thashë shefit të shtypit në Komitetin Qendror.

Erdhi edhe Ismaili në zyrën e Duros.

-Pse nuk e botoni shkrimin, siç është? - i tha Duros... Ai nuk iu përgjigj!

E lashë aty shkrimin dhe ika. Pipi tha: “Ta shikojmë”. Por shkrimi nuk u botua.

-E ke thënë bukur në roman, - i thashë Ismailit - Çdo gjë madhështore lind me dhëmbje.

Atmosfera kundër Ismailit u ashpërsua. Telefonatat vazhdonin. Zilja e derës binte. Sharje. Fërkime ziliqare të duarve. Deri sa një ditë foli shoku Enver në Elbasan. “Romani, në thelb, qëndron!”

Armiqtë e letërsisë së vërtetë u rrudhën. Romani i Ismailit nuk qe libër i vitrinave, por barrikadë lufte për çdo gjë njerëzore, kundër dhjamjes së burokratëve, kundër trajtimit të Shqipërisë si një provincë perandorie, kundër gjeneralëve që kërkonin t’ia hipnin në zverk popullit. Prandaj ata e urrenin Ismailin. Ndjenin tërmetin si minjtë e fushës.

Fundin e shkrimit tim “...Në takim foli edhe shkrimtari Ismail Kadare... etj.” e formuloi vetë Ismaili, ku ai ka dhënë, në esencë, tërë qëndrimin e tij për romanin e vet dhe kritikën që i bëhej atij. Një qëndrim i zgjuar e dinjitoz. Do të vazhdoj t’i ruaj ato fletë sepse i konsideroj me vlerë të veçantë.

Ja si e mbyllte Ismaili “shkrimin tim”:

“Në fund e mori fjalën shkrimtari Ismail Kadare. Ai falenderoi punëtorët, teknikët dhe inxhinierët e uzinës për organizimin e këtij takimi, i cili u bë në një atmosferë kaq të gjallë dhe që ishte aq i vlefshëm për të. Ai falenderoi gjithashtu diskutantët për vlerësimin që i bënë librit të tij si dhe për ato kërkesa dhe sugjerime që parashtruan ata, në mënyrë që ky libër ta lozë edhe më mirë rolin e tij. Autori i romanit tha se për të kanë qenë gjithmonë të dobishme kontaktet, se disa herë nga këto kontakte shkrimtari mund të përfitojë po aq, në mos më tepër, se nga kritika letrare profesioniste. Ai tha se për të, ashtu si për shumicën e shkrimtarëve, rishikimi i veprës pas botimit është një proces normal pune dhe këtë gjë ai e ka bërë me shumicën e veprave të tij. Është e natyrshme, tha ai, që për një vepër shumëplanëshe dhe komplekse, si romani për të cilin porsa diskutuam, ka gjithmonë vend për të parë diçka dhe për të sheshuar diçka.

Ai tha pastaj se ishte dakord me shumicën e diskutimeve që thanë se nuk është e nevojshme që klasa punëtorë të zinte një linjë të veçantë në roman, sepse në fund të fundit e gjithë kjo luftë që bënte partia, bëhej pikërisht për të mbrojtur interesat e klasës. Nga ana tjetër romani përshkruan vetëm fillimin e bllokadës për të cilën do të shkruhen e duhet të shkruhen vepra të tjera ku të tregohet se si e mbajtën peshën konkretisht klasa punëtorë apo fshatarësia, sipas detyrës që mund t’i vejë vetes çdo shkrimtar.

Megjithatë, - tha autori i romanit, - në libër ka mundësi të theksohet më tepër prania e klasës, brenda konstruktit të tanishëm të veprës. Ai tha gjithashtu se do të rishikojë me kujdes ato momente në roman ku mund të ndihet një farë rënie e tonit epik-madhështor (p.sh. linja e të rinjve, apo ndonjë moment tjetër). Ai tha se këto do të jenë retushime apo plotësime që do të bëhen brenda strukturës ekzistuese të veprës, strukturë të cilën ai nuk ka ndërmend ta ndryshojë.

Shkrimtari tha pastaj se ishte një kënaqësi e vërtetë të merrte pjesë në një takim të tillë, ku ndihej menjëherë jo vetëm pjekuria ideo-estetike e punëtorëve, teknikëve dhe inxhinjerëve të uzinës, por edhe një shije shumë e mirë artistike.

Në fund të takimit përfaqësuesi i komitetit të Bashkimeve Profesionale të uzinës e falenderoi autorin në emër të punonjësve duke

i uruar suksese të mëtejshme në punën letrare.” S’ke çfarë të shtosh. Të tëra i tha qartë.

9 shkurt 1985

Disa herë është folur te ne për disa shkrimtarë që pak merren me ndërtimin e socializmit dhe shkruajnë për “antikitetin”. Madje Ismail Kadareja iu kundërvu edhe vetë plenumit të Shkrimtarëve, kur novela e parë që botoi pas këtij plenumi (ku u kritikua për mostrajtimin sa duhet të temës aktuale) ishte një novelë për dy shkencëtarë që vijnë të studjojnë legjendat tona në një mjedis krejt pa kulturë. Po ku lindën pra këto kryevepra? Aty, madje, Kadareja e quan Shqipërinë “vendi i fundit” ose “i vetëm” homerik. Mos do të thotë se Shqipëria është vendi i fundit, ose “i vetëm” socialist? Gjynah mos bëfsha, por hajde merre vesh gjuhën e Kadaresë. Hajde merre vesh se çfarë përfytyron ai me *“Pallatin e Ëndrrave”* të Stambollit që realisht kurrë nuk ka ekzistuar. Për çfarë e shpiku pra këtë pallat?! Nuk është vështirë të kuptohet. Unë njoh vetëm një mjedis si ai që përshkruan Ismaili.

Koha do ta tregojë qartë këtë.

24 mars 1985

Në revistën “Nëntori” (Nr.1) lexova novelën e Ismailit *“Nata me hënë”*. Pas kaq kohe i penguar, nxorri diçka në dritë (Shkoi e botoi edhe një tregim në revistën “10 Korriku” apo “Në shërbim të popullit” për të cilin thonë se ia ka veshur Sabri Godos). Pra, *“Nata me hënë”* pas një heshtjeje të gjatë – me dy romane që nuk ia botojnë (!!!) E ç’është kjo natë me hënë? Natë e Ismail Kadaresë, ndoshta. Shkruar bukur. Siç mund të shkruajë ai. Diku, në mjedisin e një ndërmarrjeje, një furtunë thashethemesh rrethon një vajzë të ndershme. Në vorbullën e ngjarjes përfsihien të gjithë, përveç drejtorit. Dhe puna arrin aq keq saqë vajzën e detyrojnë të kërkojë te mjeku një dëshmi virgjërie. (Të kujton edhe vezën e Shën Mërisë ose Shën Marianës – se Mariana është heroina e Kadaresë.) Madje ajo e merr atë dëshmi dhe pastaj e gris. Këtë Kadareja e konsideron si kulmin e emancipimit.

Për kë është ky kulm?! Mariana dhe të tjerët. Ajo nuk përfill asgjë. As ata që e donin figurën e saj të pastër. Ç’janë këta që e çuan Marianën deri te mjeku i “virgjërisë”?! Kaq e pamundur është që një vajzë të afirmojë figurën e vet, por u dashka edhe *dëshmia e Shën Mërisë?! Që* edhe mund të ndodh kështu në një apo njëqind raste, s’ka dyshim. Por pse merret Kadareja me këtë të vërtetë jetësore?! Është një kohë e humbur të merresh me novelën e Kadaresë, si të tillë. Me siguri, ka diçka tjetër. Pas çdo gjëje që shkruan Kadareja unë shtroj pyetjen: Ç’don të thotë me këtë? Çfarë ka menduar pas kësaj perdeje që na hedh në skenë? Mos e ka shkruar për “virgjërinë” e vetvetes në letërsi?!

Një sinjal u dha një herë: Ç’është *“Pallati i ëndrrave”* që krijoi Kadareja me fantazinë e tij? Cili është ky popull që rropatet me ëndrra?

Mandej merret me ata dy homerikët që vijnë në Shqipëri, në një mjedis injorantësh, të cilin e quajnë “vendi i vetëm ku jeton ende eposi homerik”, por që s’ka pse mos të përkthehet si “vendi i vetëm ku jeton ende socializmi” dhe ç’do të bëhet më tej?! Vjen pastaj romani i pabotuar “Gjakftohtësia” ku thonë (unë nuk e kam lexuar) se me mjeshtri damkosen politikat kineze. Po pse nuk botohet romani? Sepse shumë gjëra tingellojnë jo për Kinën, po për vetë Shqipërinë. Merret me turqit, merret me kinezët troket në një qiell me pluhur. Tani vijmë te *Nata me hënë*. Tërë kjo periudhë ka kaluar për Kadarenë pa botuar ndonjë gjë serioze. Nuk e kanë lënë. Aq më tepër që në Plenumin e Lidhjes para dy vjetësh u kritikua me emër dhe rreptë, por edhe pa emër nga shoku Ramiz Alia. Pra, gjatë këtyre dy-tri vjetëve krijimtaria e Kadaresë po përjeton një farë krize. Rreth tij është endur një mjegull. Pse nuk shkruan? Pse kërkon vendstrehim në temën e së kaluarës? Pse ky apo ai roman nuk u botua? Pse barrë me pikëpyetje mbi shpinën e shkrimtarit! Atëherë ç’duhet? Një dëshmi virgjërie?! Qofsha unë i gabuar, por novela “Natë me hënë” nuk është gjë tjetër veçse një përpjekje për të mbrojtur vetveten, për të ngushlluar vetveten, se ndryshe asqë do t’i shkonte në mend Kadaresë të merrej me një Marianë. Dhe thelbi: Mariana gjatë tërë shtjellimit të ngjarjeve akuzuese për figurën e saj morale, manifeston një mospërfillje të dukshme ndaj mjedisit, madje edhe ndaj atyre tre-katër vetëve që e duan. Mospërfillës ndaj kësaj shoqërie më shumë është Kadareja se sa Mariana e tij.

Së fundi: Disa herë shtrohet pyetja: Pse Ismaili merret pak me temën e ditës? Duke lexuar një studim të bukur e dinjitoz të Rexhep Qoses për romantizmin e Rilindjes sonë, hasa në një mendim shumë interesant të studjuesit

Arnold Hanzer, i cili thotë: *“Historia bëhet vendstrehim i të gjithë elementëve shoqërorë, ekzistenca intelektuale dhe materiale e të cilëve është e rrezikuar dhe të cilët janë në zënkë me kohën e vet; para sëgjithash vendstrehim i inteligjencës që tani ndjen se i janë rrënuar shpresat, se është e privuar të drejtash të veta jo vetëm në Gjermani, por edhe në vendet e Europës Perëndimore.”*Natyrisht ky mendim i sociologut gjerman është tërësisht për romantikët, por ai ta çon mendjen te Kadareja.

23 tetor 1987

Sot qe dita e dytë e Kongresit të Rinisë. Dita e parë ishte shumë e mirë. Sot ra disi niveli. Por një ngjarje tjetër hyri si pykë dhe trazoi gazetarët dhe emisionet tona të informacionit. Sot erdhi për vizitë ministri i jashtëm gjermano-perëndimor Hans Ditrhi Gensher. Erdhi rreth orës 9-9³⁰. Pa vendin ku do të ndërtohet ambasada e tyre, bëri bisedime me Reiz Malilen, e priti kryeministri dhe në fund bisedoi e hëngri drekë edhe me shokun Ramiz Alia. Të tëra këto deri në orën katër pa dhjetë. Në katër pa dhjetë bëri një konferencë të përbashkët shtypi me gazetarë gjermanë e shqiptarë. Zgjati rreth 20 minuta. Dhe fill e në aeroport për të ikur brenda ditës përsëri në Gjermani.

Të bën përshtypje një gjë: s’ka kaluar ende një muaj nga lidhja e marrëdhënieve diplomatike dhe ai erdhi në Shqipëri, në një kohë kur ka shtete me të cilat kemi 40 vjet marrëdhënie dhe akoma ndonjë ministër të jashtëm s’ua kemi parë. Duket që edhe në diplomaci e politikë gjemanët janë njerëz praktik, të punës, të qartë në synimet e tyre. Bisedimet zgjatën 12 vjet. Dhe tani, siç na deklaroi Gensher në konferencën e shtypit, duam të fitojmë kohën e humbur.

Në Konferencën me Gensherin ishte edhe Ismail Kadare. Ç’do të shkruajë vallë?

Në një pushim të Kongresit të Rinisë piva kafe me të. I tregova për çka më pat thënë gazetari Eleriaga i “El Paisit” të Madridit. Pastaj i tregova për një faqe dorëshkrim të tij për “Dimrin e madh” që e ruaj që prej 15-vjetësh. Qeshi. Më bëri përshtypje një mendim i tij për pinjollët e emigracionit tonë politik e ekonomik. Shumëve prej tyre u janë zgjuar lidhjet me kombin dhe dëshirojnë t’i forcojnë pa ndonjë synim politik të mbrapshtë. Ndërkohë janë njerëz me pakicë në fusha të ndryshme. Duhet një qëndrim i ri ndaj tyre, më dialektik – tha ai. Po deri ku duhet të shkojë ky qëndrim i ri dialektik?!

Në bisedë, nuk e di në ç’rrethanë, përdori një shprehje shumë interesante: “luftë influencash”. Më duket se e kishte fjalën për influencat pro dhe antishqiptare në shtypin e huaj. Aty këtu po duket se po fitojnë influencat pro-shqiptare. Pararendës është shtypi gjerman.

Tani sapo u dha lajmi për Gensherin. Vetëm mbërritja në aeroport. Asgjë tjetër, megjithëse kanë kaluar rreth 8 orë që nga mbërritja e tij. Ja sa keq punojmë, sa avash ecim.

25 nëntor 1987


Bëmë një takim me Ismail Kadarenë në Këshillin e Përgjithshëm të BPSH. Foli për letërsinë dhe mjaft probleme shqetësuese sociale. Ndërsa fliste, unë mendoja: “Letërsia jonë është një mozaik, që ka në mes një gur të çmuar – Ismail Kadarenë”

26 prill 1988

Kisha shkuar sot në Ministrinë e Jashtme për të takuar Vangjel Mitën, një shok të gazetarisë, që më jep ndonjë revistë në spanjisht. Në korridor takova Ismail Kadarenë. Bashkë me Andon B. (funksionar në Ministri, me të cilin njihem që në zbor). Po shkonin te Sokrat Plaka, “për të marrë udhëzimet”. Ismaili më foli me përzemërsi. Kishte veshur një pardesy që i rrinte e madhe. Sepse m’u duk pak si i drojtur. Njeriu që ka sunduar botën letrare, që Franca mendjemadhe i bie në këmbë dhe çmendet pas 12 librave të tij që ka botuar, që Amerika po i boton tërë veprën me reflektimin *“Si është e mundur që ky shkrimtar të na ketë kaluar kaq kohë pa u vënë re?!”*, njeriu ynë i shquar i letrave që praktikisht lexohet në tërë botën, përveç B.Sovjetik; ky shkrimtar i madh pra, sepse m’u duk i ndrojtur në korridoret e Ministrisë së Jashtme. Po. Që të shkojë atje ku e thërrasin botuesit e veprave të tij, duhet të kalojë patjetër nga këto korridore.

Sot Ismaili po merrte, mesa duket, dokumentet e nevojshme për në Portugali. Presidenti Soarez e ka ftuar bashkë me 70 shkrimtarë të tjerë më të njohur të Evropës, Brazilit, Amerikës dhe B.S. për takime e turizëm. Tanimë ai është një personalitet botëror. (Le t’i heqim kapelen të gjithë!)

Sot m’u kujtua episodi kur Sabri Godua



botoi “Ali Pashë Tepelenën”. Po hynte në “Dajti” bashkë me Ismailin (Atëherë qenë në orë të mira me njëri-tjetrin e më vonë kushedi pse u prishën dhe Ismaili shkroi një novelë diskredituese për Godon e shkretë). Duke hyrë në “Dajti” takuan Shefqet Peçin. Ai takoi me përzemërsi Sabriun, e uroi për “Ali Pashën” etj.etj., ndërsa Ismailit i dha vetëm një gjysmë dore. Kur u ndanë, Sabriu, “për mirësjellje”, i tha Ismailit: “Mos ja verë re. Është nën përshtypjet e Ali Pashës, prandaj u soll ftohtë me ty.” Hidhur, por plot zgjuarsi, Ismaili i tha: “Ta kam falur Shefqetin me gjithë Shqipërinë. Unë kam botën.”

Dhe sot ai e ka botën, që lexon librat e tij. Unë çuditem madje, pse nuk i japin një pashaportë të përherëshme dhe të bredh ku të dojë. Ai do të bënte për Shqipërinë sa tërë ambadadorët që kemi patur e kemi sot. Pse e lenë të sillet korridoreve të Ministrisë së Punëve të Jashtme që disa zyrtarucë të mendojnë plot zili burokratike: “E shikon, ç’ç jemi dhe ne. Pa firmën tonë ti s’shkon dot jashtë shtetit.” Shkrimtari i madh. Dhe nuk besoj të ketë ndonjë tjetër që të ketë patur aq shqetësime sa ai për veprat e tij. Kuptohet, herë-herë, se ç’i shkrep në atë kokën e tij pjellore! Por i kanë rënë në qafë edhe dhjetra herë, kur nuk duhej. Zilia. Burokracia. Mediokriteti. Të mbledhura bashkë në një ushtri pleshtash të bezdisshëm. Vajti aq keq puna sa një palaço, një farë injoranti në fushën e letërsisë, mori guximin të kritikojë dhe “Dimrin e madh”. Ishte tepër fyese. Të gjithë këta tipa nuk e deshën “Dimrin”. Ai u dukej si një traktat çpronësimi për tërë kastën e qelbur. Dhe u munduan ta varrosin. Por nuk arritën. Dhe “Dimri i madh” është sot ai që është e po ashtu edhe autori i tij Ismail Kadareja.

29 prill 1988

Nuk paskam qenë fort i gabuar në përshtypjen time për Ismail Kadarenë. Ia tregova atë një shoku dhe ai më tha: “Ka diçka konkrete në këtë gjë. Kur u botua në Francë novela “Krushqit janë të ngrirë” (apo “Kush e solli Doruntinën”) *“Fajardi”* e thirri Ismailin për prezantimin e parë të librit. Ato ditë ndodhi incidenti i Tedi Papavramit dhe për këtë arsye nuk e lanë Ismail Kadarenë të shkojë në Francë. Budallallëk. Ppikërisht në ato momente duhej dërguar Ismaili që t’i thoshte botës se nuk është ndonjë zgjuarsi e madhe dhe as meritë të merresh me një fëmijë. Nejshe. Më vonë Ismaili shkoi atje dhe u prit me nderim të madh.

Por e kisha fjalën te zyrtarët, në raport me talentet. Kur vajti Ismaili në Gjermani, kërkoi të kalonte vajtje e kthim nga Zvicra. Disa filluan të bënin llogari paratë. Duroi sa duroi dhe më në fund u tha:

“Po bëni llogari me paratë e mia?!” (Shpenzimet e udhëtimeve të tij, bëheshin nga një llogari e veçantë ku depozitoheshin honoraret që vinin nga botuesit.)

E shfaqti vetveten si njeri mospërfillës ndaj njerëzve mediokër. Kjo mospërfillje herë-herë

i shkon shumë përshtat, sidomos kur e përdor me shumë zgjuarësi siç di ndoshta vetëm ai...

Kishin ardhur dy grupe franceze xhirimi dhe i kërkuan intervistë.

-Kë përfaqësoni ju? – i pyeti.

-*Antenë – 1*, tha njeri.

-*Antenë – 2*, tha tjetri.

-Ti fillo nga puna; ti tjetri shko e transmeto intervistën që të kam dhënë para një viti.

Mospërfillje dhe dinjitet.

Mirë që e kemi. Hija e tij tani është mbase e frikëshme për letrarët e rinj. Ai duket i paarritshëm. Por emri i tij do t’i prijë një brezi të tërë shkrimtarësh.

27 gusht 1988

Dje ishte 50-vjetori i vdekjes së Migjenit. U përkujtua gjerë dhe mirë. U botua edhe një vëllim jubilar nga më të plotët e veprës së Migjenit.

Parathënien *“Migjeni ose uragani i ndërprerë”* e ka shkruar Ismail Kadare. Sot e mora librin (dje qarkulloi për herë të parë) dhe pasi i hodha një sy fillova të lexoj parathënien e Ismailit. E mahnitshme. Befasuese në mençuri. Thuajse e paarritshme në gjerësi. Dhe tepër e guximshme në thellësi. Kanë shkuar 50 vjet qëkurse Migjeni i ngriti monumentin vetvetes, po të shprehem me Horacin. Por u desh ky gjysëmshekulli që më në fund, me brumin e Kadaresë, të gatuhej e të ngrihej piedestali i këtij monumenti madhështor. Lexoja dhe mallëngjehesha, lexoja dhe mendoja, entuziazmohesha...

Papritur mora telefonin, formova numrin...

-Alo! Familja Kadare?

-Po.

-Vajza jeni!... A është babi?...

Ajo la telefonin hapur dhe dëgjova që foli: “Ju kërkon kryeredaktori i gazetës “Puna”... Namik Dokle...”

Doli Ismaili...

-Si jeni? Braktisa ndrojtjen – i thashë – dhe ju telefonova kohë e pa kohë... Po lexoj parathënien e veprës së Migjenit... Ke bërë një mrekulli.

-Faleminderit shumë, – tha Ismaili entuziast.

-Na kënaqe!

-Kënaqësia është edhe e imja nga këto fjalë...

Zëri i tij qe i butë, tejet miqësor. Me të vërtetë më gëzoi dhe madje duke patur në shpirt edhe dhimbjen për Migjenin tonë të shtrenjtë, u mallëngjeva. Migjeni – një fenomen i paarritshëm për kohën e tij. Po kështu dhe Kadareja për kohën tonë...

Nesër në gazetën “Drita” do të botohet eseja *“Hemingueji im”* e Gabriel Garcia Marquesit. E kam përkthyer nga spanjishtja. Më në fund bëra diçka për të qenë; diçka që ndoshta do të më tërheqë drejt letërsisë së vërtetë. Ndoshta...

19 shkurt 1989

Dje takova Remzi Lanin dhe më tregoi se Ismail Kadarenë e kanë zgjedhur anëtar



me korrespondencë të Akademisë Franceze. (Ka rreth një muaj që Ismaili është në Francë me gjithë Elenën.) Ky veprim afirmon me seriozitetin më të madh personalitetin krijues të Kadaresë, përsonalitet që pa dyshim përbën një nga krenaritë e kombit tonë.

Por ja një çudi nga më të çuditshmet!

Akoma nuk është dhënë asnjë lajm në shtypin tonë për këtë gjë. Gjithë bota e di këtë. Madje Tanjuga e dha lajmin, pa e fshehur dot marazhin. Ndërsa ne heshtim. Përse vallë?! Kujt i intereson kjo heshtje? Dhe unë nuk e kuptoj ku ka ngecur ky lajm; te Taqo Zotua apo te Miti Tona. Akademia Franceze, me sa dimë është një akademi serioze. Në këtë veprim të saj nuk fshihet ndonjë prapamendim i mbrapsht politik. Atëherë ne s'kemi pse të heshtim. Mos vallë kishte ndonjë ndryshim të madh kur Akademia Suedeze i dha prof. Androkli Kostallarit titullin “Doktor nderi” (apo diçka të tillë) dhe ne e propagandam? Aq më tepër duhet në këtë rast. Dihet që Franca ka predispozicion proslav e veçmas prejugosllav; *Tanjugu* qahet për predispozicionin antijugosllav të Kadaresë. Këtu mbi të gjitha kemi të bëjmë me një imponim të personalitetit të Kadaresë ndaj akadmikëve jo pak mendjemdhenj të Francës. Atëherë?! Pse mbahet në hije kjo gjë? Prandaj thashë që në fillim: çudi nga më të çuditshmet.

Por Kadareja është mësuar më këto. Madje, disa veprime mediokre të kësaj natyre sikur e impulsjnë në krijimtarinë e tij. Atëherë: faleminderit shumë, burokratë.

17 mars 1989

Dje u zhvillua një sesion shkencor me temën “Perestrojka – teori dhe praktikë antisocialiste”. Në njërën nga seancat do të kisha ikur, po të mos kishte qenë... dera e mbyllur. Nuk kishte gjëra shumë të zgjuara. Ndërsa pasdite foli shoku Foto Çami. Ishte një fjalim i mirë. Me disa ide të reja, me argumente dhe bindës. Me vështirësi po shkojmë drejt ideve të reja. Presim që këto të na i thonë vetëm udhëheqësit. Po 84 profesorët dhe dhjetra shkencëtarë të tjerë ç'bëjnë? Kemi pak autoritete si, fjala vjen, profesor Buda, Shuteriqi, prof. Çami, prof. Popa etj. Kopetentë në fushat e tyre. Aq sa Leka Shkurti, si me tallje, i thoshte Zija Xholit në pushim:

-Ç'thonë akademikët e rinj?

-Ka jehonë pozitive... veçanërisht për Alfred Uçin, Hamit Beqjen, për Kadarenë...

-Kadarenë jau kujtuan francezët më duket, - i thashë akademikut Xholi.

-Jo, jo...

-Nuk është pa gjë fjala e Namikut – tha Leka.

E vërteta është e qartë. Kadareja për ne është i njohur si i tillë prej vitesh. Po askujt

nuk i shkonte në mend ta bënte akademik. Ndonjë studim për krimbin e mëndafshit dikujt mund t'i duket më i rëndësishëm se vepra e Kadaresë. Por kur Akademia Franceze e Shkencave Morale e Politike e zgjodhi midis 60 anëtarëve korrespondentë që ka në mbarë botën (dhe zëvendësoi një akademik francez që vdiq.) atëherë u kujtuan edhe akadmeikët tanë. Më mirë vonë se kurrë, përndryshe Kadareja do t'u thoshte:

-S'kam nevojë për kolltukun tuaj akademik! Ju a kam falur gjithë nderimin e këtushëm. Kam botën.

Sidoqoftë ky është një veprim i mirë. Ai nderon Akademinë dhe jo Ismailin; ajo ka nevojë për të dhe jo Ismaili për Akademinë.

Po pija kafe sot me Bedri Islamin dhe po i mbushja mendjen që të qëndronte në gazetën “Puna” meqë kohët e fundit i është prishur mendja për të shkuar në gazetën “Bashkimi”

Na erdhi në tavolinë Kolë Jakova. U rinjohëm se siç na tha “vazhdoj të shkruaj, por më mundon nga pak arterioskleroza”. Unë e respektoj Kolën, megjithëse nga *artirioskleroza* e tij m'u varros para 15-16 vjetësh drama “*Kufiri midis jetës dhe vdekjes*”. Megjithatë ka ditë që mendoj se si t'i kthehem dramës, në ç'formë e në ç'rrethana. Ndoshta e bëj për 45-vjetorin e Çlirimit. Kola pastaj filloi të flas me Bedriun për Naim Gjylbegun (meqë Bedriu e ka dajë) dhe unë nisa bisedën me Petro Markon që sapo erdhi edhe ai aty. U dhashë dhe nga një kafe. Petrua më tregoi për një tregim që kishte shkruar këto ditë. Pastaj kujtoi ditët e tij të bukura kur kishte nxjerrë gazetën ABC, në kohën e Zogut, numri i dytë i së cilës e çoi në burg. Fliste me pasion dhe kujtonte hollësisë.

-Me Asim Vokshin e ke nxjerrë?

-Asimi mbante lidhje me abonentët. Në *numrin e dytë ne shkruam në kryeartikull se në Tiranë ka e mund të bëhet kushdo kodosh apo ministër; apo diçka të tillë. Na erdhi xhandari. Po qe i mirë se na tha që të fshihnim disa kopje para se të digjej. E bëri këtë se e njihte Asimin. Më morën e më çuan te Elem Totua. “Bolshevik! I shitur te rusët!”, më tha ministri Toto. Atëherë i nxorra mbi tavolinë këpucën e grisur nga më dilnin gishttrinjtë dhe i thashë: “Po të isha i shitur, nuk do t'i kisha gishttrinjtë përjashta”.*

Pastaj, Petrua më tha: “Edhe po nuk ke kohë të shkruash, mbaj shënime, tema, ngjarje, ide. Do të mbijnë dikur si filizat!”

2 maj 1989

Kënaqim krenarinë kombëtare kur lexojmë një Alen Boské të shkruajë që Ismail Kadare është ndër 5-6 shkrimtarët më të mirë të kohës. E krahasojmë me bashkëkohës të tjerë. Shohim diku konture më të qarta, disa gropëzime, diku një relief thuajse epik dhe përsëri krenohemi.

Sot, më së shumti, Kadarenë ia përqasim Gabriel Garsia Markesit; për nga suksemi dhe jo për nga mënyra e të shkruarit. (Kadareja më duket se është më filozof dhe do të rrojë ndoshta më gjatë. Për më tepër operon me filozofinë e së ardhmes, ndërsa Markesi me filozofinë e së tashmes). Megjithatë, para pak ditësh lexova një lajm tronditës. Është botuar romani i fundit i Markesit: “*Gjenerali në labirinthin e tij*” kushtuar viteve të fundit të jetës së Simon Bolivarit (ç'fat pata unë që kalova nëpër disa qytete ku ka jetuar e luftuar Bolivari. Mora avion në aeroportin “Simon Bolivar” të Guajakilit. Pashë momunemte të tij etj.etj.) Romani i Markesit është botuar në edicionin e parë në 700.000 kopje. Të gjitha janë parablerë. Dhe menjëherë janë nënshkruar kontratat që për vitin e ardhshëm të botohet në 39 gjuhë të botës.

Kadareja deri tani ka arritur në 38 gjuhë të botës; që praktikisht “mbulojnë” tërë botën veç kontinentit kinez. Por për këtë iu deshën rreth 15-20 vjet. Markesi e arrin këtë vetëm me një vit. Ritme lemerisht më të larta! E pra Kadareja nuk është më i paktë se Markesi (pavarësisht se unë kam simpati të madhe edhe për të.) Në disa pikëpamje është më i madh. Por “*ne jemi fëmijë të epokës në të cilën jetojmë*”, ka thënë dikush. Do të shtoja: “*Jemi fëmijë edhe të vendeve ku jetojmë*”. Spanjishtja e Markesit sundon në një kontinent të tërë. Makina propagandistike e saj është shumë më e fuqishme. Është, do të thosha, një “duel” me armë të pabarabarta.

20 qershor 1989

E hapa ditarin si për t'u çlodhur pas rrëmujës së punëve që kam në prag të Kongresit të 6-të të FDSH. Diskutime, Thirrje etj.etj. hollësisë që tani të paktën s'kam asnjë interes t'i përmend.

Po ç'të shkruaj për t'u çlodhur?

“*Sikur Gorki të shkruante poezi si Homeri, do të ishte Ismail Kadare*”, ka shkruar një gazetë franceze. Bukur. E vërtetë e thënë me finesë franceze. Po Amerika ç'thotë? Ka filluar botimi në seri i Kadaresë në Amerikë. Apdajku bën recension të shkëlqyer. E krahasojnë me shkrimtarët e mrekullueshëm të shekullit të 19-të në Rusi, Tolstoi etj. Kandidaturë nga më të përshtatshmet për çmimin Nobel. Çdo gjë e mirë që mund të thuhet për një shkrimtar. *Kapërcim shekullor nga një vend primitiv*, thonë autorë të ndryshëm.

I zgjuar m'u duk konstatimi i një recenzuesi. “Ka në veprën e Kadaresë, thotë ai, një simbolikë që është e vështirë për t'u interpretuar. Por atë, më mirë se kushdo e di shkrimtari i madh shqiptar”. Për mendimin tim, pikërisht këtu qëndron universalizmi i Kadaresë, fara më e sigurtë e gjenialitetit. Dhe gjëja më e mençur që ka pjellur mendja e pashtershme e Kadaresë. Megjithatë jo gjithmonë ka arritur t'ua hedhë “shfave të kuadrit”. Kushedi sa prej tyre i ka zënë dhe i zë kanceri nga madhështia e Ismailit. E në i ka zënë, le të pëlcasin!

27 qershor 1989

Sot ishte dita e dytë e Kongresit të 6-të të FDSH. Shkova. Kisha ftesë vetëm për sot, si të gjithë kryeredaktorët e gazetave periodike.

Seancën e parë të Kongresit e drejtoi Ismail Kadare. E ndoqa me kënaqësi. Kur mbaroi punimet seanca, e takova rastësisht në mjediset e Kongresit.

-Ç'kemi? – tha.

-Na gëzove që drejtove seancën. Dikush më tha: “Sa mirë që e kanë menduar.” Dhe unë i thashë: “Është nder për Kongresin, jo për Ismailin.”

Shkrimtari ynë i madh buzëqeshi në mënyrë të përmabajtur. (Unë po mendoja se fjalët e mia nuk ishin aspak një kompliment. Cilët nga personalitetet tona i ka bërë shërbimin më të madh popullit, për ta bërë të njohur në botë qëndresën dhe vitalitetin e tij?)

Pastaj e pyeta:

-E lexove recensionin e Amerikës?

-Cilin?

-Atë që shkruante se është fatkeqësi për Amerikën që nuk ka një shkrimtar si Kadareja. -Këtë e pashë, por më thanë se paska folur edhe para tre ditësh...

-Ja, lexojmë për ty dhe kënaqemi.

-Është e natyrshme; siç mund të kënaqemi edhe për një pingpongist shqiptar...

-Aa, ky është krahasimi më i keq që mund të kesh bërë.

-E kam fjalën në kuptimin e thjeshtë njerëzor, - tha më në fund Ismaili dhe u ndamë.

20 qershor 1990

Me Remzi Lanin pimë kafe në Pallatin e Kongreseve. Më tregoi se, para pak ditësh, shoku Ramiz kishte thirrur në takim gjithë

udhëheqjen e rinisë dhe Remziun. Kuptohet për problemet e Plenumit të 10-të. Si po i kupton rinia? Si po reagon e si po vepron?

I kaluar nëpër filtrin e Remziut, shqetësimi kryesor i shokut Ramiz, duket se është rezistenca e heshtur dhe jo e heshtur e disa forcave konservatore për zbatimin e vendimeve të Plenumit. E kishte shpjeguar këtë gjërë e gjatë. Por edhe krahu avangardist nuk është inekzistent.

Jetojmë kohra delikate. Është arritur deri te parulla “Të jap dy dëshmorë më jep një të arratisur”. E kujt është vallë ajo? E armikut, apo e konservatorit? Gjithsesi është kundër ndryshimeve. Po si mund të jetojmë pa ecur?! Çmimi mund të jetë përvëlues, por duhet duruar si i tillë. Shikoj një gjë shumë pozitive: “pushteti i të privilegjuarve” po shkundet pak nga pak. Prandaj ka pluhur. Prandaj edhe tështijmë. Shëndet!

Ismail Kadareja, në një artikull në gazetën “Drita”, për Eskilin, u hídhet si ulkonjë disa njerëzve të sigurimit që shkelin të drejtat e njeriut. I quan plehërina dhe i krahason me shovinistët serbë. Kush e ka zemëruar Zeusin e Olimpik shqiptar? Thonë se disa prej tyre kanë dashur taurveojnë: ç'bën, ç'flet, me kë mblidhet. (Ndërkohë ai luante njëfarë loje me kompjuter, në shoqëri me miqtë e tij.) Këurveojnë?! Ismail Kadarenë?! Sa përkëdhelëse qenka, pra, sharja e tij për këta njerëz, për këta qyrranjozë që mund të dalin vetëm nga hunda e një Koçi Xoxeje a të një Feqorr Shehu! Ata, që si atdhetarë e si “patriotë militantë” janë si mizë përpara një mali si Ismaili. Xhelozit e ndyrë shekullore! Ethe zilije të pështira! Të nderuar do të ishin edhe si baltë e këpucëve të Ismailit. E nga kjo baltë dalin kinezëritë e “ç'jetinçive”. Qënie të pështira që si shushunja pinë gjakun e popullit, gjoja në emër të mbrojtjes së tij. Më thanë se çështjen e kishte marrë vesh shoku Ramiz dhe kishte urdhëruar të merren masa të rrepta. Mirë.

27 qershor 1990

Sot isha i ftuar në Konferencën Kombëtare të Kryqit të Kuq Shqiptar. I themeluar më 1921 dhe i aprovuar në Ligën ndërkombëtare të Kryqit të Kuq më 1923, në vitet 1967-1969 u abandonua krejt dhe gjatë 20 vjetve shteti ynë vetëm pagoi kuotizacionin që i takonte, pa marrë gjë prej tij. Pse u larguam nga një shoqatë kaq humanitare?! Na trembte fjala kryq apo çfarë? Politizim i tepruar. Madje në këtë rast ideologjizim i tepruar. “Nuk kemi nevojë për asnjë ndihmë!” As në zjarr dhe as në tërmet. Por as nuk jepnim për të tjerët. Njëfarë mendjemadhësie e çuditshme. Por vetëm tani na duket e tillë.

Ciril Pistoli, ish –kryetar (në hije) i KKSH-së foli në konferencë. Nuk hyri në analiza, as doli në përfundime. Por tregoi karakterin human të shoqatës. Ishte bindës. Sherri krisi në zgjedhjet. Njerëzit, duke menduar se KK do të ketë një farë aktiviteti ndërkombëtar, donin si e si të futeshin në organet e tij. Manovrat qenë bërë me kohë nën rrogë. Aq sa dhe Muharrem Xhafa ishte kandidat për në Këshillin Qëndror të KKSH. Por zgjedhjet demokratike me votë të fshehtë, bënë që të hiqeshin shumë nga listat. Muharremi vetë u ngrit e dha “dorëheqje vullnetare”. U hoq Skënder Gjinushi (me votim), Mehmet Elezi e shumë funksionarë të tjerë. Vetëm një njeri nuk pati asnjë votë kundër: Ismail Kadare.

10 gusht 1990

Ramiz Alia u takua sot me intelektualët më të shquar të Tiranës, duke filluar me Ismail Kadarenë e duke përfunduar te Luan Omari a Bardhyl Londo, Muntaz Dhrami a Spiro Dede. Në krah të djathtë kishte Xhelil Gjonin! “Më thanë të bëja një takim intim me 5-6 intelektualë të shquar. Por unë i shtova shifrës një zero dhe jemi mbledhur 50-60. A nuk është përsëri intim takimi?” Një shaka sa për fillim. Pastaj kishte shpjeguar situatën. Përmbyse e plotë e socializmit në lindje. I njëjti skenar dhe për Shqipërinë. Por te ngjarja e ambasadave skenari u ndërpre. Nga Shqipëria nuk kërkohet kozmetikë, por përmbyse e plotë. Këtu qëndron thelbi i kontradiktës tonë me botën e sotme... pas kësaj ekspozije, pyetja:

- “Dua të këshillohem me ju; ç'të bëjmë? Flota greke është dislokuar në Korfuz. Po unë si Komandant i Përgjithshëm ta lë flotën në Shëngjin?” etj.

Kishin folur I. Kadare, M. Dhrami, S. Berisha, L. Omari, etj. Ishin shtruar shumë pyetje e sugjerime:

-A ka të vrarë në Malin me Gropa?

-Në demonstratën e Tiranës pati të vrarë, pse u tha që pati plagosje të lehta?

-Pse ministri i Sigurimit nuk u shkarkua?

-Pse nuk njoftohet populli për ngjarjet kryesore?

vijnë nga jashtë, jo kur ikin...” E kuptova që ai po ikte, se kishte mbetur pa kalá. Por nuk i thashë njeriu. “Le të ikë!” – mendova me vete. Mirë bëri. Unë qëndrova. Edhe unë mirë bëra.”

4 maj 1995

Erdhën eshtrat e Faik Konicës. Gjatë ceremonisë takova Kadarenë. “Do të rri disa ditë”, më tha. Dukej mirë. Mungonte Dritëro Agolli; Shteti nuk e ka ftuar. Injorancë.

20 nëntor 1995

Kadareja kundër socialistëve?

-Në gazetën “Albania” Ismail Kadare deklaroi se socialistët nuk duhet të vijnë në pushtet. Ky deklarim pati jehonë në qarqet politike shqiptare. Por gjithsesi deklarata e Kadaresë, sidomos në një gazetë që lexohet nga ushtarë të urdhëruar, nuk përbën ndonjë ngjarje në jetën politike shqiptare.

Megjithatë, për respekt ndaj shkrimtarit të madh, unë do të bëja një koment të shkurtër. Mua më vjen mirë që Kadareja ka dalë kundër versionit zyrtar të Tritan Shehut, i cili bashkë me Sali Berishën, Maksin dhe Ali Spahinë ka pretenduar se “do ta mbajmë gjatë pushtetit”. Kadareja përkundrazi nënkupton që socialistët mund të vijnë në pushtet. E rëndësishme është, gjithashtu, që edhe Kadareja është në një mendje me sondazhet e eurobarometrit që thonë se socialistët mund të vijnë në pushtet. Ndërsa thotë se nuk është mirë të vijnë, shton se nuk do ta mbajnë gjatë pushtetin. A është mirë, apo s’është mirë, këtë s’e di as Kadareja dhe as unë, por e dinë zgjedhësit. Nuk po zgjatem në komente të mëtejshme për këtë deklaratë, sepse nuk është e thënë që shkrimtarë të mëdhenj të jenë gjithmonë edhe politikanë të mëdhenj. Fjala vjen, Gabriel Garcia Markesi është një shkrimtar i madh, fitues i çmimit Nobel, por në politikë nganjëherë ia fut kot dhe thotë se “regjimi më i mirë në botë është ai i Fidel Kastros”.

Paris, 16 dhjetor 1998

Sot kisha një mbledhje të Komisionit Politik të KiE-së. Fjalë, fjalë, fjalë.

Në darkë shkova në ambasadë. Kanë ndërruar selinë, nga Rue de la Pompe, kanë shkuar në Avenue Marceau. Më në qendër, më e lirë, më e mirë.

Dy gra artiste (Mira Kuçuku dhe një tjetër) kishin hapur një ekspozitë qeramike dhe tekstili artistik. Me këtë rast ishin mbledhur shumë shqiptarë; të ardhur nga Shqipëria, ose me banim në Paris. Biseda të shumta...

Më mbetën në mend për të shënuar disa gjëra...

Zamir Mati, piktor, më tregoi se Llambi G. jetonte në Paris. Po me se jeton, e pyeta, dhëndri a djali, kush e mban? Ata kanë punën e tyre, më tha, por unë bëj piktura, Edi Rama dhe të tjerë bëjnë piktura, Llambi i shet pikturat dhe jetojmë të gjithë... Anëtar i Byrosë Politike... Pompë e madhe dhe tani pordhë e madhe në Paris.

Takova dhe vajzën e Shpresa Kamanit, Verën. Ishte atje për një specializim. “Sa ju shikoj ju, më kujtohet mami”, më tha Vera. Në të vërtetë edhe mua kështu më ndodh. Sa herë shikoj ndonjërin nga vajzat e Shpresës, më kujtohet ajo.

Aty nga fundi i mbrëmjes, në ambasadë erdhi Ismail Kadare me Elenën. Më thanë që kohët e fundit ata vijnë me më pak naze në ambasadë, meqenëse aty, tashmë, punon djali i Llazar Siliqit. Vajza e Ismailit është e martuar me djalin e Llazarit...

“Ua Namiku, sa kohë s’të kam parë, më tha Elena. Sa herë të shoh, më kujton Shpresën.” I tregova se të njëjtën ndjesi ka edhe Vera.

Pastaj u tërhoqëm në një kënd me Ismailin dhe folëm thujse një orë për Shqipërinë dhe Kosovën. Ishte shumë i pezmatuar me politikën dhe politikanët shqiptarë, te ne dhe në Kosovë.

“Politikanët shqiptarë nuk e kuptojnë se e kanë vendin në zi. Dhe në zi ka më shumë heshtje dhe respekt. Ç’bëjnë ata?! Pse janë katandisur në ca grindavecë të vegjël?”

Vura re se, në asnjë rast, mua nuk më përfshinte në këtë grup. Nuk thoshte “Ç’bëni ju?” por “Ç’bëjnë ata?”. Thjesht për xhentesë franceze, më duket. Por ishte shumë i hapur dhe i shqetësuar.

Po për Kosovën? e pyeta...

“Ata janë më keq. Ata zihen e grihen për kolltuqe dhe për para, kur vendi është akoma i pushtuar nga Serbia. Mjerë Kosova me ata politikanë që ka.”

Pastaj folëm shumë për Teatrin dhe problemet që ai po përjeton.

10 korrik 2000

Në zyrën e Rexhepit pritëm, bashkë, motrën e Ukshin Hotit, Myrveten. Që më 16 Maj të vitit

të kaluar asgjë nuk dihet për këtë politolog të shquar të Kosovës. Ishte në burgun e Dobravës, në afërsi të Istogut. Më tej u tha që u transferua në Nish; të tjerë thonë që është liruar, por s’dihet se ku është. Ndoshta bën pjesë në 7000 kosovarët e zhdukur.

Ani, të pakëtn t’ia di varrin, tha motra. Unë e di se çdo të thotë të jesh motër e pangushlluar, me vëlla të zhdukur, se e kam jetuar këtë ndjesi te nëna ime, të cilës, po serbët, ia zhdukën vëllanë, Shahinin, që më 1945. As i vdekur, as i gjallë...

Mora përsipër të interesohem në KiE. Për Ukshin Hotin është interesuar Rexhep Meidani, Dan Evertsi, Kryqi i Kuq etj. Por zëri më i fuqishëm për të vërtetën e Ukshin Hotit, të paktën deri më tani, ka qenë Ismail Kadare. Dhe akoma s’po e gjejmë. Serbët janë monstruozë në zhdukjen e njerëzve!

27 nëntor 2006

Isha për 2-3 ditë në Azerbaixhan, në Asamblenë e PABSEC-ut. Gjëja e parë që na organizuan të zotët e shtëpisë ishte vënia e kurorës te varri i Hajdar Alijevit, ish-udhëheqës komunist, i konvertuar më pas në demokrat e patriot azer. Pastaj na çuan në varret e të rënëve në luftën me trupat e BRSS dhe në Nagorni-Karabak. Shumë nga deputetët merrnin poza serioziteti; të tjerë nënqeshnin me ironi. Të dy “pozat” ishin qesharake; ose të paktën kështu m’u dukën mua.

Duke u kthyer nga Azerbaixhani, në autobuzin aeroportual të Vjenës, takova Ismail Kadarenë. Kishte qenë për dy ditë në Vjenë.

“Po ti, ku ishe”? – më pyeti. I tregova.

“Shumë po shkoni në lindje”, më tha.

Ministri i Jashtëm ka qenë tre herë në Moskë.

“A, jo” – i thashë – Azerbaixhani nuk shikonte nga Moska, por nga Stambolli.

“Turqi - hesapi”, – tha ai. Pastaj më tha që do të largohej shpejt nga Tirana. “Nuk shkruaj dot në Tiranë. Shumë zhurmë politike, zgjedhje, Kod, Komision Qendror. Dhe sikur këto do të zgjidhin ndonjë gjë! Asgjë nuk zgjidhin! Në Francë shkruaj më qetë.”

“Të ka lodhur edhe debati”, - e ngacmova.

“Jo vetëm debati”, - më tha.

Pastaj hipëm në avion. Ishim larg njeri-tjetrit...

19 maj 2007

Pas shumë vitesh e rilexova romanin Kronikë në gur, me të njëjtën etje si dikur. Nuk e di dhe nuk besoj të jetë shkruar një kronikë tjetër, kaq dramatike, e situr deri në përsosmëri, në rrëfimin e një fëmije!

Mendoj se është një nga kryeveprat e Kadaresë. Ndoshta edhe vetëm për këtë duhet ta kishte marrë prej kohësh çmimin Nobel. Vetëm për këtë. Ndoshta... Por ndoshta pse nuk është vetëm kjo s’po ia japin çmimin Nobel. Disa nga veprat e tjera mund të kenë prishur shijen e “Kronikës” nobeliste për Kadarenë. Sidoqoftë, “Kronikë në gur” është një shkollë se si duhet të shkruhet. Ç’më erdhi ky mendim kështu?! Kur u botua për herë të parë “Kronika”, në fillim të viteve shtatëdhjetë, Nexhip N., një koleg i imi në gazetën “Puna”, më tha: Ky libër tregon se si nuk duhet shkruar një roman. U grindëm një copë herë; siç ndodhte rëndom me veprat e Kadaresë, të cilat i ndanin njerëzit gjithmonë në dy grupe; pro dhe kundra. Ishte dhe një grup i tretë; të heshturit. Ose më mirë të themi frikacakët. Po, po; kishin frikë të shprehnin një opinion! Kështu ndodhi edhe me “Kronikën”. Nexhipi, gazetar shumë më i vjetër nga unë, i kishte nxirë me shënime hapësirat anësore të librit dhe bërtiste: Ja si nuk duhet shkruar! Sidomos ishte gati të vriste Kako Pinon dhe Xivo Gavon. Ç’kishte me Xivo Gavon?! Kujtonte, i marri, se me Xivo Gavon, Kadareja sulmonte të gjithë gazetarët (kronistët)!

Më në fund kuptova se me këtë njeri, i cili, kishte shkruar letër “lart” që të gjitha fushat e futbollit të mbillen me patate, ishte e kotë të diskutoje.

Më duket se edhe për Xivo Gavon shkroi letër “lart”. Por natyrisht, i ndjeri Nexhip nuk e bënte nga cmira. Cmirëzinjtë kundër Kadaresë, ishin pikërisht “lart”.

Ata “lart” ëndërronin ta shihnin një ditë të varrosur, të harruar në pluhurin e kohës. E godisnin, i ngrinin kurthe, e kontrollonin, e përgjonin; hidhnin përsëri bomba mbi të; përsëri dhe përsëri. Njëlloj si me qytetin e tij të gurtë. Në një kuptim, romani nuk është kronikë për Qytetin, por kronikë për Njeriun, madje, kronikë për vetë Ismail Kadarenë. Qëndresa e Qytetit të Gurtë është vetë Guri i Qëndresës për Kadarenë. Fëmija i vogël përcjell gjithë kronikën e Ismailit të madh; dhe ata shkrihen me njëri-tjetrin në mënyrën me të natyrshme; si uji me tokën; si era me borën...



PORTRETI I KADARESË - DHURATË E MAESTRO KODRËS.

Nga Visar Zhiti

Ta kujtosh përmes artit, është kujtesa më e bukur...

Ka gjezte mes njerëzve të njohur që bëhen fare zakonshëm, aspak për dukje, por mbeten dhe ndoshta këtë kanë dashur, por mbi të gjitha të tregojnë marrëdhënien e mirë mes atyre që bëjnë art.

Ja, një vizatim që ka kaluar nga një dorë në tjetrën, që sigurisht mban brenda vetes kohë dhe dëshmon, gati flet....

Është një skicë e Maestro Ibrahim Kodrës, portreti i shkrimtarit tonë Ismail Kadare, jo se ai i pozoi, - më ka treguar vetë Kodra.- s’ishin bashkë kur hodhi vijat e skicës mbi letër. Por e punoi me ngazëllim dhe vetëm me kujtesë. Kodra rikrijoi një çast, që e deshi, një vështrim nga shkrimtari. E çmonte atë pranë. Imazhi kaloi nga zemra në mendje e pastaj në letër për të mbetur figurë emocionale. Vijat janë të pakta, të sigurta, pa zbukurime. Në to shfaqet një Kadare i përqendruar, i heshtur, me qetësinë e atij që e di fjalën si ai tjetri vizën.

Po ku ishin takuar dy K-të?

Në Paris, në qytetin e ikjes së Kadaresë dhe të lirisë?

Në Milanon e Maestro Kodres, mes ekspozitash dhe bisedash për artin?

Në ndonjë përrurim libri të ri të Kadaresë?

Apo në ndonjërin nga shtëpitë e tyre, si dy shqiptarë të njohur në Evropë e në botë, që ndanin jo vetëm famën, por edhe barrën e përfaqësimit?

Nuk pyeta dhe nuk më thanë gjë...

Ndoshta takimi i tyre më i vërtetë ka ndodhur përtej vendeve, në hapësirën e përbashkët të krijimit, aty ku arti dhe letërsia njohin njëri-tjetrin pa pasur nevojë për shpjegime e adresë. As konflikt...

Skicën ma dhuroi mua Kodra atëherë, kur isha pranë tij në Milano, nga që e pa që unë e doja Kadarenë ashtu si dhe atë. Skica udhëton me mua në Tiranë. Dhe një ditë në takimet në lokalin “Juvenilja” me Kadarenë dhe botuesin e tij besnik, Bujar Hudhri, tregova për portretin, madje Kodra më kishte dhënë dhe negativin e tij në alumin. Kadaré heshti si zakonisht, kur i pëlqente diçka apo e bënte të mendohej. Bujari u interesua për më tej duke e imagjinuar vlerën e më vonëshme. Dhe do ua dhuroja atyre skicën dhe copëzën e aluminit. Me Bujarin do kishte më rëndësi, e ndjeja. Një çast i thjeshtë, pa ceremoni. Kadareja besoj e pa jo vetëm si një portret të tij, por dhe si një shenjë miqësie dhe adhurimi. Atij i duheshin miqësitë, takimet, bisedat e qeta, njerëzit me të cilët fjala ndahej.

Tani kur Ismail Kadareja do të ishte 90 vjeç e bashkë me Kodrën janë në Qiell, kjo historizë merr një vlerë tjetër, sa njerëzore, edhe artistike. Jo si artefakt përvjetori, por si çast nderimi i një jete që i dha gjuhës shqipe me romanet e tij një përmasë botërore. Skica e Kodrës, e kaluar nga një mik te tjetri tani duket si në një rreth të mbyllur me qetësi: arti në burimit e veta.

Por flet kujtesa e gjallë kulturore, edhe përmes asaj që duket heshtje. Një fletë letre, një makinë shkrimi dhe jeta... Vepra dhe pavdekësia.

- Ç’të kujton kjo? - më pyeti Bujari nga larg, por që i ndjehej emri i tij, bujaria. Dhe s’kish si të mos i shkruaja. E rëndësishme është të dimë të kujtojmë përmes artit. Dhe dashurisë. Se jo çdo kujtesë është ashtu, sidomos ato nga urrejtja dhe ca më keq, kujtesa ideologjike. Jo të tjerat. Kujtesa e artit mbetet më e bukura....

Lisbonë, 23 Janar 2026

Ndue Dedaj, ndoshta është sot autori i vetëm “rregulltar” në lëvrimin e reportazhit, kësaj gjinie mirëfilli e publicistikës, reportazhit letrar gjithashtu, e ndërmjetmja që ndërlidh të parën me letërsinë. Në krye të herës, Ndueja është shfaqur si poet në letrat shqipe. Më se tri dekada më parë. Duke dizenuar gjurmën e tij të përvetçme në këtë fushë. Por ka lëvruar njëherësh edhe prozën e shkurtë, me po të njëjtën mirëpritje, ku shprehësia poetike, ka qenë gjithëherë e pranishme, madje gati rregull estetik në prozën e autorit. Tregimet interesante, dalluar për narrativën origjinale kanë shënuar linja të reja në profilin krijues të tij edhe në zhandrrin e prozës së shkurtë të viteve të fundit.

Kërkues e ngulmues në stilin e tij shkrimor, Ndue Dedaj nuk krijon mirëfilli realitete artistike, ai përzgjedh e modelon artistikisht gjëndje reale, të ndodhura këtu, në njerëzinë e në peisazhin e këtushëm. Pa e shtrirë fantazinë krijuese në “galaktika të tjera”. Nuk e ka ndjerë e as nuk e ndjen të nevojëshme këtë, falë plotënisë së vehtjes krijuese me përjetime, të cilat vijnë në tryezën e shkrimit mbas eksplorimit të thellë nëpër realitete e ngjarje, që shumëkush kishte me ja pasë lakmi. E së njëjtës hulli është romani KLASIKU V . Një dëshmi besnike e kohës që rrok; nga vitet ‘60 deri në vitet ‘90 të shekullit të shkuar e përimtuar me shije nëpër laboratorin krijues të autorit e duke e sjellë atë në formë të receptueshme e mandeje të obserbueshme lehtas e me ndezullí emocionuese te lexuesi. Me shenja të dallueshme mirëpritjeje.

Piketat që ndërlidhin ngjarjet janë në tri pika përbashkuese: malësia, qyteti industrial i Pirustit me “minierën në pranga” dhe Tirana në fillimetamorfiozën e atyre viteve. Ngjarjet që lëvrijnë nëpërmjet këtyre enëve komunikuese janë të lidhura gërshet dhe si të tilla vijnë të njinjishme, të pashkëputura. Spunton intriguere e marrin nga një shpoti e tre djemve tiranas në kafe “Flora”. Me shakanë e tyre prekin të paprekshmen; katërshes së klasikëve, që asokohe kishin pushtuar subkoshiencën publike, i “shtojnë e i heqin” të pestin, që lëvrinte si ëndërra e paranojës së prijësit të gjithëfuqishëm. Shakaja paguhet shtrenjtë; Arseni përfundon në kampin e të dënuarve politik në Dyfandorë, afër qytezës së Pirustit, kurse e shoqja Justina, mbartëse e një traume pas përdhunimit mizor. Bindëse deri në bestyt, ngjarjet. Se vijnë prej një autori me njohje-përjetime të detajuara deri në skaj. Lënda nga e shkuara e afërt edhe pse e trajtuar vetëm si fiction vjen e bindëshme e pa kurrfarë mëdyzje. Plot kërshëri për lexuesin me moshë të papikëtakueshme me kohën romanore, po gati si makabritet përtej besueshmërisë i personazheve të ngjarjeve. Kurse lexuesit mocatar me ngjarjet i dhembnin në palcë ato ; gjithsecili gjen diçka e shumëçka të vetën në to. Vjen aty koha e vëzhguar me të gjitha shqisat krijuese të autorit, endur në personazhe - karaktere si: Justina, Arsen Petrela, Bibëdod Orosi me lesh në vesh, Holta D., nëna e Andon Moravës, shefi i burgut Hetem Borani, i plotfuqishmi përdhunues, Prokop Vrana, Ruta Përshpali, Shpendi, i arratisuri me të dashurën në Korab . Drama e personazheve objekte të saj përjetohet edhe si dramë për këtë kategori të lexuesit. Realja dhe surrealla këtu ndahen prej një lëmazë (fije e hollë) qepe; xhelati dhe viktimja gjënden ngjitas dhe vjen një çast kur përdhunuesi shpallet hero. Vuajtja e viktimës gjakon në të brendëshmen e “dëshmitarit” lexues.

Drama në vetvehte vjen e shtresëzuar si tri dimensionale, sipas gjeografisë së teatrit ku zhvillohen ngjarjet, por, megjithatë kulmon kurdoherë në një të përbashkët: denatyrimi i njeriut normal dhe i etnosit të tij e përpjekja e rregjimit për ta zëvendësuar me njeriun-tip laboratorik, homosapiensi

Shënime për romanin *Klasiku V* i Ndue Dedajt

DËSHMI LETRARE E NJË KOHE TRAGJIKOMIKE

Nga Frano Kulli

i ri socialist. Një përpjekje që e kërkon me ngulm ta materializojë, paranoja e Klasikut V. Aq e thellë e ngulmuese sa e kish fashitur e më pas asgjësuar vetë Jezusin në subkoshiencën e tij e kish zbritur këtu ndër ne si vetë mesia për shpëtimin e njerëzisë së këtushme. Me synimin për të krijuar vëllazërinë e ...të mjerëve. Në trup e në shpirt. Krijimin e qenies së mëdyshtë; njëra pjesë për jashtë e tjetra ajo e vërteta për mbrenda mureve të shtëpisë e “mureve” të vetvehtes. Aq e vetvetishme vjen e gjitha kjo, mjafton përsjellja e përpjesëshme në rendin e leximit e shumësisë së fjalësit që lëvrin në bashkëbisedën e personazheve:

- në dhomë qanin vajtojcet, në dhomën tjetër këndoheshin ninullat

- teshat e dekës?... me më fal Amerikën, jo nuk i shes.

Dikund tjetër janë “prangat që rrinin varur në ajër”. Tek metafora e prangave në ajër rri varur në zgrip të jetës qenia njerëzore. Përqasja e dhunimit të Justinës me legjendën e Tringë Meshurdhit, është sureale. Sipas legjendës Tringa e vrau pashën turk përdhunues për mos me ra në dorë të tij e mandej u hodh

prej shkambit. Kurse Justina ... heshtja, pafuqia e saj ndaj përdhunuesit është vetë sindromi i Stokholmit. (Do të vinte siraja që përdhunuesi të shpallej hero) O tempora o mores! - do të ligjëronte përsëri Ciceroni. Po, a s’ ishte e gjithë marrëdhënia e njerëzisë së këtushme me KLASIKUN e V-të një sindrom i Stokholmit?! A s’e duartrokitën kur ai u hoqi vetë Zotin prej shtëpisë së tij? Dhe e duartrokitën, e duartrokitën kur kishin mbetë kockë e lëkurë, pa mish e pa shpirt, prej dhunës e përdhunës së tij?! Ata, të përdhunuarit që ai, të afërmit ua kish dënuar për së vdekuri. Se trupi i të vdekurit të dënuar nuk mund të tërhiqej pa mbaruar dënimi ua kish lënë pa varr?! E ata, vetë ata e përcollën me lot përfaqe për në varr KLASIKUN paranojak !

-Jo, kullat tona burgun e kanë pas veç për gjanë e gjallë, kurse gjeveeria ua ka shtrur udhën me hithër shqiptarëve. Ku të linte Kuvendi i Maleve më ia mbyll gojën burrit, le pastaj me e mbyll atë vetë në vathë si berrin - fliste me vehte Bibëdoda urtak.

- Nuk fluturojnë më mbi ato karma zogj. Nuk këndojnë. Kanë turitur. I vetmi shpend që dëgjohet atje është qyqja.



- në bulevardin “Dëshmorët e Kombit” ishte lustra, mashtrimi, farsa, asgjëja.

- Një hero përdhunues...

- barinj të sogjetarë (roje)... që ruanin kufrin prej shkelësve më shumë se bagëtiti...

Shfityrimi dramatik i njeriut prej rregjimit, i cilësdo shtresë a etnitet kulturor qoftë; kryeqytetas, malësor a skllav i “minierës-burg”, rrokulliset me një temporitëm që të përpin, një densitet emocional që shkon krah me ngasjen emocionuese të lexuesit. Por që se arrin asnjëherë “pikën e vlimit”. Valvula që shfryn densitetin dramatik është *shtjella satirike* forma e epërme e kualitetit artistik, një humor i zi e satirë e hollë, e mprehtë, që ther deri në palcë...

-zinxhiri i pantallonave të Holta D... bëhet objekt qortimi në Komitetin e partisë.

-përveç raportit zyrtar për Byronë Politike t’ju dërgoj dhe këtë raport kofidencial: Një mësuese dhe një nëpunëse kanë bërë kopila këtë vit dhe i kanë mbajtur t’i rrisin vetë, s’duan t’i çojnë në shtëpinë e fëmijës.

-Shoku i radiologjës i Andon Moravës dënohet dy vjet më pak sepse në lojë kishte pasë rol pozitiv.


- në Komitetin Ekzekutiv plasi sherri pasi, për vitin e ardhshëm, në të gjithë rrethin nuk ishte planifikuar të blihej asnjë gomar? E si do të mbarseshin pelat dhe gomaricat?...

“U mblodh shtabi i luftës kundër shfaqjeve të huaja dhe nuk vuri gjumë në sy, për gjithë natën. Aty nga ora tre pa dalë drita, u futën në Komitetin berberët e qytetit, për një takim urgjent me sekretarin e parë. etj, etj, etj.”

Ajo anekdoda për shiun, e njohur për usullin e pagjindshëm të katundarëve që do e duan e do tjerë se duan është e herëshme. “Qe verë e thatë asohere, rrëfen anektoda, e Zoti s’po falte shi. Katundarët bahen bashkë e shkojnë te prifti me ia paraqitë atij lutjet që I lumi prej së nalti të falte shi. Mirëpo, ishte kohë të korrash e ato që ende se kishin korrë grurin do prej tyre, s’po e duan shiun. Të tjerët që donin me mbjellë lypshin shi . E atëhere prifti u thotë:

- Bajuni në një mendje ju ndërmjet vedit e atëhere hajdeni e unë atëherë ia paraqes lutjen tuaj Atij..., mbyllet anektoda. Kurse për stërvitjen ushtarake “shiu është gjithherë i dobishëm për kalitjen e ushtarëve e zboristëve”, kumton njëri prej personazheve groteskë të romanit. Edhe ai mbrojtës i idiotësisë, siç ishte groteske e gjithë udhëheqësia e mbrojtjes prej armiqve imagjinare nën mbretërinë e Klasikut të V-të...

Letërsia e vërtetë e tejkalon realitetin, dihet, por letërsia me mjetet e saj edhe e dëshmon kohën, atë pjesë kohë që brendashkruan. Madje pretendon ta ndikojë atë. Dhe letërsinë e mirë, posë të tjerash e bën edhe gjuha e zgjedhur. Ndue Dedaj, një lëmues i sprovuar i saj është njëri prej tyre që spikat.



“*Poema e mungesës*” e poetes Rita Petro, vjen si një reflektim i thellë mbi të vërtetën shpirtërore dhe atë shoqërore, ku vargjet shndërrohen në hapësirë meditimi mbi qenien njerëzore dhe mungesën e saj.

Vepra i ngjan një udhëtimi të brendshëm që nis me *Prologun mbi dashurinë*, vargje të ndërtuara mbi përsëritje ritmike dhe antiteza të fuqishme, ku dashuria shfaqet njëkohësisht si forcë krijuese dhe shkatërruese. *Për dashurinë/Që janë shkruar libra/Për dashurinë /Që janë bërë luftëra. Për dashurinë /Që na fut nën dhé/Për dashurinë/Që na ngre mbi re.*(fq. 8-9)

Ky prolog, duket se çmitizon idealizimin romantik, duke e paraqitur dashurinë si energji transformuese që prish kufijtë moralë, biologjikë dhe shoqërorë. Kalimi nga pafajësia në pjekuri dhe nga joshja në mbrojtje tregon se dashuria nuk është gjendje statike, por proces i vazhdueshëm tensioni dhe kundërvënije. *Për dashurinë / Le të vdesim sot/Që të rilindim /Të dashuruar nesër.* (fq. 9)

Si rrjedhojë, prologu e sheh dashurinë jo si ndjenjë sentimentale, por si parim ekzistencial që lëviz njeriun mes rënies dhe shenjtërimit, duke përgatitur terrenin filozofik në të gjithë veprën.

Ky udhëtim në skutat shpirtërore (që vendos ta quaj pas leximit veprën) përballat me boshllëkun e *Shtratit Gjysmëbosh*, ku *dashuria* dhe *vdekja* bashkëjetojnë në një tension të heshtur, por thellësisht ekzistencial.

Nëse ndalemi te poezia e parë “*I njëjti mall të solli?*” që hap nënsythin “*Dashuria*”, ajo ndërton një meditim filozofik mbi mungesën, përkohësinë dhe iluzionin e vazhdimësisë, ku përvoja intime shndërrohet në reflektim ekzistencial. Simbolika e yllit që ndriçon edhe ditën, përmbys rendin natyror: drita e yllit nuk i përket më vetëm errësirës, por bëhet parim orientues i vetëdijes gjatë ditës. Ylli që shfaqet dhe zhduket pas reve vendos gjendjen e autores në një lëvizje të pandërprerë mes Jetës dhe Vdekjes, jo si cikël biologjik, por si gjendje të ndërgjegjes: prania është jetë, mungesa është vdekje, dhe ku kjo lojë nuk ka mbyllje siç shprehet autorja. *Më shfaqesh e më zhdukesh pas reve/një lojë kjo pa mbarim: Jetë – Vdekje.* (fq. 12)

Poetja është e vetëdijshme për paprekshmërinë e botës tjetër “*Shpejtësinë e erës në parajsën tënde nuk e mat dot*”, megjithatë, kujtesa dhe imaginata e rikthejnë të munguarin “të gjallë”, duke e bërë të pamundurën të mundur. Koha ndalet vetëm për të pyetur, jo për të marrë përgjigje. *Po, kur të sjell të gjallë para meje/ mundem ta ndal për pak kohë /sa të të pyes/ Edhe ty/ i njëjti mall të solli?* (fq. 12)

Pyetja retorike mbi mallin nënkupton se mungesa është reciproke, por kurrë e verifikueshme. Në vargun e fundit “*mua më ngrinë krahët hapur*” përmbledhin dramën filozofike të tekstit: njeriu mbetet i hapur ndaj tjetrit, edhe kur tjetri mungon. Është gjendja e një subjekti që nuk mbyllet dot, sepse mbyllja do të ishte pranimi i fundit. Kështu, poezia pohon se dashuria dhe malli nuk e pranojnë fundin; ato e shndërrojnë mungesën në formë të vazhdimësisë.

Te nënsythy “*Vdekja*” interesante në poezinë “*Ne jetojmë me vdekjen.*” shfaqet këndvështrimi i poetes për vdekjen. Poezia e zhvendos vdekjen nga prania e vazhdueshme drejt ngjarjes finale. Metafora e shtëpisë e paraqet jetën si hapësirë të mbyllur ku vdekja është gjithmonë e pranishme, por e padukshme, ashtu si sendet e harruara. Kjo krijon një kontrast mes dukshmërisë së jetës dhe fshehtësisë së vdekjes, duke sugjeruar se ajo nuk është e huaj, por e përfshirë në përditshmëri. *Ne jetojmë me vdekjen në një shtëpi/nuk e shohim, si dhe shumë prej sendeve/që nuk ua hedhim sytë...* (fq. 83)

“*Poema e mungesës*” e poetes Rita Petro, Albas

Vazhdimësia e imazheve pas leximit të “Poemës së mungesës”

Nga Klevisa Bardeli

Në vargjet e kësaj poezie, vdekja vjen e përshkallëzuar në tre momente:

Vdekja e padukshme – bashkëjetuese e heshtur, e pluhurosur nga harresa.

Vdekja si paralajmërim – shfaqet si hije dhe perceptohet përmes trupit (*ritmi i zemrës*), çka tregon se vetëdija biologjike reagon përpara ndërgjegjes racionale.

Vdekja ballore – momenti i përballjes absolute me vdekjen, ku çdo pyetje bëhet e pavlefshme dhe koha reduktohet drejt fundit.

Në aspektin gjuhësor, përdorimi i një ligjërimi të thjeshtë, pothuajse prozaik, i jep vdekjes një karakter të zakonshëm, duke shmangur patetizmin. Fjalët si “pluhur”, “hije”, “mure” krijojnë një leksik të mbylljes dhe të ngurtësisë, që përforcon idenë e jetës së jetuar në izolim emocional dhe kohor. Koha për të thënë lamtumirë siç pohon poetja përmes vargjeve vjen një ditë. Këto vargje ngërthejnë një reflektim të thellë ekzistencial mbi përkohshmërinë e jetës dhe domosdoshmërinë e ndarjes. *Nuk mund të shijosh nga jeta asgjë/nëse nuk ndahesh nga diçka që dhemb.* (fq. 83)

Dhimbja këtu nuk është dobësi, por provë e lidhjeve të forta që, nëse mbahen gjatë, shndërrohen në mure që izolojnë zemrën dhe mendjen. Vargu i fundit “*Për çfarë jetova?*” e zhvesh individin nga çdo justifikim dhe e vë përballë përgjegjësisë për zgjedhjet e veta, duke e kthyer tekstin në një thirrje për vetëdije, përpara se koha të shndërrohet në një lamtumirë të papritur.

Intermezzo e Popullit të vogël, që qëndron mes *Dashurisë*, *Vdekjes* dhe *Vetmisë* e bën më interesante strukturën e veprës por edhe atë çfarë trajton. Poezitë në këtë sythë vijnë si kohë reflektimi dhe ndërprerjeje në rrjedhën e librit. Tensionet shoqërore ndërthuren, duke

krijuar një dialektikë poetike midis personales dhe kolektives. Poetja dallon pakicat e rralla të liderve shpirtërorë, që udhëheqin me integritet dhe vizion, nga turmat që ndjekin pushtetin pa reflektim. Vargjet godasin të vërteta drithëruese për popullin tonë, drejtuesit e saj, si dhe individin shqiptar. Pavarësisht tematikave të ndryshme që përcillen përmes poezive, prania e mungesës së njeriut të dashur duket se e shoqëron bashkarisht çdo varg të poezisë. Ngjarjet globale renditen si një kronikë e ftohtë faktesh, ku bashkë me këto ndryshime pesha e ikjes së njeriut të dashur rëndon më shumë. Përmes disa poezive në këtë sythë poetja sfidon lexuesin të shohë përtej diskursit zyrtar dhe të dallojë interesin e fshehur pas moralit të shpallur, duke e kthyer reflektimin në një akt demaskimi kritik ndaj hipokrizisë institucionale.

Rroftë politika!

Që në thelb është biznes

Sikurse dhe institucioni fetar,

Po jo aq i sinqertë sa biznesi, që deklarohet i tillë

Që fitimi apo pushtimi i tregjeve është synimi i tij,

Biznesi nuk ka nevojë për maskë,

Sikurse:

Politika – maskë e mirëqenies sociale

Religjioni-maskë e mirëqenies shpirtërore (fq. 122)

Në vargje shpaloset një kritikë e drejtpërdrejtë ndaj strukturave të pushtetit që operojnë përmes maskimit moral. Politika dhe religjioni paraqiten si forma të rafinuara të biznesit, por me një dallim thelbësor: biznesi e pranon hapur interesin e fitimit dhe nuk pretendon shpëtim kolektiv apo shpirtëror. Politika, nën petkun e mirëqenies sociale, dhe religjioni, nën premtimin e paqes

shpirtërore, ndërtojnë legjitimitetin e tyre mbi iluzionin e shërbimit altruist. Kështu, maska shndërrohet në mjet pushteti, ndërsa sinqeriteti i munguar krijon një hendek mes fjalës dhe veprimit.

Vetmia për poeten është *e bukur, e mençur*, është *paqe, liri, refleks, urti*. Ajo e universalizon vetminë, duke e nxjerrë nga kufijtë personalë dhe duke e shtrirë në përmasa kozmike. Vetmia shfaqet si gjendje e ekzistencës, ku njeriu, yjet dhe gjithësia ndajnë të njëjtën heshtje. *Vetmia s’është vetëm e imja/është e njeriut, është e yjeve që shuhën pa emër/e planeteve që rrotullohen pa dëgjues /e gjithësisë që hesht /brenda vetvetes.* (fq. 128)

Në vijim, *Mungesa Universale* shfaqet si gjendje themelore e qenies, që kapërcen kohën, trupin dhe marrëdhëniet konkrete. Përballja mes *Shpirtit* dhe *Trupit*, si tension mes lirisë trupore dhe kufizimeve shoqërore, ku trupi përjetohet si burim kënaqësie dhe ndjeshmërie, por njëkohësisht turpërohet dhe maskohet nga normat morale.

Po pastaj?

Pas çlirimit nga avujt e fërkimi,

Çfarë ndodhi me trupin tënd?

Pastaj më thanë:

Kaq ishte, shko e vishu!

E mbylla trupin e brengosur me zinxhir

Në fustanin pis të zi,

U shndërrova në djallin që vishet me Prada. (fq. 168)

Në epilogun e mbylljes së veprës na shpërfaqen imazhe dhe reflektime mbi ikjen e kohës dhe thirrjen ndaj të rinjve, të cilët duke u përhumur në arrogancën e tyre rinore, harrojnë të kujtohen se vitet ikin dhe jeta është cikël. Në çdo varg poetja kërkon të ndezë ndërgjegjen e të rinjve për të shijuar jetën por pa harruar se rinia nuk zgjatë përgjithmonë. Përmes ironisë së përdorur prekë indiferencën e të rinjve ndaj plakjes. *Na e përplasni në fytyrë arrogancën rinore/ mospërfilljen për moshën tonë të kaluar/ e mos na dëgjoni ne/ që duam vazhdimisht t’ju kujtojmë/ se një ditë do t’ju vijë dhe juve pleqëria.* (fq. 176)

Poezia e fundit e epilgut ndërtohet mbi një ligjërim simbolik, ku përmes simbolikës së tokës, jepet raporti i njeriut me trashëgiminë, kohën dhe humbjen. Poetja e zhvendos vështrimin nga përvoja individuale drejt një reflektimi universal, duke vënë në qendër iluzionin e pronësisë dhe pamundësinë për të ruajtur të paprekur atë që ndërtohet me mund, pasion dhe dashuri. Në këtë kontekst, poezia shfaqet si një meditim mbi përkohshmërinë njerëzore dhe transformimin e pashmangshëm të vlerave nga brezat pasardhës. “*Toka*” nuk është vetëm hapësirë fizike apo pronë materiale; ajo funksionon si metaforë e jetës, identitetit dhe përpjekjes njerëzore. Fëmijët, që janë farat e vazhdimësisë, shfaqen këtu si porta hyrëse e “*të panjohurve*”. Trashëgimia nuk ruan domosdoshmërisht thelbin e origjinës; ajo e transformon, e deformon ose e shkatërron.

Ata shkelin pa teklif në tokën tonë/ mbjellë me farën më të mirë dikur/ disa përpigën ta ruajnë/ por ndryshojnë farat, formën, kufijtë/ disa e lënë djerrë dhe shurrojnë mbi të. (fq. 190)

Në fund, përmes ironisë, poetja na kujton se e vetmja trashëgimi nga ne, do të mbetet veç fotografia.

Dhe do ish vërtet mrekulli/ nëse do ta varnin në mur foton tonë /e vetmja trashëgimi/mbetur prej nesh, do të thonë. (fq. 190)

Mbyllja e Poemës me *Imazhet e Fundit* si reflektim final mbi ciklin e jetës dhe tensionin midis breznive, i lënë lexuesit një hapësirë reflektimi të hapur, ku *mungesa* nuk shuhet, por shndërrohet në *kujtesë* dhe *vetëdije*. “*Toka tani ka aromën tënde dhe të njerëzve të mi të shtrenjtë, që i humba rrugës.*” (fq.191)



Libri “Klithma” është hise e plotë zërash dhe shpirttrash që rrëfejnë, gjymtimin në moshë fëmimore, të personave realë tashmë të rritur. Janë tetë tregime që dëshmojnë një barbari të cilën e kemi hequr prej syve dhe nuk e kemi kthyer në provë tronditëse për pasardhësit dhe për të tjerët. Ky ka qenë realiteti ynë epiko tragjik të cilin ndryshe, duhej t’ua shtonim me kohë provave genocidiste të Serbisë në Kosovë.

“Historia-kjo dinamikë e viktimave”, thotë Emil Cioran, në Kosovë shënon sparagmosin serb jo të hyjnive, por të një regjimi mizor pushtuesi.

Shqiptarët e Kosovës duhet të mbesin vijimësisht në këtë rrekje për ta dëftuar atë histori gjakimesh e gjymtimesh që nuk përjashtoi moshat e vogla, aq më tepër fëmijët.

Rrëfimtaret në këto tregime reale, janë ish fëmijët që në rrethanat e luftës në Kosovë u gjymtuan, ndryshuan jetën e trupave dhe gjymtyrëve të tyre të njoma, por njëkohësisht edhe raportin me jetën vetiake të mëpastajme.

Këto janë histori drithëronjëse, si provë e vonuar për dijen dhe dijeninë e lexuesve, madje edhe për historishkruesit e Luftës në Kosovë.

Në të gjitha faqet e librit “Klithma”, të autores Alketa Gashi Fazliu, si një zë prej providence të kumbon apeli i shenjtë: “Ka gjashtë gjëra që i urren Zoti... duart që derdhin gjak të pafajshëm...”!

Në fjalët e këtij libri kullon dhimbja dhe të zgjohen imazhe të llahtarshme me gjymtime e cungime të forta trupore të fëmijëve që janë në ecje apo në lojnat e tyre. Është fjala për tregime me trupaprerje minorenësh(!). Por jo vetëm kjo tragjedi.

Janë rrëfenja për rënien në humnerat e thella të dëshpërimit, të fundosjes psikologjike dhe më pas, për triumfin e tyre njerëzor. Aty ku rrëfëhet drama dhe tragjedia kurmcopëtuese, njëherësh lartësohet një fisnikëri e pashoqe, jo prej viktimash, por prej triumfalistësh, duke mos mbartur në asnjë skutë të ndërgjegjes dhe psiqikës së tyre, shenjë urrejtjeje apo hakmarrjeje.

“Klithma” është një libër që mbart adresën dhe emrin real të fëmijës që u gjymtua nga shpërthimi barbar që shkaktoi kasaphanë, tek Tregu i Mitrovicës, në 13 mars të 1999. Është historia tragjike e asaj fëmije tashmë të madhuar e cila “gjymtimin e vet e pa, pasi doli nga kllapia”.

Kjo heroinë e pashpallur e kësaj dite marsi, risjell aq qashtërsisht (përmes rrëfimit tek shkrimtarja), episode si në tragjeditë antike apo atyre të luftërave nga letërsia e madhe e njerëzimit, ku pacientja e vogël e gjymtuar, vërrente ushtarakët dhe bishat pushtuese në të njëjtin spital.

Por njëherësh, në këtë libër, mes kohës së fëminisë dhe momentit të të qenit tashmë personazh i rritur, përcillet aq mencurisht dhe aq thukshëm trishtimi i së sotmes, e cila sipas shkrimtares, shenjohej aq domethënëshëm: “Plagosja e shpirtit pas luftime... më e gjatë se dhimbja e plagëve në luftë...”

Ky libër nuk ka vetëm forcën e vlerës dëshmuese apo peshën kuptimore të një artefakti autentik për pasojat dhe barbarinë e pushtuesit mbi civilët dhe kryesisht fëmijët në Kosovë.

Ky libër është antologji sintetike e dhimbjes dhe e ndodhive fëmijëgjymtues.

Rrëfimtaret e tragjedive dhe dramave të tyre janë të gjithë shpirtbukur dhe ngadhënjimtarë fisnikërie.

Njeri prej tyre është vijimësisht në lartësinë e përgjegjësit dhe shërbyesit të shëndetit mendor për fëmijët e vet kur shprehet se: “Fëmijës sim nuk ia rrëfej luftën e fëminisë sime”.

Personazhet realë të librit “Klithma” janë heronj të kohës post-tragjedi, kryelartë në sakrificën e tyre që “jetojnë lirinë me gjysëm trupi e gjysëm zemrë”.

“Klithma”, i autores Alketa Gashi Fazliu

“Klithma”, si dëshmi e krimeve të pagjykuara

Nga Aleksandër Çipa

Drama dhe ndodhitë e jetës së Arben Gurit meritojnë atë sintezë pohuese që shkrimtarja Gashi më së miri e shpreh përmes nëntitullit: “Fjalët që ma çanë zemrën më shumë se shpërthimi i bombës”.

Historitë e personazheve pas tragjedisë trupore, janë tregime mes tregimesh.

Janë tekste të sjella aq thjeshtësisht në stil që të imponojnë përjetim dhe drithërimë. Janë subjekte nga ato jetë që kanë hise kuptimplota heroizmi njerëzor.

Ky është libër i mbijetesës stoike shqiptare në viset e Kosovës.

Në tërësinë e episodeve të këtyre tetë tregimeve reale të befasojnë dhe shkaktajnë emocione e rrënqethje të forta ndjenjat e thella dashurore, dhembshuritë e veçanta shpirtërore, ndiesitë e shumëfishta prindërore dhe në mënyrë të përveçme: ndërlihdhet psikogjenealogjike brenda familjes dhe shoqërisë shqiptare edhe në kohë e mot të një tragjedie si lufta dhe egërsia fatbjerrëse e pushtuesit.

Nga gjendja dhe raporti i sotëm, Atifete Gashi në librin “Klithma” e vetëklasifikon ndodhinë tragjike të fëminisë si “histori filmi”, sepse sikundër rrëfen: “Tragjedia ime familjare nis prej kur isha foshnje e vogël.

Babai im vdiq i ri. Kur isha dy muajshe. Ai ishte 27 vjeç. Unë bebe e

vogël. Motra ime ishte dy vjeçe. Nëna shkoi...na la...ishim vajza të vogla..Na rriti gjyshja. Asaj i thonim mam...”

Mjafton ky pasazh të përfitosh plotësisht perceptimin e një tragjedie që do ta kishte zili çdo regjisor filmash. Sikundër simotër e kësaj tragjedie është edhe risku i fatit ekzistencial në episodin: “Fëmijë në trenin e tmerrit”.

Intensiteti rrëfimtari në këtë libër, përbën një ndër vlerat shkrimore, por shpërfaq edhe sqimën autoriale dhe elegancën letrare të Alketa Gashit. Sjellja në një gjuhë standarte e rrëfimeve bëhet qasje e vetëdijshme kulturore e ndërgjegjeje shkrimore për një perimetër të gjerë leximi në vise e matanëvise të shqipes.

Autorja, përmes një stili të përkorë në thjeshtësinë e vet, ia ka dalë jo vetëm të formësojë një libër ekstrashtanor, por ta sjellë krejt tekstin e librit “Klithma”, si një shkrimtarësi në funksion të memorialistikës faktologjike për çmimin dhe pasojat e Luftës në Kosovë.

Duke zgjedhur ndodhitë dhe tregimet epike mbi një kategori aq divine moshore,

si fëmijët, shkrimtarja e sjell këtë libër imponues si për të ndjeshmit edhe për të pandjeshmit, mjafton që të dytët, të kenë thjesht një zemër dhe mendje.

Të tetë tregimet janë klithmë për fëmijë-vrasjet serbe, në Kosovën e fundviteve ’90-të.

Të tilla klithma, sa tronditëse dhe epike, kanë të gjitha një paskohësi tjetër, të fisme e optimiste si prej heronjsh të heshtur. Janë si në kumtin e vargut të Visar Zhitit tek libri i tij “Dritë që ecën zbathur”: “Sa jetë ka edhe pas jetës...”

Këtë të vërtetë, vijueshmërisht në ndodhje, autorja e sjell si pohim të vetë heroit real të saj:

“Do të jetoj bukur, edhe pse përgjysëm”.

Sepse të gjithë rrëfyesit e pazakontë në këtë libër janë shpirtgjerë dhe me një barrë përgjegjësie të aq shpeshdëshmuar për prindërit, vëllezërit e motrat, bashkëfëmijët si dhe për pasardhësit e tyre, në kohën dhe jetën e mëtejshme, pas gjymtimit.

“Klithma” nuk është libër me rënkime dhe lëngata fatale. Është një vepër me peshë rrëfimesh, por gjithashtu edhe kumtesh, edhe refleksionesh. Personazhet realë janë qytetarë sokratikë që dhimbat dhe plagët e lirisë i mbartin ndoshta ende në trisht si të luftës.

Përballja e tyre me sfidat sociale dhe psikologjike është madhështi dhe heroizëm qytetar. Dëshmohen si mirënjohës dhe urtakë mendjefortë, si ngadhënjimtarë të dramave sociale, të mospasjes dhe të pengimit paragjykues në jo pak raste. Jeta e tyre është e tillë që të mban në asosacione hygojane për nga kontrastet dhe zinxhiri i dramave pasuese. Ata janë naratorë të fismë të kalvareve të tyre në dy kohë: atë të luftës dhe të pasluftës.

Të gjithë rrëfimtaret e zgjedhur për në tekstin e këtij libri, janë autorë të epitafit të bukur e kumtimtar të jetës së tyre kalvarike.

Në pjesën epiloguese të librit, rrëfimi për “Rrobat e fshehura nën dhe, artefakti i vetëm nga e kaluara”, ka vlerën potenciale të një dëshmie që do të impononte çdo gjykatë dhe prokurori për të hapur hetime dhe procesin e pashmangshëm të hetimit të krimit, të spastrimit dhe genocidit barbar.

Sikundër e tillë edhe historia e Burim Përteshit për “rrëmbimin e burrave pas disa arrative të lodhshme” në atë korrik të 1986 në Duhle të Suharekës (Therandë), apo për: “Bunarën e tragjedisë së 11 jetëve të ndërprera”.

Autorja e këtij libri e di fort mirë se “shenjtëria shkakton drithërima”, prandaj i ka qëmtuar tetë tregime për librin “Klithma”, në emër të një të vërtete dhe të drejte kombëtare shqiptare që nuk lipset të harrohet e të humbasë.

Sikundër klithma maksimalizon vëmendjen njerëzore edhe ky libër, me këtë titull dhe lëndën e tij, na mëson të fiksohemi tek ajo kohë e tragjedisë dhe dramave që shkaktuan pushtuesit e dëbuar.


Barbarët në atë luftë copëtuan dhe gjakuan fëmijë të cilët në kohën e lirisë jetojnë dramën si invalidë dhe mungesa, por tashmë si të rritur.

“Klithma” si libër, nuk është vetëm për atë të shkuar, por në rastin e personazheve të gjetur prej autores, ka vlerën e asaj që ka pohuar Milan Kundera: “...si akt rezistence”.

Duke rikthyer me vetërrëfim personazhesh realë, atë që ka ndodhur, Alketa Gashi Fazliu ekspozon në sytë, në mendjen dhe ndërgjegjen tonë si lexues, dinjitetin dhe historinë e tyre.

Me talent ia ka arritur të evidentojë si faktmbledhëse, pamundësinë e tragjedive të këtyre ish fëmijëve për ta çrrënjosur njeriun nga vetja e tyre.

Rrëfimi në këtë formë shkrimore i atyre ndodhive të ferrta, është mënyrë autentike për të mos humbur vetëdijen tonë historike ndaj gjakimit dhe gjymtimeve që shkaktuan me tepëri pushtuesit dhe lukunitë e tij, në akte pentheniane mbi fëmijët e tokës shqiptare.



Në vijim të një tradite të çmuar në terrenet të poezisë, shkolla kosovare e vargjeve të mahnit me prurjet e herë pas hershme dhe me arkitekturën poetike që ajo përcjell te lexuesi. Do të qe vëllimi “Re prej drite”, universi i cili më njohu me shkrimtarin dhe poetin Ndue Ukaj. Pas atij vëllimi, disa sprova në prozë dhe së fundi, “Mund të jetë si në fillimet e kohëve”, përmbledhja me poezi që shënoi fundvitin që sapo iku.

Ky artikull, që paraqitet si më poshtë, ka si synim të ofrojë për lexuesin një panoramë reflektive pikërisht mbi vëllimin në fjalë, pra “Mund të jetë si në fillimet e kohëve” (Onufri, 2025). Janë përzgjedhur disa poezi të cilat për mua si lexues kanë shënuar jo vetëm kompleksin poetik, por edhe frymëzimin tek unë. Para se të përshtjellojmë shembujt konkretë, doja të perifrazoja N. Frye (*Anatomy of criticism*) (autor të cilin do e citojmë përsëri më poshtë) sipas të cilit, poezia shërben si arkiv i imagjinatës kolektive. Kjo do të thotë që poezia pra pasqyron realitetin shoqëror, politik dhe historik të kohës kur është shkruar. Gjithashtu, studimi i saj do të japë kahe të reja në kuptimin e historisë dhe identitetit kombëtar.

“Mund të jetë si në fillimet e kohëve”

Poezia në fjalë përkon me brendësinë e kreut të parë, “Mësimet e vona”. Që në krye të saj, poezia na përball me një realitet tjetër, me një kohë të re, pse jo, me një kohë **mitike**. Ky shembull më së miri lidhet me atë *kohën e shenjtë* të M. Eliade, pra një rikthim të plotë në kohën e gjenezës. Vetë dita e re është një fillim, një nisje e re ontologjike. Po ashtu, këtë gjendje, e shpall në mënyrë të saktë edhe vargu “Sot është ditë e re dhe mund të jetë si...”

Dy simbolika krejt të kudondodhura në poezi janë qielli dhe drita. Madje **qielli** shfaqet edhe si simbol qendror duke marrë mbi vete karakteristika të *kthjellëta*, të *bukura* apo edhe si i lidhur me sytë, zemrën apo kërkimin e vazhdueshëm. Në poezi qielli mund të shihet si një hapësirë e brendshme, jo dekor estetik, por ai koncept sipas të cilit G. Bachelard, tregon zgjerimin e ndërgjegjes individuale.

Ndër mendimet e tij, Albert Camus hipotetizon se rebelimi më i pastër është ruajtja e ndjeshmërisë njerëzore në një shoqëri, në një botë që ka premisa për ta shtypur atë. Në këtë moment, poeti na paraqet mendimin e radhës, sa etik aq edhe ekzistencial, teksa shprehet “Ti mos lejo askënd ta ngulfatë bulëzimin e zemrës sate.” Nuk mund të jetë naiviteti një buzëqeshje e zemrës, por një akt i shpallur rezistence.

Për t’u rikthyer sërish tek fillimi, autori na parashtron një simbol pastrimi, një katarsis apo një proces të tillë tek vargu “Ky mëngjes i bardhë si bora”. Po sipas Frye, tek poezia lirike, e bardha mund të pranohet si simbol i fillimit, i pafajësisë apo edhe i mundësisë për një korrigjim të vetvetes. Duke hequr dorë nga imazhet e errëta apo nga ëndrrat e zeza, autori na përgatit një proces katarsis për gjithë ç’ka është e kaluar.

Ringjallja, rifillimi, e tani krejt i prekshëm, duke u larguar nga abstraktja, na paraqitet tek vargu “... në një kopsht të bukur ku gjithçka mund të kthehet pranverë...” Që nga Bibla e deri te poezia e ditëve të sotme, koncepti i kopshtit mbetet një nga arketipat më universale. Të gjithë elementet e brendshëm aty jetojnë të harmonizuar. Akoma më tej, autori e mishëron idenë duke mos e lënë atë abstrakte por e bën të prekshme kur thotë “... si duart e një dashurie përvëluese.” Poezia, edhe në mbyllje të saj, qëndron tek një frymë lirizmi reflektiv, me qëllim vetëdijen dhe shërimin ndërsa mbyllet me vargjet “Se një ditë e re është njëlloj përsëdytje e krijimit,/ ku ti mund të krijosh gjithçka të bukur,/ gjithçka të bukur që nuk ka ndodhur më parë,/ dhe nuk ka mundësi të përsëritet kurrë më si atë ditë.”

“Ars poetica”

Të tilla poezi si kjo që vijon, nuk janë vetëm një vijimësi e trashëgimisë që na

Reflektime mbi vëllimin “Mund të jetë si në fillimet e kohëve” (Onufri, 2025)

Poezia që na kujton fillimin: Ndue Ukaj dhe koha e parë

Nga Rei F. Hodo

mbërrin që prej Horacit, Boileaut apo Verlain. Ato janë shembuj konkretë për të kuptuar jo vetëm artin e poezisë por edhe pse ky art është sa i domosdoshëm aq edhe i rrezikshëm njëkohësisht. O. Paz shprehet se të tilla poezi janë momente reflektimi të poezisë për poezinë.

Poezia hapet me vargun “Arti nuk mund të shpëtojë jetë” i cili pikërisht artin e vendos në konturet jo të shërimit të trupit por të ndriçimit të zgjedhjes. Rëndësia e këtij vargu ka të bëjë me shmangien që ai i bën sentimentales së artit. Poezia apo arti, edhe sipas Th. Adornos, nuk shihet si moralizues d he s’mund të ketë funksionin praktik të shpëtimtarit. Poeti i shton udhët jetës, i jep orientim dhe i rikthen njerëzit tek vetëdija e tyre. Poezia u jep njerëzve **sy për të parë e zemër për të mos u përulur**. Pra, autori na jep mundësinë e zbulesës të të vërtetës, ai nuk e fshin realitetin, por e çliron atë nga errësira. Vetë vargu “sy të shohin në terr” është qëndresa për njohje dhe jo një metaforë e thjeshtë dëshpërimi.

Më tej na paraqitet vargu “Lirinë të mos e depozitojmë nëpër korniza”. Këtë mund ta shohim si një kritikë të qartë ndaj normave

shoqërore, ndaj kufizimeve ideologjike apo edhe etiketimeve të gatshme. Poezia është një hapësirë e papërthithshme, ajo nuk mund të mjaftohet me vetëm funksionimin e saj por shndërrohet në një hapësirë refuzimi estetik ndaj sistemit në tërësi.

Një moment kulmor në poezi është vargu “Arti ka edhe diçka të rrezikshme” Fare mirë, ky pohim krejtësisht modern vjen dhe rezonon me Platonin, i cili e dëbonte poetin nga republika vetëm sepse arti e ka fuqinë ta trazojë rendin e vendosur. Megjithatë, në rastin tonë, rrezikshmëria është virtut dhe jo problem.

“Ars poetica” nuk e mohon errësirën. Ajo e sheh dhe e pranon si terrin që josh, si zemrën ku mungon drita ashtu edhe vetë errësirën e dendur. Dhënia formë të vërtetës, mos zbukurimi i saj përbën atë që G. Lukács e njeh si realizëm etik. Arti nuk mund të gënjejë, as të zbukurojë.

Dy momente krejt kulmore janë edhe empatia morale dhe leximi tragjik i historisë. Në poezi dallojmë një zbritje nga koncepti abstrakt tek ai praktik, trupor: duar që prekin, mërzia si dallgë apo zemra që dridhen. Gjithashtu, figura e turmës që marshon drejt

kryqëzimit është e gjetur. Ajo na paraqet një indiferencë morale, një përsëritje të dhunës apo edhe një verbëri kolektive.

Poezia, krejt reflektive dhe e pjekur, e cila artin e vendos si një mjet vetëdijeje, rreziku apo lirie mbyllet me vargjet: “Poezia të bën ëndërrimtar, kërkues, krijues,/ se arti është rruzullim më vete,/ të nxit të provosh udhët e harruara,/ të zhytesh në pyllin e dëshirave/ e të mbledhësh fijet e të gjithave/ për të bërë një kurore të artë jete.”

“Njeriu i propagandës”

Një poezi tërësisht e fortë, historiko-politike dhe që katërcipërisht mund të shërbejë si kujtesë kolektive dhe si një thirrje e brendshme për vetëdijen kritike është pikërisht “Njeriu i propagandës”. Autori na paralajmëron se historia rrezikon të përsëritet dhe se pikërisht **njeriu i ri** krijohet nga pjesët më të egra të historisë.

Si temë kryesore e kësaj poezie mund të shihet shndërrimi i qenies në produkt të propagandës, dehumanizimi i njeriut prej dhe përmes propagandës. Jo vetëm në koncept, por edhe në poezi, propaganda shfaqet si forca ndër kryesoret që e deformon të vërtetën, krijon shoqërinë e manipulueshme dhe zhduk ndjeshmërinë humane. Kuptohet se tashmë **e vërteta** nuk është më një vlerë morale, por është arma e re për dominim dhe kjo na paraqitet në vargjet “Ai trillon të vërtetat e veta/ dhe ato i përdor si shkopinj gjuetie.” Në këtë moment na vjen në ndihmë po ashtu edhe mendimi i H. Arendt (*The origins of totalitarianism*) sipas së cilës, propaganda është arma e cila synon shkatërrimin e aftësisë për të dalluar të vërtetën nga gënjeshtra.

Gjithashtu, në poezi udha mund të na sjellë para edhe logjikën e përmbysur morale apo thënë ndryshe ajo për të cilën edhe G. Orwell (*Politics and English language*) flet lidhur me përdorimin e gjuhës si mjetin efikas për fshehjen e përgjegjësisë morale dhe manipulimin e realitetit. Vargjet “Ai ka mësuar si ta bëjë tjetrin fajtor/ kur tjetri nuk ka lidhje me fajin.” na tregojnë se si subjekt kemi të bëjmë me një qenie të formuar nga gënjeshtra, dhuna dhe manipulimi historik. Ai ka aftësinë ta fajësojë tjetrin edhe kur ky i fundit nuk ka asnjë lidhje me fajin.

Kjo poezi bëhet edhe më e veçantë për sa kohë ajo merr një ton prej dëshmitari personal. Autori e shndërron poezinë në zërin e tij si dëshmitar të tragjedisë historike dhe shoqërore ndërsa thotë se “Kam parë zvetënimin e njeriut,/ kalldrëmet e mbuluara me gjak.” Letërsia pas traumave të shkaktuara nga historia kthehet në një akt dëshmie dhe kujtese, sidomos nëse marrim parasysht përvojën ballkanike kolektive të fundshekullit të XX-të.

Michel Foucault (*Discipline and punish*) na flet për një mënyrë se si ia del pushteti të prodhojë subjekte përmes disiplinimit dhe kontrollit të rreptë të tij. Këtë mendim mund ta gjejmë të jetëzuar tek vargjet “... janë krijuar laboratorët e frikës,/ ku shartohet njeriu/ dhe krijohet njeriu i ri” dhe ku shprehja **laboratorët e frikës** vjen si metaforë e fuqishme e cila simbolizon krijimin me qëllim të terrorit. Janë ideologjitë totalitare ato të cilat kanë si synim krijimin e një identiteti të ri, edhe artificial.

Patriotizmin e rremë po ashtu, pse jo edhe të denoncuar nga autori, e gjejmë në vargjet “Kam parë njeriun e propagandës/ si ka asfiksuar atdheun.” Në emër të atdheut, edhe vetë ai shkatërrohet.

“Krijimi”

Jo më kot e zgjedha këtë poezi për të përmbyllur grupin e poezive të shqyrtuara sepse si temë kryesore të saj shohim procesin e krijimit si ndër më domethënësit në jetë. Jo vetëm si një veprim apo akt artistik por si nevojë ekzistenciale.

Të krijuarit na shfaqet si një kundërvënie ndaj harresës, ndaj zbrazëtisë. Ai vjen si një mënyrë për të shpëtuar jetën nga një lloj shuarje, edhe pse simbolike. “Të krijosh



OnufriPoezi

domethënë të zgjasësh kohën,/ të luftosh harresën,/ të ripërtërish jetën”. Është pikërisht vetë kuptimi i jetës që krijohet përmes përgjegjësisë, përjetimit apo përmes veprimit.

Për poetin, koha nuk është thjesht lineare. Ajo përjetohet përmes procesit të krijimit dhe si e tillë, vetë njeriu rilind në përmasa të reja kohore e shpirtërore. Koha mbetet një përjetim i brendshëm dhe jo një matje mekanike, sipas H. Bergson (*Time and free will*). Këtë e dallojmë në vargjet si vijojnë: “Të krijosh domethënë të fitosh kohë,/ të futesh në tunele të jetës dhe të dalësh prej tyre/ në një kohë tjetër.”

Një figurë domethënëse në poezi del edhe **mozaiku**. Ai simbolizon jetën të thyer në copa përvoje, kujtese apo dhembjeje. “... të mbledhësh thërmmija/ e copëza të thyera jete/ dhe t’i shndërrosh në një mozaik plot ngjyra.” Thënë ndryshe, edhe pse këto copëza, këto fragmente jete nuk mohohen, krijimi shërben si akti i shërimit të tyre, duke u rindërtuar në një tërësi më kuptimplote.

Empatia dhe imagjinata luajnë rol në poezi. Pra, krijimi është proces që shkon përtej vetvetes, lidhet me tjetrin dhe dhembjen e këtij të fundit rreket jo vetëm ta ndiejë por ta kthejë në kuptim. “... të kapësh me duar zemrat e plagosura,/ zemrat e dashuruara, t’i shtrydhësh dëshirat e tyre/ dhe me to të krijosh një vals të gjatë ekzistence.”

Një tjetër moment kyç është në poezi është edhe pranimi i gabimit. Kjo nënkupton se akti i krijimit nuk mjaftohet vetëm me idealizimin e vetë poetit, por edhe me pjekurinë morale të tij. Vetvetja është qenie që ndërtohet përmes zgjedhjeve dhe vetë përgjegjësisë (*S. Kierkegaard*) e kjo shfaqet në vargjet si vijon: “Të krijosh domethënë ta ribësh veten tënde:/ t’i mbledhësh gabimet dhe çastet e lumturisë me duart e tua.” Nga ana tjetër, kjo vete nuk mund të romantizohet, por kalon përmes vështirësive dhe rrezikut të dhembjes: “Të mësosh se në jetë ka ngjitje maleve të larta,/ rrëshqitje teposhtë, ku të presin tufa të egra që të ndjekin/ me gozhdët e ndryshkura të urrejtjes.”

Si rezultat Ndue Ukaj nuk mbetet autori individualist i cili e kufizon krijimtarinë e tij brenda vetes. Ai, jo vetëm me vëllimin “Mund të jetë si në fillimet e kohëve” por me gjithë opusin e tij letrar konsiderohet një zë aktiv i një tradite me themele të forta, që vazhdon të flasë me zë të ulët, por këmbëngulës.


Kjo traditë, e formuar në një tension të vazhdueshëm duke u gjendur herë midis traumës kolektive, herë midis historisë e herë midis kërkimit të domethënies njerëzore mbetet zëri më i ndërgjegjshëm e më kritik i shkollës kosovare të poezisë. Në këto linja mendimi, edhe autori ynë na shfaqet si poet i një reflektimi të thellë, një veprimtar që nuk i ikën dhembjes historike dhe as përgjegjësisë morale që ka fjala e arti.

Ndue Ukaj e konsideron poezinë si një hapësirë për rezistencë. Fjala për të nuk mund të jetë në rehati, por në lëvizje të vazhdueshme. Në poezinë e tij, ai e shmang atë ndienjë të thjeshtuar të retorikës apo nacionalizmin banal; gjithë aktin e tij të krijimit e përqendron tek njeriu si qenie etike dhe e brishtë, e cila kurdoherë është e ekspozuar ndaj pushteteve dhe egërsisë së tyre.

Në një kohë si e sotmja, ku gjithçka është duke u marginalizuar nga një ritëm tmerrësisht i shpejtë i teknologjisë dhe nga bota virtuale, vepra e Ndue Ukajt mbetet një dëshmitare e fortë se poezia dhe arti mbetet një nevojë thelbësore e qenies humane. Poezia dhe letërsia janë ndihmuesit kryesorë të ruajtjes së kujtesës historike dhe të formimit të një ndjenje empatie kolektive dhe vetëdijeje kritike. Pa këto të fundit, çdo shoqëri rrezikon të përfundojë në banalitet, manipulim dhe një propagandë simbolike. Poezia na kujton se fjala e vërtetë mbetet ndër format më të pastra të përballjes me veten dhe me të vërtetën, në kohën e krizës së fjalës dhe vlerës.

‘Veç drita s’paska mbarim’: Fryma profetike dhe testamenti letrar nga Zef Zorba tek Zorbnesha e re”

Nga Eduart Bardhi



Perceptimi i dritës në letërsinë moderne shqipe është i lidhur ngushtë me ndërlidhjen e kohës dhe kujtesës, *ku drita shfaqet si një rrugë drejt të së kaluarës së përjetuar në mënyrë të përjetshme*.¹Në këtë plan, drita shfaqet si një prani që sfidon kohën, përtej përfundimit dhe rrënimit, përtej dekadencës së njeriut dhe dhunës së historisë. **“Veç drita s’ka mbarim”** është një tezë ekzistenciale, pohim se në fund të çdo historie, përtej çdo pushteti, mbetet drita si shenjë e jetës, e artit dhe e shpirtit që nuk shterohet kurrë, *me këtë varg, merr frymë profecia e lirikut Zef Zorba...* Ky varg përbën testamentin letrar që poeti i la së bijës, Zorbneshës së re, Luçija Zorba Kalaj. Autorja në fjalë e ka marrë këtë sinjal profetik nga i ati dhe e ka shënjuar në pelegrinazhin e saj krijues përmes spiritusit titullor **“Veç drita s’paska mbarim”**. Që në titull, autorja indikon një bosht themelor kuptimor që përshkon të gjithë veprën: dritën si element të pashtershëm. “Drita” shfaqet këtu si një metaforë polisemike, e cila funksionon njëkohësisht si shenjë e shpresës, e vetëdijes, e besimit dhe e kujtesës. Në këtë mënyrë, vepra radhitet në atë prirej estetikë që në studimet letrare është konceptuar *“letërsia si kujtesë”*.² **Çdo lexim i letërsisë është një akt i kujtesës. Historia e letërsisë mund të konsiderohet**

si një sistem i gjerë i kujtesës kulturore, që ruan, përpunon dhe ritransmeton përvojat njerëzore të shprehura në formën estetike të fjalës. Historia e letërsisë funksionon si një sistem kompleks dhe sistematik i kujtesës, i cili përfshin dimensionin individual dhe atë kolektiv. Me këtë vepër, përmes një përshkrimi peizazhist që shkrin kujtesën vetjake me atë kolektive, vihet në qendër të vëmendjes Shkodra, e paraqitur me finesën dhe elegancën e saj, si dhe me rolin e saj si djep kulturor që ajo padronon mbi supe.

Kujtesa është e kaluara që vazhdon të jetojë në të tashmen – ky është raporti ekzistencial dhe historik *ndërmjet kohës dhe subjektit*.³ Ajo që ndodh është vetëm ajo që mbahet mend; kjo na çon drejt natyrës dramatike të marrëdhënies mes Kujtesës dhe Harresës. Në këtë përballje simbolike, kujtesa kërkon të ruajë një vazhdimësi identitare, ndërsa harresa rrezikon ta ndërpresë atë. Nëse marrim me mend se “e tashmja” mund të përfytyrohet si kujtesa e “të ardhmes”, atëherë shtrohet një raport tjetër i ngjeshur, ai *midis Kujtesës dhe Imagjinatës*, bijës së saj ilegjitime, e cila shfaqet *herë si mbështetje e procesit letrar*⁴, herë si djep i fantazisë letrare. Rrjedhimisht, *Zorba e re* rikujton pikërisht ato ngjarje që kanë lënë gjurmë përcaktuese në jetën e saj. Vlen të theksohet se e bija e Zorbës zotëron

një kujtesë të hekurt, çka dëshmohet nga ruajtja e hollësishme e detajeve dhe nga inkorporimi i tyre në tekst, duke e ngritur veprën në një nivel të veçantë originaliteti. Kësisoj, autorja na ofron një vepër me theks të fortë autobiografik. Ajo nuk heziton të artikulojë disa të vërteta dopjo (pa rezerva), shpeshherë të dhimbshme, që lidhen me jetën e saj, familjen dhe rrethin shoqëror. Kujtesa paraqitet si një proces dinamik, ku episodet përjetojnë intensitete emocionale të ndryshme, të shoqëruara nga shpërthime narrative, por gjithnjë të menaxhuara përmes një ndjeshmërie të rafinuar stilistike. Përshkrimi i qytetit të Shkodrës dhe i hapësirave të tij urbane ndërtohet përmes ndërthurjes së përvojës individuale me memoriën kolektive, duke pasur si pikënisje fëmijërinë dhe duke u zhvilluar në mënyrë asociative. Rrjedha narrative shfaq tipare të asaj që mund të quhet *“kujtesë në varg”*, ku një imazh evokon tjetrin në mënyrë spontane dhe jo-lineare. Personazhet e paraqitura janë referencialisht real; disa prej tyre identifikohen me emra konkretë, ndërsa të tjerë mbeten të paemërtuar, si rezultat i një zgjedhjeje autoriale. Vepra shquhet gjithashtu për praninë e një humori elegant dhe fin, i cili funksionon si mekanizëm stilistik që e pranveron rrëfimin. Në rreshtat e kësaj vepre evidentohet qartë lidhja e ngushtë emocionale dhe shpirtërore e Zorbneshës së re me të atin, Zef Zorba, e cila shfaqet si një marrëdhënie themelore në ndërtimin e subjektivitetit autoral dhe të diskursit kujtimor. Zorba synon të rrëfejë historinë e jetës së tij, duke nënvizuar rolin e pazëvendësueshëm që dritat kanë pasur në këtë rrugëtim. Dritat, si prani të heshtura por të fuqishme, i janë qasur poetit në çaste të ndryshme të jetës, ndërsa ai, me një ndjeshmëri të rrallë, u është kthyer me vëmendje, përkushtim dhe emocion të pastër, *e njëjta dritë që na lejon të shohim botën jashtë, është ajo që ndriçon rrugën e shpirtit drejt të vërtetës*⁵, nga konteksti i veprës duket se edhe e bija aspiron të ndjekë rrugën dhe të njëjtat gjurmë si i ati. Në diskursin narrativ përfshihen episode nga fëmijëria e autores, si lojërat me kuklla dhe lodra të ardhura nga jashtë vendit, përvojat shkollore, raporti me piktorin dhe figurën e piktorit, kujdesi për qenushin e saj, pema pranë oborrit familjar, si edhe pusi venecian, të cilat funksionojnë si topoi të kujtesës personale. Paralelisht, në tekst përmenden figura që kanë ndikuar drejtpërdrejt në jetën dhe veprimtarinë poetike të Zef Zorbës, duke krijuar një rrjet referencial kulturor dhe intelektual. Ndër to veçohen kompozitori Prenk Jakova, Ernest Përdoda, Kol Kurti, martiri Gjon Shllaku, Stefan Çapaliku, si dhe studiuesja Viola Isufaj, e cila angazhohet në përgatitjen e një monografie kushtuar Zef Zorbës. Këto përmendje e zgjerojnë horizontin e veprës nga autobiografia individuale drejt një kujtese kulturore më të gjerë.

Rrëfimi do të përmbyllet me një **Post Scriptum**, që Zorbnesha ia kushton bashkëshortit të saj të ndjerë, Paulinit. Në këtë pjesë, ajo rikthen kujtimet e saj nga SHBA-ja, shkrimet, përkthimet dhe vargjet – themeli i padukshëm i historis. Për autoren, humbja e Paulinit përfaqëson një motiv të rëndësishëm që e ka shtyrë të mësojë tastierën përmendësh, duke tejkaluar kufizimet e pamundësisë së shikimit, dhe të realizojë veprën që aktualisht është në dispozicion të lexuesve. Jam i bindur se Paulini ka lexuar çdo rresht, varg, rrokje e shkronjë, para se ky botim të dilte në dritë. Artikullin dua ta mbyll me fjalinë e fundit që autorja ka shkruar: *“... e bindur, Pal, se edhe pak vite na ndajnë prej kohës kur do të lexojmë së bashku!”*

1 Ilir Shyta, Drita në kontekstin poetik të letërsisë moderne shqipe. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, 2008, f. 54.

2 Emërtimi i Konferencës Shkencore Ndërkombëtare në përkujtim të Martin Camaj. Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Studime albanologjike: Letërsia si kujtesë, In memoriam Martin Camaj, 2017.

3 Paul Ricoeur, *Memory, History, Forgetting*. Trans. Kathleen Blamey and David Pellauer. Chicago: University of Chicago Press. 2004.

4 Jan Assmann, *Cultural Memory and Early Civilization: Writing, Remembrance, and Political Imagination*. Cambridge: Cambridge University Press, 2011.

5 Platoni, *Republika* (Përkthyer nga A. Hoxha). Tiranë: Toena, 2010.

Librat e artit janë tërheqës. Ata janë të bukuri. Ata janë plot të papritura, pasi figura e veprës së artit apo ilustrimet siç tentojmë t'i quajmë të çojnë në mjedisë të ndryshme, që askurr më parë nuk keni qenë, si dhe brendia e teksteve të bënë të lundrosh në mjediset e ideve të pafundme. Në libraritë e kudondodhura në botë ato janë të vendosura në një seksion më vete. Ata janë libra të shtrenjtë, sepse prodhimi i tyre kushton dhe kostoja përcaktohet nga skuadra që punon për të organizuar një libër të tillë. Dhe skuadra ka në përbërjen e saj dhjetëra specialistë, ku kryeson krijimtaria e artistit. Nëse njëri prej tyre mungon libri mbetet i parealizuar. Sëbashku punojnë studiuesit dhe historianët e artit; redaktorët dhe korektorët si njohësit e mrekullueshëm të gjuhës, fotografët dhe teknikienët dizajner, të cilët duket se luajnë me formatet dhe mënyrat kompozicionale të çdo faqeje të librit të artit; letra, specialistët e ngjyrave, ata të makinave të shtypit dhe duarartët e qepjes së fashikujve prekin të parët magjinë e librit të artit. Libra të tillë shtypen me mijëra, por sasia e titujve të tyre është e pakët.

Një nga më të fundit është “Historia e novelës shqiptare dhe karikaturës shqiptare”. Ai është një libër studimor shumë i mirë dhe absolutisht i vlefshëm dhe i domosdoshëm për studimet shqiptare dhe ato të huaja mbi zhanrin e novelës grafike dhe karikaturës të realizuara nga artistë shqiptarë dhe të huaj, si dhe nga artistë të huaj, novelat grafike dhe karikaturat e të cilëve kanë subjekte dhe personazhe shqiptare. Ky është një libër i parë i këtij lloji, ku janë përfshirë thuajse të gjitha novelat grafike. Dy cilësitë e lartëpërmendura venë në dukje dhe rëndësinë e librit. Së pari libri “Historia e novelës grafike dhe karikaturës shqiptare” është një libër i suksesshëm studimor. Suksesi në tij e kanë siguruar:

Puna e madhe e kërkimeve në arkiva e biblioteka, punë e cila ka kërkuar kohë fizike të gjatë, hulumtime vit pas viti mbi revista, gazeta e libra, lexime dhe mbajtje shënimesh intensive mbi faktet e gjetura në organe botuese.

Puna e madhe në grumbullimin e sistemit e novelave grafike dhe karikaturave, fakteve historike, estetike, ideologjike dhe politike që kanë bërë të mundur të krijohen veprat e artit që përfshijnë këto dy gjini, titujve të tyre, imazheve dhe artistëve që i kanë krijuar.

Puna e madhe në gjurmimin e fakteve paralele, që lidhen me datat historike, ngjarjet dhe fenomenet historike, me politikën, ideologjinë dhe kulturën e periudhave të ndryshme, që shtrihen gjatë periudhës nga fundi i shekullit XIX deri në vitin 2014. Kjo është periudha mbi të cilën autori ka gjurmuar në brendësi të fakteve të rënditura brenda saj.

Libri studimor “Historia e novelës grafike dhe karikaturës shqiptare” është shumë i rëndësishëm **pasi subjekti i tij është shterues mbi zhanret e novelës grafike dhe karikaturës**, që do të thotë se studiuesi ka përfshirë pothuajse të gjithë dokumentacionin faktik si në imazhe ashtu dhe në tekste që lidhen me novelën grafike dhe thuajse me karikaturën. Përpos metodës didaktike, tradicionale të radhitjes së fakteve dhe ngjajeve, metodës së përshkrimit, asaj të vlerësimit, në shumë raste gjejmë të përdorur metodën e krahasimit, metodë shumë tërheqëse në studimet mbi veprën e artit dhe botkuptimit të artistëve.

Subjekti i këtij libri është shumë i **kuptueshëm sepse** është ndërtuar në

(Mbi librin studimor të artit me titull: “Historia e novelës grafike dhe karikaturës shqiptare”, i autorit Dr. Oltsen Gripshi)

STUDIMOR, I VEÇANTË DHE I DOMOSDOSHËM

Nga Suzana Varvarica Kuka

7 krerë, që bëhen të ditur nga titujt, të cilët lidhen me përmbajtjen kryesore të çdo njërit prej tyre. Në brendësi të krerëve shtjellohen në mënyrë të qartë dhjetëra segmente historike që lidhen me imazhin e krijuar, mesazhin që ai transmeton dhe qëllimin pse janë realizuar. Gjithashtu janë evidentuar artistët krijues në periudha të ndryshme dhe mbi të gjitha autori ka mbajtur qëndrim kritik, vlerësues dhe estetik mbi kohën historike, mbi personazhet dhe ngjarjet historike, që trajtohen në secilën novelë grafike dhe karikaturë. Vështrimi mbi produktin studimor të krerëve zbulon se:

Në kreun e parë i është dhënë vend njohjes me karakteristikave të novelës grafike. Në kreun e dytë, autori shteron tërësinë e mendimeve të tij mbi metodologjinë që përdoret për të krijuar novelën grafike, mbi gjuhën specifike dhe rregullat e “gramatikës” së imazhit dhe tekstit, dy elemente bazë të zhvillimit të tyre. Në kreun e tretë zë vend historia e novelës grafike botërore, kryesisht në SHBA dhe Europë si dhe lindja e përcaktimeve si: comics, fumetto, dessin anime, karikatur, dibujos animados, të cilat të gjitha përkthehen në terminologjinë: novela grafike, e cila e shënoi lindjen e saj me 5 maj 1895 në SHBA. Në Kreun e katërt zhvillohet një temë përtej se interesante, e cila i përket novelës grafike dhe karikaturës së huaj, që

nis nga fundi i shekullit XIX e vijoi përgjatë gjithë shekullit XX. Ato janë realizuar të gjitha nga autorë të huaj. Në qendër të subjekteve të tyre janë ngjarje që lidhen me Shqipërinë, shqiptarët, periudhën e mbretit Zog I, Nënë Tereza, Aleksandri i Madh, Gjergj Kastrioti dhe përshkrime të mrekullueshme të jetës, zakoneve, kostumeve dhe bukurisë tipologjike të shtatit trupor të shqiptarëve.

Kreu i pestë është kreu më i gjatë, pasi trajtohen të gjitha problematikat mbi novelën grafike dhe karikaturën të zhvilluara në Shqipëri gjatë gjithë shekullit XX. Është një nga pjesët më domethënëse të këtij libri studimor, pasi e vendos në linjë historike si zhvillimin estetik e artistik të formës dhe personazheve të këtyre gjinive ashtu dhe metodën e realizmit socialist, i cili në një mënyrë apo në një tjetër i përdori si nolevën grafike ashtu dhe karikaturën për interes të propagandës ideologjike dhe edukimit komunist të fëmijëve, rinisë dhe popullsisë shqiptare. Autori në këtë pjesë arrin të zbërthejë thelbin e këtij përdorimi duke u shprehur qartë për rolin dhe funksionin e revistave Yllka, Fatosi, Pionieri, Hosteni, Ylli etj.. Ai sjell datat e sakta të botimeve të tyre, emra të artistëve që kontribuan ethshëm, si dhe përshkrime mbi çdo novelë grafike apo karikaturë, duke u shprehur edhe mbi arritjet estetike për secilën prej tyre. Autori mban qëndrim korrekt ndaj personalitetit



dhe krijimtarisë së çdo artisti dhe zbulon se artistët më në zë të pikturës, skulpturës dhe kinematografisë shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX kanë qenë edhe artistët më në zë të krijimit të novelave grafike dhe karikaturave.

Në mesin e gjithë prurjeve të këtij kreu është me shumë interes qëndrimi i autorit në ato novela, ku bëhet një referim paralel mbi marrëdhënien ideologjike të veprimtarisë së heroit kombëtar Gjergj Kastrioti dhe Enver Hoxhës, ku ky i fundit ndërtoi në mënyrë të nëndheshme kultin e individit përmes sistemit hoxhist, siç autori e cilëson periudhën komuniste të zhvillimit në Shqipëri. Ai shkruan në faqen 309 se: “...Përfaqësimi i Skënderbeut dhe Enver Hoxhës në novelat grafike dhe ilustrimet për fëmijë..., gjatë regjimit komunist nuk ishte thjesht një akt artistik, por një akt i pastër propagandistik politik. E kjo do të thotë se Skënderbeu u rikonceptua si pararendës ideologjik i udhëheqjes komuniste, ndërsa Enver Hoxha u përjetësua si figura qendrore e historisë së re të Shqipërisë”. Në kreun e gjashtë studiuesi përqendrohet tek funksioni edukativ, artistik, ideologjik dhe kulturor i revistave shqiptare për fëmijë e të rritur, te të cilat zejnë vend të dukshëm novela grafike dhe karikatura. Në përmbajtjen e këtij kreu zbulon qartësisht se si të gjitha materialet si ato grafike të imazheve realiste e figurative ashtu dhe gjuha e teksteve synonin formimin masiv ideologjik komunist të brezit të ri. Kreu i shtatë i përket novelave grafike shqiptare të pas viteve '90. Autori i jep rëndësi publikimit dhe vlerësimit të përpjekjeve të artistëve të rinj, të cilët janë të shumtë dhe trajtojnë novelën grafike si përmes ekzekutimeve krijuese manuale me forma tradicionale ashtu dhe përmes përdorimit të çelsave të teknologjisë. Ai vë në dukje se artistët e sotëm e të rinj, që trajtojnë novelën grafike dhe karikaturën, kanë shfaqur kërkesa krejt të reja si në imazhe dhe në subjekte apo tekste, duke sjellë në kujtesë se pas viteve '90 gjithçka ka ndryshuar, pasi ato kanë në qëllimin e tyre edukimin me fenomenet më të shquara tradicionale, me evidentimin e çasteve më kryesore të historisë dhe me botkuptimin e ri njerëzor mbi lirinë dhe të drejtat e njeriut.

Në segmente të librit të artit “Historia e novelës grafike dhe karikaturës shqiptare” ka shumë ide të tjera dhe mendime të pasura, vlerësime për artistët, fakte historike mbi besimin fetar, mbi rolin agresiv të pushtetit hoxhist ndaj këtij besimi, mbi deformimin e njeriut nën moton e krijimit të njeriut të ri, mbi estetizimin modern të formës tek karikatura, e shumë të tjera, të cilat shpresoj t'i zbuloni edhe ju duke e lexuar dhe shfletuar me kërshtëri librin mbi novelën grafike dhe karikaturën shqiptare.

Janar 2026




Një gjeth e zuri për mik. Një gjeth vjeshte. Një gjeth vjeshtak dhe të vonuar. Stina e vjeshtës kishte marrë me hov të madh, me shira e mjegulla, me erëra të ftohta. Mirëpo një gjeth valëvitej ende në maje të lisit të lartë, jo larg shtëpisë së tij, më mirë të thuash në fund të oborrit të tij, aty diku pranë rrugës së asfaltuar. Në atë rend ishin edhe shumë lisa të tjerë, plepa shumëvjeçar të mbjellë kushedi prej cilës dorë të hairit dhe krijuese. Në njërin prej tyre qëndronte një gjeth, mu në maje të lisit, gjeth i vetmuar, por jo i brengosur, jo i pikëlluar. Përkundrazi, në çdo puhi, sado të lehtë qoftë, ai lëvizte gjallërisht, luante njëfarë loje të vetën, duke kthyer herë faqen e herë shpinën kah shikuesi i rastit. Ai në fillim nuk ia vinte veshin gjethit të vetmuar as gjetheve të tjera madje që dita-ditës derdheshin e mbaronin një herë e përgjithmonë poshtë, nën këmbët e kalimtarëve apo në bar të thatë përreth trungut të trashë. Vërtet, ai ndonjëherë ua hidhte kalimthi ndonjë shikim të shkurtër lisave para oborrit, por pa menduar gjë, pa u zhytur në pamjen e tyre vjeshtore. Mirëpo kjo filloi të ndryshonte. Pamja e lisave nisi t'ia tërheqë vëmendjen me ngjyrat e tyre të mrekullueshme, me ngjyrat më se të bukura, tërheqëse sa të duash. I dukej se asnjë ngjyrë ari nuk e ka atë ëmbëlsirë të ngjyrës së verdhë siç e kishin gjethet e plepave kësaj vjeshte. Kështu, duke shijuar kukurinë e ngjyrave, ai tashmë filloi t'i kulloste sytë më shpesh nëpër gjethet e lisave. T'i thithte bukuritë e tyre e të ndiqte ndërrimin e nuancave të tyre në ditët e kësaj vjeshte të këndshme. Gjethet gjithnjë e më shpesh këputeshin e binin për tokë, binin ashtu si e kanë zakon gjethet, dalëngadalë, e duke bërë njëfarë loje në ajër, lojë të fundit dhe të mallëngjyeshme. Mirëpo kjo nuk vërehej në pamjen e përgjithshme të lisave. Ata dukeshin prapë të plotë me gjethe, të paprekur në madhëstsinë e tyre vjeshtore.

Një ditë fryu një erë e fortë, por nuk mbajti shumë. Fryu disi papritmas, aty diku kah dreka kur s'e kishte zakon në këto anë. Vërtet, nuk mbajti gjatë, por i shkundi lisat si të kishte fryrë ditë e natë. O, sa e preku kjo! Sa ndjenja të pikëllueshme ia ringjalli në shpirt pamja e çoroditur e lisave. Kah majat e tyre, gati të gjithë plepat ishin zhveshur gjysmë për gjysmë. Shumë e shumë gjethe u mungonin tanimë. Rrembat dalloheshin aty këtu dhe të përfytyronin eshtrat e një trupi të sëmurë, apo të dobësuar, së paku. Bukuria e plepave ishte cenuar pra rëndë e pa mëshirë.

Të nesërmen e nja disa ditë të tjera, gjethet nisën të palohen më me hov nën kurorat e plepave. Të palohen njëri mbi tjetrin përreth trungjeve, të palohen tanimë krejtësisht të qetë, pa lëvizje e shushurimë, pa jetë e gëzim. Era gati një javë ditë nuk ua prishi atë rehatinë e fundit. Ndenji diku larg, shumë larg, thuafe e zënë kushedi me çfarë pune. Mirëpo, një ditë prapë ia nisi të vetës. E lirë dhe pa kurrfarë pengesash, iu vërsul çdo gjëje që gjente para vetes, duke çuar pluhur e gjethe në ajër dhe duke bërë një ushëtimë aq të madhe sa që fuste njëfarë shqetësimi në shpirtrat e njerëzve. Mbasi e mrroli edhe qiellin vetë dhe e bëri armik të tokës, ajo, diku kah mbrëmja, u zhduk pa pritur e kujtuar. Mbas vetes la njëfarë heshtjeje të çuditshme, njëfarë qetësie jo fort të këndshme. Por edhe lisat i la pa shumë e shumë gjethe. Plepat gati krejtësisht i zhveshi. Atyre u kishin mbetur vetëm do fletë në pjesën e poshtme. Mirëpo, si për çudi, një gjeth valëvitej mu në maje të njërit prej tyre. Kishte mbetur ky në degëzën më të lartë dhe pa asnjë gjeth tjetër në afërsinë e tij. Ai e shikoi bukur gjatë kësaj gjethi. E shikoi duke menduar dhe vrarë mendjen për ta gjetur shpjegimin si ka mundur të përballojë ky gjeth gjithë atë furtunë të sotme, furtunë e cila nuk lë gjë pa e tronditur. Duke e shikuar kështu të vetmuar, gjethi i dukej tani sikur ishte më i madh se të gjitha fletët e tjera, i madh thuafe një pëllëmbë gati. Nisi bile t'ia mveshë edhe do veti të tjera,

HIVZI SYLEJMANI

Një gjeth e një njeri



NJERIU-GJETH DHE GJETHI-NJERI

Ky është është tregimi i fundit i shkrimtarit Hivzi Sylejmani (1910-1975), i botuar për herë të parë një vit pas vdekjes së tij në revistën letrare “Jeta e re” të Prishtinës nr. 4-5, 1976.

Një gjeth e një njeri është një tregim gjithsesi interesant, i bukur, poetik dhe simbolik. Gjethi simbolizon qëndresën, kryelartësinë, jetën, temë e preferuar e Hivziut si shkrimtar. Dhe vdekjen në fund, pas gjithë asaj rezistence, vdekjen e pashmangshme. Ikjen nga kjo botë. Paralelizmi: gjeth-njeri. Befasia: gjethi bie kur s'e pret, pasi kalon stuhia. Edhe njeriu shumë herë dorëzohet, vdes, atëherë kur më së paku pritet.

A është gjethi *alter ego* e vetë shkrimtarit? Në masë të madhe po, sepse në tregim flitet për një gjeth “të vetmuar, por jo të brengosur dhe të pikëlluar”. Rrëfimi zhvillohet në vetën e tretë. Ai që rrëfen është një njeri i vetmuar, që sodit gjethet, lisat, natyrën në përgjithësi dhe përsiat. Nuk thuhet tekstualisht, por rrëfimtari është njëkohësisht njeri i moshuar dhe, madje, edhe i sëmurë. Kjo ide sugjerohet nëpërmjet paralelizmit figurativ. Rrembat e lisave i kujtojnë “eshtrat e një trupi të sëmurë, të dobësuar”. Miqësohet aq shumë me gjethin që qëndron majë plepit, sa e quan “gjethi im”. Duke e soditur me simpati të veçantë gjethin “e tij”, rrëfimtari nis t'i mveshë atij “veti të njeriut”.

Derisa te tregimi i hershëm *Miku im, Xho* (1957) flitet për miqësinë e njeriut me kafshën – qenin, ndërsa te tregimi *Qetësi deti* (1961) për miqësinë e njeriut me një insekt – një cinxër, që në qetësinë e natës këndon këngën e vet të hareshme, këtu kemi rrëfimin për një gjeth. Kafsha, insekti, gjethi i japin shkas narratorit të meditojë për jetën, ëndrrat, qëndresën, dashurinë... Cinxëri bie pre e këngës së vet, ashtu sikurse njeriu i mbërthyer për karrocën e invalidit ka rënë pre e iluzionit të tij për ta ndryshuar botën: “për bukurinë e jetës që e kam kërkuar jo vetëm për vete...”.

Rrëfimi për gjethin në majë të plepit është i rrjedhshëm, i zhdërvjellët, me një ndjeshmëri të hollë për natyrën: erën, shiun, gjethet, stinët, ngjyrërat. Si pothuajse në tërë prozën e Hivzi Sylejmanit edhe këtu rrëfimi realist tradicional gërshetohet me diskursin alegorik-simbolik dhe asociativ-metaforik.

Zgjidhi dhe komentoi: A. Vinca

do veti të veçanta dhe të ngjashme me vetitë e njeriut. Me një fjalë, ky gjeth, ky gjeth i vetmuar në maje të lisit, u bë tanimë aq tërheqës, sa nuk linte pa ia hedhur ndonjë shikim sa herë që dilte në dritare ose në oborr. E ky me këmbëngulje qëndronte atje nën qiell, atje në atë degëzën më të lartë të plepit. Qëndronte krenar dhe plot vetëbesim, thuafe nuk e kishte mendjen ta merrte edhe ai rrugën e gjetheve të tjera, tanimë të shkapërderdhura në të katër anët e botës. Zaten kjo më së shumti e tërhiqte vëmendjen e tij. Bile cuditej si bën të qëllojë ky aq i fortë sa t'i përballojë edhe aso erërash siç ishin ato të fundit. Kështu, dalëngadalë ai një ditë u bë njëfarë simpatizuesi i këtij gjethi. Sa herë që e vështronte, në të, gjithnjë e më shumë, lindnin dofarë ndjenjash të çuditshme. Ndjenja mrekullimi, ndjenja që ta çonin mallin për njeriun që s'u përkulet vështirësive, njeriun e gatshëm për rezistencë ndaj stuhisë së jetës dhe furtunave të saj të ndryshme. Kështu u bë edhe sot kur brenda ditës shumë e shumë herë i drejtoi sytë kah maja e lisit, kah gjethi tanimë i dashur i tij. Kështu u bë edhe nja disa ditë me radhë. E çdo herë kur e shihte gjethin duke u valëvitur atje lart si pëlhura e flamurit, i fortë dhe i vendosur të mbetet aty përkundër çfarëdo kushti, atij i mbushej zemra me gazmend. Madje, madje, në ato çaste e ndjente veten si të lumtur, bile me të vërtetë të lumtur, sepse i vinte buzët në gaz prej njëfarë kënaqësie.

Sot para dite ai filloi ta drejtojë shikimin më shpesh kah maja e lisit. Arsyeja ishte e thjeshtë: në horizontin e largët u shfaqën do re të dendura, të vrenjtura dhe kërcënuese.

Po edhe njëfarë ere nisi të frynte. Erë jo e fortë, vërtet, por prapë e rrezikshme për gjethin e tij. Mirëpo ai vetëm valëvitej atje larg, valëvitej gjallërisht dhe dukej sikur s'po ia vinte veshin kurrfarë rreziku që mund t'i kanosej. Diku mbas dite era filloi të egërsohej. Retë kërcënuese dhe të zeza e kapluan tërë qiellin skaj më skaj. Duke e shikuar me një vështrim të gjatë atje diku kah mbrëmja, ai ndjente në vetvete njëfarë shqetësimi për fatin e gjethit të tij. Kur terri u shtua aq sa nuk dalloheshin tanimë as degët e lisit, ai u tërhoq nga dritarja dhe nisi të ecte nëpër dhomë me hapa të ngadalshëm. Më në fund u ul pranë tavolinës dhe filloi të lexonte njëfarë libri në të cilin trajtohej arkitektura e lashtë arabe. E atje jashtë, era zotëronte tanimë sipas qejfit të vet dhe me atë ushëtimën trishtuese të shtinte të mendosh për do gjëra që vetëm atëherë të bien ndër mend. Para se të shkonte në dhomën e fjetjes, ai doli pakëz në ballkon dhe i nguli sytë në hapësirën e errët. E duke u kthyer brenda, iu duk se për gjethin e tij s' kishte më shpresë në këtë natë të turbullt dhe plot ushëtimë të egër ere.

Kësaj here për një kohë të gjatë nuk e mori gjumi. Kur diku kah mesnata u zgjua, mendja menjëherë i shkoi te gjethi. A thua ende është aty, ku e pashë herën e fundit? - bëri me vetveten duke dëgjuar ulërimën e erës së tërbuar. Jo, jo, s'është e mundur që të jetë më aty. Kjo s'është më erë, por furtunë, shtrëngatë e vërtetë. Edhe nja disa herë i doli gjumi gjatë natës. E tërë kjo natë i kaloi kështu. Diku mu para agut, ai edhe njëherë u zgjua. Stuhia vazhdonte këngën e vet të vrazhdë. Herë-herë lëkundej edhe shtëpia

bile. Vrimat e saj dhe plasat fishkëllenin në mënyrë të gjatë njëfarë melodie trishtuese, melodie që të bënte të futesh edhe më thellë në vetvete, të mendosh dhe të kuptosh natyrën në tërë kompleksin e saj. A thua u dorëzua gjethi krenar? - tha me vete posa hodhi një shikim kah lisat e humbur në terrin e natës. Kah lisat që ende nuk shiheshin fare. Paj, është dorëzuar, çka tjetër, bëri me një dhimbje të fshehur. Ku mund të çojë inat ai me një erë kaq të shfrenuar dhe kur çdo gjë në jetë e ka kufirin e vet... Nëpër kokën e tij të përgjumur kaluan edhe nja disa pyetje e mendime kësodore. Duke parë se ende kishte kohë për pak gjumë, ai u mundua të flinte edhe pak, por kot. Tanimë gjethi dhe halli i tij nuk e linin rehat trurin e tij. Më në fund u ngrit. U rregullua në banjo dhe u vendos pranë dritares. Duke qëndruar aty, mendohej herë-herë ta shponte terrin e natës, mirëpo munda i shkonte huq, sepse errësira ende nuk e lejonte për të parë gjë. E ai pra digjej nga kërshtëria për të marrë vesh a ishte gjethi në vendin e vet apo e kishte rrëmbyer furtuna ndoshta dhe çuar kushedi ku e mbas sa kodrave. Dikur iu duk se zbardhi agimi. Iu duk madje se po shihte diçka atje pranë rrugës në fund të oborrit. Pak më vonë me të vërtetë filluan të shfaqeshin siluetat e lisave. Tanimë ai nisi të bënte çmos për të gjetur gjethin në plepin e tij, për të gjetur dhe për të parë a kishte dalë ngadhënjimtar në këtë betejë aspak të barabartë apo... apo ndoshta... Jo, s'mund ta pranonte kollaj disfatën e tij, dorëzimin e gjethit kryeneç. Zemra i dridhej ngapak nga të priturit dhe padurimi. E drita e agut sikur për inat nuk ngutej t'ia plotësonte dëshirën e tij të flaktë. Gdhinte ngadalë, rreze për rreze. Dikur iu duk se s'ishte më gjethi atje, atje në atë degëzën më të lartë të plepit. Për t'u bindur, i nguli sytë edhe njëherë. Iu duk prapë se gjethi nuk ishte më aty. Më në fund i fërkoj sytë dhe provoi edhe njëherë. Eeee-eh! - bëri me njëfarë dhembjeje në zemër kur edhe kesi herë iu duk se era e kishte rrëmbyer gjethin hasharí. Tanimë e kaploi njëfarë mallëngjimi për mikun plot vitalitet, për gjethin e tij me të cilin bëri një muhabet aq intim dhe të çuditshëm. Duke menduar për fatin e tij, ai nuk kishte vërejtur se me agimin, tanimë të plotë, kishte pushuar edhe era vetë. Në hapësirën e ftohtë dhe të vranët, nuk ndihej pra as më e vogla puhi. Ai këtë e vuri re mu atëherë kur doli në ballkon për të shikuar pak panoramën e qytetit mbas një nate të trazuar vjeshtore. E këtu ndodhi çka ndodhi. Sytë e tij panë diçka thuafe të pamundshme. E panë gjethin mu në atë vend ku e zuri nata. Rrinte pezull dhe i qetë në vendin e vet. Rrinte si i lodhur dhe i stërlodhur nga beteja që e bëri gjatë gjithë një nate të hatashme, betejë me erën e pamëshirshme. E ai, duke mos ditur se çka të bënte tjetër, vetëm e hapi gojën dhe i zgurdulloi sytë prej habisë së papërshkrueshme. Fytyra e tij pasqyronte pamjen e një njeriu jo vetëm të çuditshëm, por edhe të gëzuar sa s'bën më. Në atë gjendje shpirtërore ia drejtoi gjethit nja njëqind lëvdata, më të bukurat e më të përzemërtat që i ranë në mend në ato çaste.

Sa e çuditshme i doli kjo punë! Diku kah mesdita ajo ia solli prapë një befasi. Duke ardhur në shtëpi, ai qysh prej së largu ia hodhi një shikim vendit ku duhej të ishte gjethi i tij. Mirëpo, gjethi nuk qëndronte më aty. E moti pra ishte që prej mëngjesit i qetë. As puhi nuk frynte e jo më erë. Vetëm një shi vjeshtor rigonte nga pak, shi që mezi e lagte tokën. Kur iu afrua plepit, shikoi rreth e rrotull trungut ku mendonte ta gjente, por kot. As një fletë bile të vjetër nuk gjeti aty. Shikoi edhe një herë më me kujdes, por prapë asgjë. Më në fund u largua pak dhe i drejtoi sytë kah rrembat e plepit. Ah, qe ku është! - bëri kur e pa mikun e vet. E gjethi ishte mes do degëzash që e kishin ndalur mes veti sikur dëshironin t'i shprehnin mirënjohjen e tyre për shërbimin e palodhshëm që ia kish bërë trungut dhe rrembave të tij.

“Jeta e re” nr. 4-5, 1976.

Veprat letrare në rrugën e vështirë të lexuesit

Nga Granit Zela

Fillimjanari i këtij viti ngjalli debat për poezinë, tregimin, dhe letërsinë për fëmijë. Shkak u bënë çmimet letrare për prurjet letrare të para dy viteve, nga Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, si dhe deklarimi publik i drejtoreshës së saj se çmimet vjetore për poezinë, tregimin dhe letërsinë për fëmijë nuk ishin dhënë ngaqë ky kishte qenë propozim i jurive të mëparshme dhe se gjatë vitit 2024 “kategori si tregimi, letërsia për fëmijë apo poezia nuk kishin prurje të mjaftueshme për gjykim”.


E vërteta është se asnjëri prej anëtarëve të jurisë së çmimeve për vitin letrar 2024 nuk e ka pohuar me shkrim apo me gojë një gjykim të tillë për poezinë, tregimin apo për letërsinë për fëmijë. Z. Mehmet Kraja, kryetari i jurisë së Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për veprat e botuara gjatë vitit 2022, u shpreh në fjalën e tij të rastit se vepra të mira ishin botuar edhe jashtë përzgjedhjes së atij viti dhe se “çmimet letrare janë një mjet i përshtatshëm dhe ndihmës për popullarizimin e veprave letrare, një ndihmesë sado e vogël që letërsia, që vepra letrare të kalojnë me lehtë në rrugën e vështirë të lexuesit”.

Kandidatë për çmimin e librit poetik të atij viti ishin poetën Niko Kacalidha, Erina Çoku, Flurans Ilia, Ndue Ukaj, dhe Olimbi Velaj me libër fitues. Kandidatë për vëllimin më të mirë me tregime ishin Zejnulla Rrahmani, Besnik Mustafaj, Behar Jacaj, (fitues), Dashnor Kokonozi dhe Flutura Aça. Po kështu edhe letërsia për fëmijë pati autorët e saj të dinjitetshëm. Të ketë propozuar kjo juri që poezia, tregimi dhe letërsia për fëmijë të mos jetë si kategori më vete sepse prurjet e autorëve të këtij viti nuk e përligjinin çmimin letrar? Kjo është e pagjasë.

Po kaq e pagjasë është që këtë ta ketë bërë juria që ka vlerësuar prurjet e vitit 2023 me kandidatë në kategorinë e tregimit, Shpëtim Kelmendin (fitues), Ardian Kyçykan., Shqiponja Axhamin, Flurans Ilia, dhe Artur Bakun. Atë vit në listën e shkurtër për poezi ishin Maklena Nika, Entela Tabaku (fituese), Roland Gjoza, Enxhi Naumi, dhe Alban Tartari. Ta ketë propozuar juria e vlerësimit të prurjeve të vitit 2023 që categoria e poezisë me këta përfaqësues nuk e përmbushte kriterin e një çmimi letrar dhe duhej hequr më pas si kategori më vete? Edhe kjo duket krejt e pagjasë sepse sipas asaj jurie vepra poetike fituese “e pasuroi poezinë shqipe me zërin e saj lirik unik”, ndërsa njëra nga poetet finaliste të atij viti, ishte anëtare e jurisë që gjykoi prurjet e një viti më pas.

Pra, asnjë gjasë nuk ka që ndonjëra prej jurive të mëparshme të Çmimeve Kombëtare të Letërsisë të ketë vlerësuar dhe lavdëruar botërisht veprat poetike, vëllimet me tregime dhe librat e letërsisë për fëmijë dhe ndërkohë të ketë propozuar zhdukjen e çmimeve për këto gjini në vitet e mëpasshme.

Letërsia shqipe sot është si një autostradë me disa “korsi”; me “korsinë” e botimeve të shtëpive botuese të Shqipërisë, me “korsinë” e botimeve të shtëpive botuese të Kosovës, dhe mandej, me “korsinë” e botimeve në Maqedoni, Mal të Zi dhe nëpër botë. Përballë këtij realiteti kaq dinamik, juritë e Qendrës Kombëtare të Leximit nuk përshkojnë dot as “korsinë” e botimeve që përfshihen në treguesin e botimeve në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë.



Pa e çuar te Biblioteka e Kosovës, juria e përvitshme nuk mundet dot të përshkojë as vetëm “korsinë” e botimeve të Buzikut në Kosovë ku përveç një aradhe të gjatë librash që kanë fituar Çmimin Goncourt, apo të nobelistëve, përkthimi i veprës së Aristotelit “Retorika”, vlerësuar si përkthim në QKLL-në e vitit 2026, te Buzuku është botuar në vitin 2021. Dhe për çudi, kësohere, ndryshe nga juritëve të mëparshme të QKLL-së, nuk pati asnjë autor nga Kosova.

Le ta theksojmë, ka një paragjykim që përsëritet kohë pas kohe për librat që shkruhen nga autorët shqiptarë, domethënë, për letërsinë shqipe, se nuk është e të njëjtave nivele me të vendeve të tjera. Kjo është një marrëzi, letërsia shqiptare ka dinamikën e vet si të gjitha letërsitë e tjera. Çështja është që ky paragjykim, ky përgojim i autorëve shqiptarë duhet të luftohet, jo të zyrtarizohet, sepse këssoj vetë QKLL krijon një pengesë, sado të vogël që letërsia, që veprat letrare të kalojnë në rrugën e vështirë të lexuesit.

BESA KALAJA

Kthehet gjithmonë

Tregim

Gjumin e kam të thellë, të rëndë, duhet të ndodhë diçka e pazakonshme që të më nxjerrë prej tij. Edhe këtë herë ishte kështu. Më thanë se kishin provuar për rreth tri orë t'më zgjonin, por pa sukses. E ndjeva një dorë të akullt që më hyri në qafë dhe nisi të më lëkundte.

-U çua jerm, hapi derën me forcë dhe doli jashtë. Qe tri orë jam duke e pritur dhe nuk po kthehet. Nuk dëgjove gjë?- më pyeti një zë i trembur, shumë i frikësuar.

-Kur? Kush?- thashë duke u përpjekur të mblidhja veten.

-Shoku ynë i dhomës.

Edhe pse zhdukej herë pas here, tri orë ishin shumë. Zakonisht e dija ku mund ta gjeja. Për një çast mendova se duhej të bëja një plan, por i ftohti i dhomës nuk më linte të përqendrohesha.

-Vishu,- i thashë. -Duhet të shkojmë në dy vendet ku zakonisht e gjej. Shpjegimet dhe planin do t'i bëjmë gjatë rrugës.

- Është shumë herët, ora ende s'është 05:00,- ma ktheu.

-Mirë, po as këtu s'mund të presim. Shihe veten si je nxirë, i thashë.

Në një kryqëzim rrugësh u ndamë. Ai dridhej më shumë se unë. Kur ia zgjata dorën, nuk ma lëshoi menjëherë, ma shtrëngonte fort.

-Kthjellu!-i bërtita. -Të premtoj se do ta gjejmë.

Më tha se gjendja e tij ishte shumë e keqe.

-U zgjua, përshkoi gjithë dhomën, doli në korridor, u kthye prapë, u përpoq të hapte dritaren me forcë. Kur s'ia doli, u drejtua nga dera, rrotulloi çelësin dhe doli jashtë. U mundova ta ndal, por është shumë i fortë. Më rrëshqiti nga duart dhe u zhduk në natë.

I rashë në krah për ta qetësuar.

-Shko te kafa dhe prit. Ndoshta vjen aty, i thashë pa qenë shumë i bindur as vet.

Duke mërmëritur nën hundë, u bind.

Më duhej të shkoja në vendin më të gërditshëm që më kishin parë sytë. Kohët

e fundit shkonte shpesh atje, takonte një grua. Shtëpia ishte pak më larg, po ecja me shpejtësi. Edhe pse pak më parë mendoja se gjithçka ishte nën kontrollin tim, fillova të dyshoja. Herë të tjera e gjeja shpejt, por jo pasi çohesha jerm.

Mendimet më vërshuan njëra pas tjetrës. Nuk e dija nëse ishin vetëm ato dy vende që i frekuentonte. Ende herët për të parë nëse kishte njeri brenda. Vetëm njëherë shkova me të në atë shtëpi. Më pati marrë me zor e prezantuar njërin prej grave. Ishte shumë e shëmtuar. Era e thartirës e përzier me duhan më patën bërë të ikja me vrap. As ftohti, as vrapimi nuk ma hoqën neverinë. Në qoshen e një shtëpie pata vjellë për gati gjysmë ore. Disa ditë më pas pata ethe dhe temperaturë.

Trupi mu dridh.

Nuk e di pse mu kujtua tani. Njeriu nuk e ka luksin që në kushte të tilla të përfshihet nga kujtimet çfarëdo qofshin ato. U mbështeta te muri dhe prita. Pas gati dy orësh, disa burra në moshë dolën prej andej, të kënaqur. Çfarë kishin për të humbur? Qejf në fund të jetës.

Prita edhe pak. Ai nuk po dilte. Vendosa të hyja. Hapa derën jo pa frikë. Një grua në moshë, që shqeponte, hapi duart dhe, duke e prishur fytyrën, më tha se orari kishte përfunduar, se vajzat ishin lodhur dhe do të shkonin në shtëpi. U përpoqa t'i shpjegoja se nuk kisha shkuar për atë punë, por shikimi i saj mosbesues dhe forca me të cilën më nxori jashtë më bindën që s'do më lejonte të hyja brenda.

Isha gati i bindur se aty do ta gjeja.

M'u kujtua shoku tjetër. Më priste te kafeneja ku pinim kafën e mëngjesit. Një vend i ndotur, por ku ne humbim në biseda që kurrë nuk na dhanë shenjë se diçka nuk shkonte me atë djalë.

U nisa drejt kafenesë. Shoku ishte brenda. Më tha se ishte mërdhirë, buzët i ishin nxirë, gishtat nuk i lëvizte dot.

-Nuk erdhi, duhet të njoftojmë policinë, nuk guxojmë të humbasim kohë. Dhe s'e



kuptoj pse nuk na kanë treguar, apo pse ai vetë s'na ka thënë që çohet jerm- më tha i shqetësuar.

Fliste me ndërprerje. Gjuha i përdridhej, sytë i rridhnin lot.

I thashë se ishte herët për policinë. Duhej së pari të gjenim të afërmit.

-Po ne nuk njohim askënd, - tha.

Ishte e vërtetë, më erdhi ideja që të kontrollonim gjërat e tij. Edhe pse iu duk absurde, më ndoqi.

Në dhomë hyra zbathur njëren këpucë, tjetren mbathur. Gjërat e tij ishin shpërndarë gjithandej. Fillova me librat dhe fletoret. Shfletoja shpejt. Gjeta vetëm disa fotografi erotike të prera nga revistat.

-Numrat!-bërtiti papritur.

U drithërova.

Çfarë?

-Numrat.

Ishte një fletë me numra telefoni dhe përshkrime të çuditshme. Në kllapa kishte shënuar emra si, tezja, nipi, nënë ziliqarja.

Nënë ziliqarja? Një nga njerëzit më të marrë që kam takuar. Ky numër duhet thirrur, mendova. Mora frymë thellë dhe shtypa numrin.

Nuk e di çfarë i thashë. Nga frymëmarrja e saj e ndërprerë e kuptova se nuk i interesonte.

-Ai kthehet gjithmonë,- tha dhe ma mbylli telefonin.

-Ai kthehet gjithmonë,- ia përsërita shokut, i përhumbur.

Sa herë e thërrisja, e njëjta përgjigje. Kurrë nuk e kuptova mungesën e dhimbjes për të birin. Mendimi për të shkuar për ta takuar atë grua më paralizonte.

Në telefon e thërrisja shpesh. E bezdisja me qëllim. I kërkoja hollësi, e pyesja nëse kishte ndodhur më parë, çfarë bënte ajo në këto raste. Gjithmonë e njëjta frymëmarrje e rëndë.

“Nënë ziliqarja”, më mbeti në kokë si jehonë. Nuk hyra kurrë në teori për ta shpjeguar, pse e thërriste dhe shënuar kështu në fletë. Nuk e biseduam kurrë as më shokun tjetër të dhomës. U pata çuditur si nuk e pati komentuar sepse ai gjeti fletën me numra të telefonit. Zaten i tillë është, kurrë nuk i komenton gjërat. As fakti që po e thërrisja gruan shpesh në telefon nuk e kureshtonte. Në njëfarë mënyrë me këtë sjellje ma bëri të qartë që nuk do të merrej me këtë punë. Mbeta vetëm në kërkim.

Vetëm dhe i frikësuar.

Edhe gruaja më hoqi lehtë qafe.

Herën e fundit që e thirra m'u përgjigj një zë tjetër. Më tha se gruaja ka vdekur para disa ditësh dhe të mos telefonoja më. Lajm vështirë i besueshëm po çfarë mund të bëja.

Luftën në kërkim të tij e vazhdova. Policinë nuk e lashë rehat asnjëherë.

Shkova drejt zyrave të policisë. Një polic trashalug më priti. Pantallonat i vareshin, dorën e mbante mbi revole. Dukej i përgjumur.

-Nuk do të heqësh dorë. Ka kaluar mjaft kohë. Shoku yt e paraqiti rastin dhe vazhdoi jetën.

-Janë zhvilluar hetime?- e pyeta.

- Sipas dosjes, po. Disa pista, asnjë rezultat. E kishin parë afër kufirit.

- Mund ta kenë vrarë?

-Pse të vritej? Nuk ishte i rëndësishëm.

Iaktheva se edhe njerëz të parëndësishëm vriten çdo ditë.

Ai qeshi. Pastaj foli gjatë për rastet me të cilat merren, për një djalë të varfër që kishte vjedhur një pulë, për shenja të lëna me qëllim nga kryerësit, për krimin që nxjerr njeriun nga anonimiteti. Në fund e mbylli dosjen, pa më shikuar asnjëherë në sy.

Me zhurmën e dollapit, u mbyll edhe rasti në zemrën time.

...

-Çohu, shkoi ora! Duhet të nisemi.

Dora e ftohtë në qafë më çoi. U ngrita shpejt.

-Ku është ai? A e keni gjetur?

Lea Ypi, “*Të poshtëruar*”, Dudaj

Këndvështrim ngasës ndaj rrëfimit dhe interpretimit të historisë

Nga Ali Aliu

Dy romanet e Lea Ypit, “*Të lirë*” dhe “*Të poshtëruar*” sjellin në letërsinë tonë sagën romanore familjare nga një kënd dhe perspektivë e veçantë, të zhanrit narrativ hibrid, ku ndërthuret historia me letërsinë. Përfshirja e më shumë diskurseve narrative, që është tipar post-modern në letërsinë bashkëkohore, në librat e saj e sjell esenë, memoaristikën, dokumentin, shkrimin akademik e filozofik, etik e politik, kryesisht nga këndvështrimi i vetës së parë, ngarkuar me mision në shërbim të kërshtorisë kreative të autores, për të sjellë art romanor të dorës së parë. Trungu familjar, *Gjyshja* dhe historia janë shtyllat narrative të poetikës romanore- dy të parat, lëndë e shtjelluar në sfondin e historisë për të interpretuar por edhe për ta nxitur historinë të rrëfjet, që në fakt është synim i parë i autores, pos sentimentit të hollë ndaj trungut familjar të Ypëve. Mund të thuhet lirisht se librat e saj janë prurje, prania e vlerës artistike, jehona e të cilave ndjehet në letërsinë shqipe dhe, siç do të thoshte Sabri Hamiti, ky zë i ri do ta lëvizë renditjen në raftet e bibliotekave tona; është zë me këndvështrim ngasës ndaj historisë, mëtim që nxit zgjimin, jo topitjen; është objektiv përtej kohe, në kërkim të

kuptimit i cili, sipas autores, funksionon vetëm përmes mendimit kritik – shkollë nga e cila vjen autorja. Proza e saj vlerësohet si origjinale kudo ku botohet, referencë e cila bën që letërsia shqipe në tërësi të ndjehet mirë në ato ambiente.

Ypi është autore e disa librave shkencorë, kryesisht nga filozofia, botuar qendrave akademike dhe universitare si dhe shtëpive botuese prestigjioze të Evropës. Lea Ypi është zë i mirëpritur në konferenca shkencore, në tribuna akademike kryeqyteteve evropiane, në ligjërata jo vetëm letrare dhe filozofike por edhe historike-politike ku debatohen dhe shtjellohen aktualitete gjegjëse, vizione reformash të rëndësishme të BE-së; prandaj “*Të poshtëruar*” është roman që i përket rrëfimit modern- atij historik, sagës familjare, ndërlidhjes ligjërimore hibride, që në botën krijuese të autores vjen shtjellim artistik i përkryer, me besueshmëri të natyrshme, gjithë krah talentit, stilit, formimit kulturor, filozofik. Edhe kur shfaqet si rrëfim zërit të parë, mbesës së familjes, tejtejet mëndje hapur, rebele dhe ironike, në kërkim të gjurmëve të të parëve, Lea vjen e besueshme duke e mbajtur vëmendjen e lexuesit natyrshëm,

pa gjykime e paragjykime.

Me përjashtime periferike, të gjithë personazhet e romanit janë emra me identitet real nga dega familjare e Ypëve që shtrirë në harkun kohor dy shekullor, i ofron autores përparësi si dhe kufizime narrative. Tërë fjetet narrative të romanit, me këtë rast lëvizin bashkërisht personazhe dhe narrator; edhe pasi heq dorë nga rrëfimi në vetën e parë, dhe ia heq kornizat kohore imagjinatës me vetën e tretë, romani si tërësi qëndron kompakt, në harmoni të brendshme. Ritmi që e tërheq lexuesin ka po atë tempo që nga fillimi në fund: është gjyshja Lemane, bosht bartës i matricës fabulare të romanit, figurë tek e cila nisin dhe përplasen sfidat e turbulencave nëpër të cilat kalon, duke e ruajtur boshtin kurrizor pa përkulur. Ajo është personazh bosht, figurë që bart, të shtresuar, sisteme historike shqiptare, ballkanike, njerëzore. Ajo ecën nëpër to, ngasjesh e sfidash të brendshme, shpesh të stuhishme, ndaj të cilave len përshtypje se i ndjek me mospërfillje, me një qetësi rebeluese, biblike. Edhe refleksat e qeshjes së saj në foton e ballinës - buzëqeshje me sy e tipare të fytyrës bashkë- ky imazh, sikur thotë: ja, ju sfidoj, të gjithëve - e sigurt për atë që është, që ka, rebelim të përmbajtur, të fshehtë. Ajo nuk ankohet për asgjë, ajo nuk akuzon, ajo nuk përkulet, me dinjitet, asketshëm i del zot vetes. Thjesht ajo është e denjë për vuajtjen, qëndrimi i dinjitetshëm i gjyshes në thelb është vuajtje e brendshme e saj, e kundërta do të ishte mohim i qenies së vet, prandaj *Gjyshja* e Leas nxit dhe të rrëmben në kredhje lashtësive tragjike të antikitetit, fajet, mëkatet dhe kostot, për të qenë e denjë për to. Rrezatimi që shigjeton botën nga qeshja ngasëse dhe sfiduese, edhe për mëkatet të supozuara apo për një zjarr-flakë të brendshme, që mund të ndezë dhe djegë çdo gjë për rreth, “*pastaj edhe veten*”, thënë me gjuhën e Niçes. Gjyshja nuk ka nevojë ta marrin në mbrojtje, askush, bile as mbesa narratore. Autorja ndërsa më shumë vëmendje, ndjeshmëri për të qenë afër, ka sjellë personazhin e gjyshit të vet, Asllanit, me formim dhe edukatë parisienne. Ai është fjalë pak, i heshtur në fatkeqësinë e vet, ndërkaj gjyshja, kalvaret dramatike të saj, mallkimet, kostot i ngre në kauza drejt “*kërkimit* të kuptimit”: (Viktor Frankl), drejt thelbit të qenies, të ekzistencës.

Kur autorja, krijon distancë nga trungu familjar, nga personazhet me identitet real, kur del nga korniza e statusit të vetës së parë dhe kalon në vetën e tretë, dukshëm i jep krah imagjinatës, shkel atëherë në realitetin e botës tonë planetare, të ndreqshme të pandreqshme; gjithnjë nga këndvështrimi tani i njohur, origjinal i Lea-s ndaj historisë. Ngarkuar në imagjinatë jetën, dramën jetësore të Gjyshes, autorja ballafaqon sfidueshëm historinë dhe realitetin, sfidë nga e cila shpërthejnë shkëndijime refleksesh dhe ndijësimesh, filozofike, etike, psikologjike, të pranishme në këtë spektër edhe hamendësime, përvidhen dilema thellësisht të pazbërthyeshme, qoftë si shikim ndaj së kaluarës njësoj ndaj së ardhmes. Ç’kuptim ka rropatja për të ndriçuar historinë, përkatësisht dëshmia testamentale, - situata në të cilat e zë veten autorja, qoftë edhe në përballje me misionin e artit letrar në monumentësimin e historisë. A kemi vërtet, në këtë rropatje, objektiv të vullnetshëm, në çaste dëshpërimi dhe zhgënjimi. Duke kërkuar brenda vetes shtron pyetjen: ka apo s’ka vullnet për këtë që bën duke bredhur arkivave shtetërore, policore, që janë kapituj, faqe rrëfimi të përsosur, përsiatje, kredhje të imagjinatës, perspektivash dhe statutesh narrative të romanit, që e rrëmbajnë lexuesin, e në instancë të fundit përmbledhen brenda boshtit stoik, etik dhe filozofik që rrezaton nga Gjyshja, e cila, duke shpalosur qenien e vet thotë: “Problemi nuk qëndron te gjetja e fajtorëve. Puna është të kuptosh”.





**Bustina e Kamomilit është një rubrikë joperiodike e shqyrtimit të disa situatave, prej shqetësimit të të cilave shpëtoj vetëm pasi t'i kem shkruar.*

FÉLICETTE, SHQIPËRIA, DAVOSI DHE NJË PORTOKALL

Andreas Dushi

Ndërkohë që punoj, qoftë në zyrë, ashtu edhe në shtëpi, e ndjej gjithnjë praninë e një maceje. Nga dritarja e zyrës, një tabi që nuk mendoj t'i vë emër pasi tanimë duhet ta ketë një të tillë nga dikush tjetër, ecën nëpër tarracën e Kalasë së Tiranës dhe më shpërfill, teksa unë e pres me padurim orarin e paradës së saj të përditshme. Në shtëpi, Lenuja, macja ime, nxiton të ndjekë një lajthi deri sa lodhet dhe, pasi mjaullin disa herë, më kruspullohet në prehër ku edhe e zë gjumi, ndonjëherë me kokën e mbështetur te tastiera, veprim me anë të të cilit më duket se, tek shtyp ndonjë tastë pa e ditur çfarë po bën, në fakt përpiket të më flasë. Por kjo është një bisedë tjetër, e gjatë dhe, me shumë gjasa, e ndërlikuar dhe e pavend të vijohet në këtë rubrikë, ku patjetër është rasti të kujtohet lidhja e veçantë mes shkrimtarëve, piktorëve dhe artistëve në përgjithësi me macet e tyre, zakonisht të adoptuara.

Marrja nga rruga e një maceje, kryesisht vlerësohet si adoptim i saj, pra si gatishmëri për t'i ofruar një familje të përhershme, ku do të gjejë ngrohtësi dhe dashuri. Prandaj, edhe pse macet nuk besoj ta kenë një një ndërgjegje kolektive lidhur me këtë, kam dëshirë të mendoj se diku thellë, e dijnë se, po u kapën prej duarve të dikujt, e ardhmja do t'u ndryshojë për mirë. Ama, jo për Félicette-n.

Historia e saj tronditëse dëshmon nivelin e mizorisë së njeriut ndaj kafshëve. Ajo u mor nga rruga me një synim: dërgimin e saj në hapësirë. U trajnuar për një kohë të gjatë në ushtrime të llahtarshme, deri sa u bë gati, vajti në hapësirë dhe, fatmirësisht e çuditërisht, u kthye gjallë, ndryshe prej kafshëve të tjera që u lanë të harruara në sorollatje të pafundme. Ky duhet të ishte fundi i horrorit të saj, dhe ashtu qe, por jo pse u pasua nga një sjellje dinjitoze me të, përkundrazi: shkencëtarët që e nisën, vendosën ta vrisnin, për të kuptuar se ky akt përfundimtar qe krejt i panevojshëm dhe se, nëpërmjet analizës së trurit të saj, nuk mësonin kurrfarë gjëje që tanimë s'e dinin.

Çdo fushë e kësaj jete është treguar mizore me kafshët. Vetëm termi në anglisht *livingstock* mjafton për ta rrëfyer se si dhe se çfarë janë kafshët për njerëzit. Tërë kjo rezonon më së miri me një shoqëri si Shqipëria, ku ditëpërditë shohim denoncime të dhunës ndaj kafshëve, në një kohë kur një pjesë e mirë e tyrja, mbase më e madhja, mbeten të fshehta.

Shtëpia botuese “Trishtil” ka botuar tani vonë një libër, *Mjau* me autor Solin, maçokun librar të librarisë “Onufri”. Gjithë shitjet e tij do të shkojnë për strehën “Animals need me” në Shkodër, nga ku Soli është adoptuar. Kjo iniciativë e pamjaftueshme sensibilizon, por nuk e thyen mendësinë se është budallallëk të kujdesemi për kafshët kur kaq shumë njerëz po vuajnë. Është e vërtetë, shumë njerëz po vuajnë, disa prej tyre edhe nga fakti se nuk arrijnë ta kuptojnë si shiten luanë në Tiktok, tigra në Facebook apo arinj në Instagram. Sepse disa njerëz kanë empati deri në atë pikë sa të vuajnë thellësisht kur ta kuptojnë se pse, te Tommy & Jerry, në një episod gjatë të cilit Tommy vete në Parajsë, para këmbëve i kalon një thes i mbyllur prej ku dalin tre kotele të lagura.

Mizoria e njeriut ndaj kafshëve është shprehur e mizorisë së më të fortit ndaj më të dobët. Sepse, sikurse Mark Carney tha në Davos këtë javë, nëse nuk je në tavolinë, atëherë je në menu. Nëse nuk na shqetëson a së paku turbullon ideja se kafshët, gjallesat e tjera që e banojnë këtë planet, keqtrajtohen çdo ditë gjer’ në skaje, duhet të ndihemi të frikësuar nga potenciali horrorsho që gjendet brenda nesh. Dhe mandej, vetëm eksperimenti i Anthony Burgess te “Portokall me kurdisje”, mbase, mund ta sjellë dynjanë në terezë.

SYLVIA PLATH

Tulipanët

Poemë | Përktheu: Qerim RAQI



Tulipanët janë shumë eksitues, këtu është dimër.
Shih si ka zbardhur gjithçka, mbuluar me dëborë, sa qetë.
Jam shtrirë vetëm, mësoj qetësinë, e qetë
si drita që qëndron në këto mure të bardha,
në këtë shtrat, në këto duar. Jam askushi;
nuk kam asnjë lidhje me shpërthimet.
Emrin dhe rrobat ua kam dhënë infermiereve,
historinë e jetës anestezistit dhe trupin kirurgëve.

Më kanë ngritur kokën midis jastëkut dhe buzës së çarçafit,
si një sy mes dy qepallave të bardha që nuk mbyllen.
Bebëza budallaqe - duhet t'i kenë të gjitha nën kontroll.
Infermieret shkojnë e vijnë, nuk shqetësohen,
lëvizin si pulëbardha mbi tokë me kapelet e tyre të bardha
dhe bëjnë gjëra me duar; njëra i ngjan tjetrës,

ndaj është e pamundur të dallosh sa janë.

Trupi im është një strall për to; ato priren ndaj tij ashtu si uji që synon të rrjedhë mbi gurë, duke i lëmuar butësisht.
Më japin përgjumje me gjilpërat e tyre të shndritshme, më japin gjumë.
Tani që kam hequr dorë nga vetja, jam lodhur nga bagazhet —
valixhen time me vernik që i ngjan një kutie të zezë pilulash,
burri dhe fëmija im duke buzëqeshur në fotografinë familjare;
buzëqeshjet e tyre ngjiten në lëkurën time,
gjemba të vegjël të buzëqeshur.

Kam vënë mallin në det, një vapor mallrash tridhjetëvjeçar që i ngjitet me kokëfortësi emrit dhe adresës.
Më kanë pastruar nga aksesorët e mi të dashur.
E frikësuar dhe e ekspozuar në barelën e gjelbër të mbuluar me plastikë,

pashë kompletin tim të çajit, dollapin tim prej liri, librat e mi tek fundoseshin jashtë syve dhe uji tek ngrihej mbi kokën time. Jam murgeshë tani - kurrë s’kam qenë kaq e pastër.


Nuk doja asnjë lule, doja vetëm të shtrihesha me duart lart dhe të isha plotësisht bosh. Sa çliruese është, nuk e keni idenë sa çliruese. Paqja është aq e madhe sa të verbon dhe nuk kërkon asgjë: as etiketë emri, as bizhuteri. Me kaq përfundojnë të vdekurit, në fund; unë mund t’i shoh duke mbyllur gojën për këtë, si në kungim.

Së pari, tulipanët janë shumë të kuq , më lëndojnë. Edhe përmes letrës së mëndafshhtë mund t’i dëgjoj duke marrë frymë lehtë, me pelena të bardha, si një foshnjë e shëmtuar. Skuqja e tyre më tërheq plagën - përgjigjet. Janë mashtrues: duken sikur notojnë, megjithëse më rëndojnë dhe më mërzhitin me gjuhët e tyre të mprehta dhe me ngjyrën e tyre, me një duzinë lidhëse plumbi të kuq rreth qafës sime.

Askush nuk më shikonte më parë; tani jam e vëzhguar. Tulipanët kthehen nga unë dhe nga dritarja pas meje, ku drita, një herë në ditë, ngadalë zgjerohet dhe hollohet, dhe unë e shoh veten, të sheshtë, qesharake, një siluetë në letër midis syrit të diellit dhe syve të tulipanëve, dhe nuk kam as fytyrë; dua të fshihesha. Tulipanët e etur për jetë më thithin oksigjenin.

Para se të vinin, ajri ishte i qetë, vinte e shkonte, frymëmarrje pas frymëmarrjes, pa fërshëllimë. Pastaj u mbush me tulipanë, si me një zhurmë e madhe. Tani ajri ndalon dhe rrotullohet rreth tyre, si një lumë që ndalon dhe rrotullohet rreth një motori të zhytur në të kuqen të ndryshkur. Ata mprehin vëmendjen time, e cila kënaqet me lojën dhe pushimin pa u lidhur me asgjë.

Duket se edhe muret kanë filluar të nxehen. Tulipanët duhet të mbyllen në kafaz si kafshë të rrezikshme; hapen si hapat e një maceje të madhe afrikane. Ndjej zemrën time që hap e mbyll gotën me lule të kuqe nga dashuria e pastër për mua. Uji që pi është i vakët dhe i kripur si deti, dhe vjen nga një tokë e largët si shëndeti.



Ti thua të mendosh për shpirtin. A nuk është diçka e papërcaktuar kjo? Ç'do të thuash ti me këtë? A kemi ne kohë të qëndrojmë në vend? Ja, kësaj i thonë të mendosh për shpirtin. Të qëndrosh në vend e të merresh me gjëra boshe.

Jo, ia kthehu tjetri, ti po e banalizon. Po ashtu siç na i rrëfeve ti, a nuk dukej gjithçka e pakuptimtë? Ti madje më fyeve, po unë jam mësuar me mosmirënjohjen.

Ç'thua, ti s'hyn fare në këtë çështje? Si s'hykam?! A nuk isha unë që i gjeta atë goxha punë gruas tënde? A nuk ishte ti që, për të mirën që të bëra, më dhe një darkë në Astoria, familjarisht? Jo, mik, jo kështu, nuk i bihet kaq mendjelehtësisht të mirës me shkelm!

Tjetri u çua dhe iku duke e lënë atë fillikat në tavolinën e qoshes, ngjitur me akuariumin, ku një gjarpër shumë i bukur përplot ngjyra po bënte kërdine me peshqit dekorativë, po i hante një nga një.

Po ky nuk mbeti as një minutë vetëm se në kafene hyri ai që kishte djalin ushtar në Afganistan.

Ç'ma plasi shpirtin, tha, as merr në telefon, as na përgjigjet, na ka bërë gjysmë njeriu, mua dhe gruan, që vetëm qan. Iku, fluturoi djali, pa na pyetur. Po unë e di pse iku. Prej dështimit tonë. Kemi dështuar. Pikë. I morëm më qafë fëmijet. Pse? Sepse nuk iu përmbushëm asnjë premtim. I gënjem. E morëm lehtë Amerikën. Përjashtuam punën dhe iu gëzuam bojës. Koka - kola, Playboy, Roberto De Niro, Mafia.. Merre me mend, kur zbrita për herë të parë te JFK, nuk do të

më dukej çudi po të më priste Madona. Pse? As unë nuk e di. Pastaj u hymë punëve derrçe, po hiç gëzim. As sot nuk e kuptoj pse nuk ndjejmë gëzim. Ore, më thuaj ti, pse nuk jemi të gëzuar këtu në Amerikë?

Sa punë bën? e pyeti tjetri. Tre punë. Kam bërë para, po nuk kam zënë karar. Ke fëmijë të tjerë? Tre. Sa herë i shikon? Ç'është kjo pyetje? Aty i kam, në shtëpi.

Me tre punë që bën ti, nuk shqipton me ta as një mirëmëngjes, apo mirëmbërëma. S'ke kohë. Djali të iku ushtar pa të pyetur. Kur të pyeste? Ti s'je..

Epo, vëlla, ndryshe nuk ia del Amerikës.

Ç'bën veç tre punëve? Ç'të bëj? A mendon? Ç'të mendoj?

Se nesër është ekuinoksi, se dita e verës këtë vit bie ditë me shi, se Kenedi e ka patur dashnore Merilin Monronë, se Netet e Kabirias ka fituar Oskar, po regjisorin, Felini, s'ka ardhur për ta marrë, se i ka patur frikë për vdekje fluturimet me avion?

Ore, po këto janë budallallëqe, s'të japin bukë. Pse, ti i mendoke këto?

Patjetër, për hir të tyre, gruaja ime e la punën.

Atë punën në pastrime? Po.

Mos, gjynah, 22 dollarë ora, 60 000 dollarë në vit. Po pse? Prandaj më rri vetëm e m'i ke varur turinjtë?

Po. Sepse nuk më kupton njeri. Ja si

ndodhi. Menazheri i madh, Xhejmsi, e thirri dhe i tha se, nga turni i dytë do të kalonte te i pari. Faleminderit, i tha gruaja. Ishte vërtet gjë e madhe, se s'do të kishte më punë me trenat e nateës, ato trenat e rrallë dhe kohën s'do ta humbte më kot stacioneve nën tokë, as nuk do të rraskapitej rrugëve. Dilja unë dhe e prisja te stacioni, gjithmonë në ora dy të natës. Vetë e merrja turnin në 6 të mëngjesit. Mendoje, mik, ç'sakrificë..Shkon gruaja te menazheri i mëngjesit, Raselli, atje gjen ca shqiptarka nga Mali i Zi dhe Kosova, po edhe nja dy nga Tropoja. Ato e uruan, i thanë se ishte me fat, të zije atë vend pëllumbash, duheshin mbi dhjetë vjet pune, po ajo ia kishte arritur që me katër vjet.. Gruaja është e urtë, ul kokën dhe punon. Ndoshta kjo e ndihmoi. Po ajo u habit fort dhe i pyeti; Moj gra, pse qënkam me kaq shumë fat? Ç'paska ky turni i parë? Si, nuk di gjë, apo je tuj u mahitë me ne? Kur ka overtime, paguhesh dyfish. Gruaja nuk bëri asnjë shenjë që t'i kënaqte sadopak, ndoshta ato gra prisnin që ajo t'u hidhej në qafë. Po atë ditë, si për dreq, e thërret menazheri, Raselli dhe i thotë se, veç turnit të saj do të bënte dhe të dytin, ngaqë punëtorja përkatëse kishte lajmëruar se qe shtruar në spital. Gruaja u trondit. Nuk e bëj dot, i tha. Rasell ngrysi vetullat, belbëzoi; Zonjë, ne na lusin për overtime. Jo, unë nuk e bëj dot, këmbënguli gruaja dhe e dërguan në shtëpi. Shoqet e punës e quajtën " të shkame." E lanë pa punë. Nuk i telefonojnë më, megjithëse i premtuan. Unë them se bëri mirë.

A je në vete? shpërtheu tjetri, nuk pranoi të bënte overtime? Kulmi! E vizitove gruan te mjeku? Të thonë, na para me grushte dhe ti t'i refuzosh? Kësaj i thonë çmenduri. Po pse, pse?

Sepse ne kemi dy djem që vazhdojnë universitetin këtu në Nju Jork dhe ajo ju përgatit drekën siç e duan ata dhe i pret kur vijnë dhe në mëngjes i përcjell për në shkollë. Këmben fjalë me ta, shkrihet me fëmijët, ndjen shpirtin, pra merret dhe me shpirtin. Do t'i mungonte kjo!

Tjetri u ngrit dhe e la vetëm. Veç tundi njëhën dorë në ajër sikur largoi një mizë. Shkoi atje ku turma ishte më e madhe, tejet e zhurmshme gati hysterike prej politikës. Atij i pëlqente kur të tjerët merreshin me hallin e tij, djalin ushtar në Afganistan, herë dukej entuziast, herë i dëshpëruar, sikur priste të fitonte llotarinë, ose ta humbte. Kur dikush ia quante djalin hero, ai shtonte se kjo punë kishte shumë benifite, zëre se i thojë Amerikës, deri tani të kam parë unë ty, tani më shiko ti mua, por, kur ndonjë tjetër shtonte; t'u ktheftë shëndoshë e mirë, djali, ai merrte pamjen e një prindi të mjerë që e mundojnë parandjenjat dhe frikërat.

Në akuarium kishte mbetur vetëm një peshk i kuq dhe gjarpëri që e ndiqte.

Nju Jork 2011

Në një nga mbrëmjet e dimrit të vitin 1786, në periferi të Vjenës, në një shtëpi të vogël prej druri po vdiste një plak i verbër, ish-kuzhinieri i konteshës Tun. Me thënë të vërtetën, nuk ishte as shtëpi, por një kabinë roje e rrënuar, e vendosur në thellësi të kopshtit. Kopshti ishte i mbushur me degë të kalbura, të rrëzuara nga era. Pas çdo hapi degët kërcisnin dhe atëherë qeni roje fillonte të ulërinte ngadalë në koliben e tij. Ai gjithashtu po vdiste, si pronari i tij, nga pleqëria dhe nuk mund të lehte më. Disa vite më parë kuzhinieri ishte verbuar nga nxehtësia e furrave. Kujdestari i konteshës e strehoi në kabinën e rojes dhe herë pas here i jepte disa florinj. Së bashku me kuzhinierin jetonte bija e tij, Maria, një vajzë tetëmbëdhjetëvjeçare. Të gjitha orënditë e kabinës përbëheshin nga një krevat, stola të thyer, një tavolinë e ashpër, enë prej balte të plasaritura dhe, së fundmi, një klaviçembal, thesari i vetëm i Marisë. Klaviçembali ishte aq i vjetër sa telat e tij këndonin gjatë dhe qetë në përgjigje të të gjitha tingujve përquarë tij. Kuzhinieri, duke qeshur, e quante klaviçembalin “rojtarin e shtëpisë”. Askush nuk mund të hynte në shtëpi pa e përshëndetur klaviçembali me gumëzhimën e tij dridhëse dhe pleqërishte. Kur Maria e lau njeriun që po vdiste dhe e veshi me një këmishë të ftohtë e të pastër, plaku tha:

— Gjithmonë nuk i kam dashur priftërinjtë dhe murgjit. Nuk mund të thërras një rrëfyes, megjithatë duhet ta pastroj ndërgjegjen time para se të vdes.

— Çfarë duhet të bëj? - pyeti Maria e frikësuar.

— Dil në rrugë, - tha plaku, - dhe kërkoji personit të parë që do takosh, të vijë në shtëpinë tonë për të dëgjuar rrëfimin e njeriut që po vdes. Askush nuk do refuzojë.

— Rrugë jonë është e shkretë... - pëshpëriti Maria, hodhi shallin rreth qafë dhe doli.

Vrapoi nëpër kopsht, hapi portën e ndryshkur me vështirësi dhe u ndal. Rrugë ishte e zbrazët. Era i solli gjethet drejt saj, kurse nga qielli i errët binin pikat e ftohta të shiut. Maria priti gjatë duke dëgjuar. Më në fund iu duk se dëgjoi një burrë që ecte pas çakëllit dhe këndonte. Ajo bëri disa hapa, u përplas me të dhe bërtiti. Burri u ndal dhe pyeti:


— Kush jeni?

Maria i kapi dorën dhe me një zë të dridhur ia përcolli kërkesën e babait të saj.

— Mirë, - tha burri qetësisht. - Edhe pse nuk jam prift, nuk ka rëndësi. Shkojmë.

Ata u futën në shtëpi. Nën dritën e qirinjve, Maria pa një burrë të vogël dhe të dobët. Ai hodhi pelerinën e tij të lagur mbi një stol. Ishte veshur me elegancë dhe thjeshtësi, drita e qirinjve shkëlqente në jelekun e tij të zi, butonat prej kristali dhe gajtanët. I panjohuri ishte ende shumë i ri. Tundi kokën në mënyrë djaloshare, rregulloi paruken e pudrosur, tërhoqi shpejt një stol pranë shtratit, u ul dhe, duke u përkulur, shikoi me vëmendje dhe gëzim fytyrën e burrit që po vdiste.

— Rrëfehuni! - tha ai. - Ndoshta me një fuqi që nuk më është dhënë nga Zoti, por nga arti të cilit i shërbej, do t’jua



lehtësoj çastet e fundit dhe do t’jua heq barrën nga shpirti.

— Punova gjithë jetën, derisa u verbova, - pëshpëriti plaku. - Dhe ata që punojnë nuk kanë kohë të mëkatojnë. Kur gruaja ime u sëmur, ajo quhej Marta, mjeku i mbushi një receteë me ilaçe të ndryshme të shtrenjta dhe më këshilloi që ta ushqenin me krem, fiq dhe verë të kuqe të nxehtë, prandaj vodha një pjatë të vogël ari nga servisi i konteshës Tun, e bëra copa-copa dhe e shita. Tani më vjen rëndë ta kujtoj dhe ta fsheh nga vajza ime sepse e mësova të mos prekte as edhe një grimcë pluhuri nga tavolina e huaj.

— A vuajti ndonjë nga shërbëtorët e konteshës për këtë? - pyeti i panjohuri.

— Beto hem, zotëri, askush, - u përgjigj plaku dhe filloi të qajë. - Nëse do ta dija që ari nuk do ta ndihmonte Martën time, si do të mund ta vidhja vallë!

— Si ju quajnë? - e pyeti i panjohuri.

— Johan Mejer, zotëri.

— Kështu, Johan Mejer, - tha i panjohuri dhe vuri pëllëmbën mbi sytë e verbër të plakut. - Ti je i pafajshëm para njerëzve. Ajo që ke bërë nuk është

as mëkat as vjedhje, por, përkundrazi, mund të llogaritet për ju si një akt dashurie.

— Amin! - pëshpëriti plaku.

— Amin! - përsëriti i panjohuri. - Dhe tani më thoni amanetin e fundit.

— Dua që dikush të kujdeset për Marian.

— Do ta bëj këtë. Çfarë doni tjetër?

Atëherë burri që po vdiste, buzëqeshi papritur dhe tha me zë të lartë:

— Do të doja ta shihja përsëri Martën ashtu siç e takova në vitet e rinisë. Të shihja diellin dhe këtë kopsht të vjetër kur lulëzon në pranverë. Por kjo është e pamundur, zotëri. Mos u zemëroni me mua për fjalët e mia budallaqe. Sëmundja duhet të më ketë çoroditur fare.

— Mirë, - tha i huaji dhe u ngrit. - Mirë, - përsëriti ai, shkoi te klaviçembali dhe u ul në stolin para tij. - Mirë! - tha ai me zë të lartë për herë të tretë dhe papritmas një tingull i shpejtë u shpërnda në të gjithë kabinën, sikur ranë në dysheme qindra topa kristali.

— Dëgjoni, - tha i huaji. - Dëgjoni dhe shikoni.

Ai filloi të luante në instrument.

Maria më vonë kujtoi fytyrën e të panjohurit, kur çelësi i parë u dëgjua nën dorën e tij. Një zbehje e pazakontë i mbuloi ballin dhe një flakë qiriri lëkundej në sytë e tij të errësuar.

Klaviçembali ushtoi me volum të plotë për herë të parë pas shumë vitesh. Ai mbushi me tinguj jo vetëm kabinën, por gjithë kopshtin. Qeni plak doli nga kolibja e tij, u ul, anoi kokën në njërën anë, vështronte me vëmendje dhe tundte bishtin në heshtje. Filloi të binte breshër, por qeni thjesht tundte veshët.

— E shoh, zotëri! - tha plaku dhe u ngrit nga shtrati. - E shoh ditën kur takova Martën dhe kur nga sikleti ajo theu enën e qumështit. Ishte dimër në male. Qielli ishte i pastër si qelqi blu dhe Marta qeshi. Qeshi, - përsëriti ai, duke dëgjuar zhurmën e telave.

I panjohuri vazhdoi të luajë duke shikuar nga dritarja e zezë.

— Po tani, - pyeti ai, - a shihni ndonjë gjë?

Plaku heshtte, duke dëgjuar.

— Nuk e shihni, vallë, - tha shpejt i panjohuri, pa e ndaluar luajtjen, - se nata është kthyer nga e zeza në blu, pastaj në blu të çelët, se një dritë e ngrohtë po bie tashmë nga diku lart, se në degët e vjetra të drurëve tuaj po çelin lule të bardha? Sipas meje, këto janë lule molle, edhe pse nga dhoma duken si tulipanë të mëdhenj. E shihni: rrezja e parë e dritës ra mbi çakëll, e ngrohu atë, dhe prej tij po ngrihen avuj. Ky duhet të jetë myshku që po thahet, i mbushur me borën e shkrirë. Kurse qielli po bëhet akoma më i lartë, më blu, më madhështor, dhe tufa zogjsh tashmë po fluturojnë në veri mbi Vjenën tonë të lashtë.

— I shoh të gjitha këto! - bërtiti plaku.

Pedali kërciste lehtë dhe klaviçembali filloi të këndonte triumfalisht, sikur të mos ishte vetëm ai, por qindra zëra të gëzuar.

— Jo, zotëri, - i tha Maria të panjohurit, - këto lule nuk duken fare si tulipanë. Këto janë mollë që çelën brenda një nate të vetme.

— Po, - u përgjigj i panjohuri, - këto janë mollë, por kanë petale shumë të mëdha.

— Hape dritaren, Maria, - kërkoj plaku.

Maria hapi dritaren. Ajri i ftohtë vërshoi në dhomë. I huaji luante shumë butë dhe ngadalë.

Plaku ra mbi nënkresë, mori frymë me etje dhe po kërkonte në batanije me duar. Maria u vërsul drejt tij. I panjohuri ndaloi së luajturi. Ai rrinte pa lëvizur te klaviçembali, si dikush që magjepset nga muzika e vet.


Maria bërtiti. I panjohuri u ngrit dhe shkoi te shtrati. Plaku tha duke dihatur:

— Pashë gjithçka kaq qartë si shumë vite më parë. Po nuk do të doja të vdisja pa ditur... emrin. Emrin!

— Emri im është Wolfgang Amadeus Mozart, - u përgjigj i panjohuri.

Maria u largua nga shtrati dhe u përkul para muzikantit të madh, gjuri i saj pothuajse preku dyshemenë. Kur ajo u drejtua, plaku tashmë kishte vdekur.

Agimi po lindte jashtë dritareve dhe në dritën e tij qëndronte një kopsht i mbushur me lule të lagështa dëbore.



Karikaturë nga Arben Mexsi

Interesi im për pikturat e Velazquesit ka qenë interes i natyrshëm i një njeriut që ka pasur adhurimin për njërin nga piktorët më të mëdhenj të njerëzimit. E megjithatë, është vizita ime e parë në Madrid, në vitin 1997, që më dha dhe rastin që të vizitojë Prado Museum, dhe të shoh nga afër gjashtë Piktura origjinale të Velazquezit. Mes tyre dhe Las Meninas. Këto ditë, kur shtypi anglez flet i entuziamuar për ekspozimin për herë të parë të Las Meninas në National Gallery of Art të Londrës, në pjesën veriore të Trafalgar Square, kujtimi i vizitës time të parë në Madrid më vjen vetvetiu. Për mua, Madridi është Las Meninas i Velazquezit.

Las Meninas është njëra nga pikturat më enigmatike, por dhe më të thella, më të fuqishme e më intriguese të Artit Botëror. Është një vepër që, për ca arsye jo shumë të qarta, më krijon një asosacion të mistershëm me ‘Melankolia, të Albert Dürer dhe pikturat e Bosch-it. Edhe pse të tre këta piktorë janë aq të pangjashëm me njëri-tjetrin. Las Meninas mbetet dhe piktura më e interpretuar deri më sot nga të gjithë veprat e Artit, jo vetëm se është dhe përfaqësia më e madhe e Artit piktoral në kulturën Perendimore, por njëkohësisht se është vepra më shumëplanëshe dhe më enigmatikja. Las Meninas, në mënyrën më paradoksale, duke qenë më e interpretuara, mbetet më pak e njohur nga të gjitha veprat e tjera të Artit. Michel Foucault i ka kushtuar njërin ndër studimet e veta më serioze filozofike dhe strukturale veprës së Velazquez, duke aplikuar në studimin e Las Meninas atë që ai e quan Arkeologji të Dijes. E prapë as studimi i Foucault- dhe mijëra studime të tjera nuk kanë qenë as shteruese dhe as të kënaqshme. Piktura e Diego Velazquez mbetet shembulli i veprës së hapur, që pranon me mijëra interpretime, interpretime të cilat sa më tepër i afrohen kuptimit të vërtetë të Pikturës, aq më shumë i largohen asaj.

Le t’i afrohem vizualisht veprës Las Meninas. Nga pikëpamja kompozicionale, Piktura ka tre vatra përqendrimi (fokale) brenda kompozimit- Figura e Infantes Margarita e rrethuar nga La Meninas, figura e Vezaquezit në Studion e tij (në sfond duken të ekspzouar dy piktura të Rubensit), dhe figurat e Mbretit dhe Mbretëreshes. Piktura, e cila duhej të ishte një portret i Mbretit dhe i Mbretëreshës, në fakt është një pikturë paradoksale-Mbreti dhe Mbretëresha shfaqen vetëm të reflektuar në një pasqyrë në cakun e errët fundor të një dhome me tavane të lartë. Ne, shikuesit e tablosë, shohim atë që shohin Mbreti dhe Mbretëresha: alarmin e las Meninas dhe të Infantes Margarita që vënë re praninë e Monarkëve. Mbreti dhe Mbretëresha supozohen të jenë jashtë tablosë, por reflektimi i tyre në pasqyrë i vendos ato brenda tablosë. Vështrimi i Infantes dhe i shërbyesve të saj janë drejtuar nga vendi ku janë Monarkët. Realisht vetë Mbreti është duke pozuar para Velazquez-it, piktorit Mbretëror, i cili shfaqet i zymtë, dhe dinjitar tek na vështron që pas telajos. Velazquez duket sikur na thotë se ai është duke parë atë që shohin Monarkët: një botë të vogël dhe të ankthshme. Infanta ndjehet nervoze dhe e shqetësuar nën vështrimin e Las Meninas (Damave të Veshjes). Dy xhuxhët dhe qeni janë atje që të krijojnë skena gazmore. Por prapë skena nuk është gazmore, edhe kur njëri nga xhuxhët shkelmon qenin. Është bota e vogël dhe e pasigurtë e Oborrit dhe e Oborrtarëve. Është një botë që reflektohet në pasqyrë dhe po nga pasqyra ne e kuptojmë se është bota e vëzhguar nga Monarkët. Skena është thellësisht teatrale, e shtirë, të gjithë duken sikur nxitojnë të aktojnë sa më mirë rolet e veta: të gjithë, veç Velazquez. Në deren e largët të sfondit fundor duket një burrë që sapo hynë duke sjellë lajmet më të fundit të Perandorisë së pafundme. Por edhe ky është jashtë fokusit të Piktorit, dhe ekziston në Tablo vetëm e vetëm nga reflektimi në pasqyrë. Vetë Tabloja kthehet në një lojë pasqyrash. Piktura është kështu një meditim për natyrën e përfaqësimit dhe realitetit, artit dhe natyres. Teoria e Artit në Renesans e vendos Intellectin në qendër të krijimtarisë artistike. Në las Meninas iluzioni i realitetit të përditshëm ka prioritet. Është piktura e pikturës iluzionistike. Velazquez shfrytëzon mjeshtërisht kontrastin e ngjyrave, duke ndriçuar pamjen ballore, njerëzit në figura solide në poza nga më të ndryshme, dhe hapësirën e gjerë, të hijshme që i rrethon këto figura. Gjashtë figurat ballore reagojnë nga hyrja e mbretit në mënyra të ndryshme. Luka Giordano, jo shumë kohë pas

MBRETI? KU ËSHTË AI?

Ese nga Rudolf Marku

vdekjes së Velazquez, e ka quajtur las Meninan *Një Teologji të Artit të Pikturës...*Realiteti, ajo që ekziston, vihet në rrezik nga iluzioni i identiteteve. Piktura kthehet kështu në një pasqyrë magjike...I vetmi realitet duket se është portreti i Velazquez-it, i cili, me praninë e vet të fuqishme, duket sikur thotë- Monarku i vetëm jam unë, Mbreti i vetëm është Artisti, është Shpirti njerëzor, është Intellecti, është Dija, dhe vetëm këto mund të krijojnë realitete mbi realitetet ekzistuese dhe iluzive, Mbretëri mbi Mbretëritë...

Por, ndryshe nga ç’mund të mendojnë mendjet sekmatiche, e gjitha kjo nuk ka të bëjë me ndonjë pakënaqësi të Velazquez-it ndaj Monarkut të vet, Filipit të Katërt, i cili ishte një njohës i shkëlqyer i Artit dhe i cili qe mbrojtësi, përkrahësi dhe dashamirësi më i madh i Velazquez-it dhe i shumë piktorëve të tjerë gjenialë. Çështja është se vetë Monarku, po aq sa dhe Piktori gjenial, e kishte pranuar rolin

suprem të Artit, avantazhin e mbretërimit të përgjeshëm të Artit në raport me Mbretërimin e përkohshëm politik. Është vetëdija se Krijuesi i Madh, edhe kur jeton në Oborrin e një Mbreti, është ai Monarku i vërtetë, se në të vërtetë janë të tjerët, duke përfshirë dhe vetë Mbretin, ata që janë oborrtarët, ata që jetojnë në të vërtetë në Oborrin e Piktorit a Poetit të Madh...Velazquez i qe bashkuar Oborrit Mbretëror që në moshën 24-vjeçare, dhe vetë Mbreti, sipas një bashkëkohësi, ishte ftuar nga Piktori i madh gjatë seancave kur krijonte Las Meninas, duke ia zgjatur atij furçën, që të shtonte në Tabllo dhe ai diçka nga vetja e vet. Pa harruar dhe atë britmën e Mbretit pasi dëgjoi për vdekjen e Velazquezit: “Vdekja e tij është rrënimi im”. Është koha kur Monarkët dhe udhëheqësit e pranojnë Artin, Dijen, Intellectin si vlerat sublime të Njeriut. Është Koha e Artë kur Arti pranohet si e kundërta e banalitetit, vulgaritetit, dhunës,

idiotësisë, baltës, vagabontazhit, kobures në pushtet dhe në politikë!

Vendosja e Vetë- Portretit të Velazquezit në Las Meninas i ngjan rastit të Fidiasit, skulptorit dhe piktorit të famshëm të Greqisë i cili e pat vendosur portretin e vet në mburojën e Perëndeshës Minerva, në atë mënyrë, që, po qe se portreti i Fidiasit do të hiqej, do prishej e gjithë skulptura e Minerves. Perëndesha Minerva nuk do të mund të qëndronte pa portretin e Krijuesit, po ashtu si dhe piktura e Velazquez pa portretin e vet. Edhe Velazques dhe vetë Monarku tashmë e kishin shpallur dhe pranuar të vërtetën se Minerva, Zotat tokësor, Perandorët dhe Mbretërit nuk mund ta shkatërronin Artin, Intellectin, Dijen, sepse, në çastin kur do të pranonin ta hiqnin figurën e krijuesit, ato do të mohonin vetveten.

Miqtë e mi që jetojnë, në Tiranë, do më kuptojnë më mire për këtë shkrim modest për Velazquez-in.



Diego Velázquez, *Las Meninas*, 1656

Fotografi drejton aparatën tek objekti që ka zgjedhur dhe në bashkohemi vështrimit të tij, shpesh duke e “harruar” atë vetë. Vetëm, pasi jemi mbushur me mbresa, ide, mendime, vjen një çast dhe e kthejmë kokën pas nga vetë ai. Ka kaluar më shumë se një vit nga ardhja e fotografit të njohur shqiptaro-kroat, Luka Mjeda, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, i ftuar nga Qendra e Studimit të Arteve, pranë këtij institucioni. Ai mbajti një *lectio magistralis* me temë “Arkitekti dhe skulptori Andrea Alessi në thjerrën e aparatit tim”. Përmes fotografive të tij, u njohëm me veprën e arkitektit të madh shqiptar Andrea Alessi, një zë me peshë në arkitekturën e Rilindjes kroate dhe evropiane: arkitekt, piktor dhe skulptor i famshëm. Luka Mjeda, si fotograf, na e sjell përmes objektivit dhe detajeve që zbulohen në librin e Andrija Mutnjaković-it: “Andrea Alessi - Artist i Rilindjes së Hershme”. Në libër zbulohet biografia e Andrea Alessi-t, i cili lindi në Durrës më 1425 dhe u zhvendos në Dalmaci, duke bërë emër në fushën e arkitekturës. Që në rini shkoi në Split të Dalmacisë dhe aty studioi pranë skulptorit Mark Troja. Është autor i statujave të lozhës së tregtarëve në Ankona të Italisë, i 1454 afreskeve në një kishë të ishullit Arabe të Dalmacisë, ndërsa kryevepra e tij mbahet *Pagëzimorja e Trogirit* e cila ndodhet në katedralen e Shën Lorencit. Megjithatë, gjurmët e punëve të tij ndihen edhe në pallatet e Trogirit përreth, në atë të peshkopit Torlon dhe veçmas në pallatin përkundruall portës kryesore të katedrales, *Palazzo di Coriolano Cippico*, ku portali disakatësh me dritaret me tri harqe (trifore), në kapelën e Shën Gjonit shihet si kryevepër e Andrea Alessit. Po kush është vetë Luka Mjeda? I lindur më 26 dhjetor 1952 në Zagreb nga prindër me origjinë nga Prizreni, është një nga fotografët më të njohur bashkëkohorë kroatë. Fillimisht studioi inxhinieri mekanike dhe ndërtimi në Zagreb, por e la për fotografinë pas takimit me fotografë amerikanë si Mary Ellen Mark, Michael O’Neil dhe Jerry Uelsmann më 1975, duke u bërë anëtar i *Fotoklub Zagreb* dhe duke filluar praktikën e tij profesionale. Pas punës 5-vjeçare në fushën e dizajnit grafik dhe bashkëpunimit me revista dhe media të ndryshme, Mjeda u bë fotograf i pavarur në vitin 1980. Ai është anëtar i ULUPUH (Shoqata Kroate e Artistëve të Artit të Aplikuar), HZSU (Shoqata Kroate e Artistëve të Pavarur) dhe themelues e president i Qendrës Kroate të Fotografisë që nga 2006. Mjeda njihet për fotografitë e tij me tonalitete të forta, shpesh në bardhë e zi, me fokus tek arkitektura dhe detajet urbane, duke shprehur një ndjeshmëri unike vizuale dhe reflektim historik


Luka Mjeda, artisti kroat me origjinë shqiptare, e ka shprehur disa herë se fotografinë e ka mësuar në mënyrë autodidakte dhe mësues ka pasur të gjithë ata fotografë me të cilët është lidhur nëpër aktivitete të ndryshme. Kthesa ndodhi pas një seminari në Zagreb në vitin 1975 ku u njoh me disa fotografë amerikanë dhe shfaqti një interes të madh në fotografi.

Studiuesit e artit fotografik të Mjedës, kanë vënë re menjëherë, se një pjesë e rëndësishme e fokusit të tij krijues është fotografimi i ndërtesave. Këtu luan rol

Një profil i fotografit të njohur shqiptaro-kroat, Luka Mjeda

Mjeda i Zagrebit “E bardha dhe e zeza mbeten të bukura”

Përgatiti: Durim Taçi



edhe njohja e tij e thelluar e arkitekturës. Fotografia e tij e parë e këtij lloji është realizuar në Venecia, kurse pas katër viteve, ai u vendos në Francë ku filloi edhe ciklin e tij *Crystal Sky*, për të vazhduar më tej në Amerikë, Gjermani dhe Kroaci.

Sipas tij, ndërtesat tregojnë që njeriu ka nevojë të ngjitet çdo herë lart e më lart, kurse vetë cikli i fotografive paraqet filozofinë e jetës së tij në të cilën ngjyrt

nuk kanë rëndësi. Ai shprehet se në procesin e të kujtuarit, ka harruar edhe tonalitetin e ngjyrave prandaj për të vetëm e bardha dhe e zeza kanë rëndësi. Fotografitë bardh e zi të ndërtesave, por edhe të njerëzve, mbesin gjithmonë të bukura.

Siç është shprehur ai, fotografia sot ka marrë përmasë universale: të gjithë që kanë një fotoaparatur apo kompjuter mund të bëjnë fotografi, por për të qenë

fotografë duhet të realizosh cikle të tëra me fotografi të mira dhe jo vetëm një.

Luka Mjeda ka zhvilluar shumë portretin në fotografinë e tij. Ai është autori i portreteve të 80 artistëve kroatë, porositur Ministria e Kulturës në Kroaci.


Ai ka prezantuar punën e tij në shumë ekspozita vetjake në vende të ndryshme gjatë viteve ’80 dhe ’90 si Varaždin, Split, Kopenhagen dhe shumë qytete tjera evropiane. Të parën ekspozitë publike e hapi më 1984, në Zagreb – Galeria Gjurro. Ka ekspozuar veprat e tij në Muzeu i Arteve dhe Zejeve (Zagreb) në 2006. Më vonë edhe në Nottingham, UK (Gallery 1851), 2001, në Los Angeles – *Photo Independent*, 2015. Në Prishtinë – *Galeria Kombëtare e Kosovës*, 2016 (ekspozitë personale me cikle si “Blue box”, “Crystal city”). Ai ka gjithashtu ekspozita specifike dhe tematike si: “Andrea Alessi” – Muzeu Mimara në Zagreb (2019); ekspozitë fotografike kushtuar veprave të skulptorit dhe arkitektit të hershëm rilindas me origjinë nga Durrësi (Albania), Andrea Alessi. “Portret Hrvatske 2020” – Muzeu Mimara (2020); projekt dhe ekspozitë që paraqet portrete të qytetarëve të Kroacisë

Ka marrë pjesë gjithashtu në ekspozita kolektive me fotografë të tjerë, përfshirë: *Zagreb Salon* (45th Zagreb Salon), Muzeu Mimara – Aktualno series, ekspozita në *São Paulo (BRA)*, *Buenos Aires (ARG)*, *Santiago (CHI)* me projekte të fotografisë kroate etj. Ai ka gjithashtu disa botime dhe monografi me veprat e tij, si autor dhe portretist.

Një nga ekspozitat e tij më të famshme është “*Teeth as Art*” – *Atelier LM* (Zagreb, 2024): ekspozitë ku ka prezantuar fotografi kreative të dhëmbëve të neandertalëve të kapura përmes lenteve të fotografisë si formë arti. Për të cilën antropologu David Frayer shprehet: “Çfarë sheh artisti Luka Mjeda? A janë thjesht dhëmbë apo fosile të vjetra e të pista? Jo për të dhe jo për këta dhëmbë. Përtej rëndësisë së tyre antropologjike, këta dhëmbë përmbajnë një komponent surreal – një koncept të ndryshimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit të njerëzimit gjatë historisë së lashtë. I intriguar nga kjo ide, ai i lejoj vetes të manipulojë imazhet origjinale dhe të krijojë një perspektivë të re dhe një homazh ndaj mënyrës se si ne shohim dhëmbët si art...”

Ndërsa antropologu tjetër i njohur John Hawks, thotë: “Fotografia dokumentuese e frymëzoi Mjedën të bënte diçka të veçantë: ai filloi të konceptojë dimensionin artistik të dhëmbëve, përmes ngjyrës dhe modelit. Mjeda krijoi një seri printesh artistike që luajnë me format e këtyre dhëmbëve, duke nxjerrë në pah një seri portretesh befasuese dhe evokuese.

Redaktorja e *Teeth as Art* është shkrimtarja kroate Edda Dubravec, e cila duke reflektuar mbi punën e Mjedës, shqyrton se si detajet e dhëmbëve linden vizionin e artistit: “Dhëmbë që përtypnin ushqimin, dhëmbë që ndoshta dhëmbnin sepse kishin karies ose ndonjë dëmtim tjetër, u bënë imazhe të pazakonta, abstrakte dhe realiste njëkohësisht, të cilat ne mund t’i shohim dhe t’i përjetojmë si forma kristalore, imazhe në të cilat mund të hyjmë në një lloj spiraleje kujtese, ndoshta edhe njohjeje...”





“Nuk ka asgjë si mërzia që të të shtyjë të shkruash”: Një intervistë e rrallë me Agatha Christie-n e pakapshme

Greg McKevitt

Misteret e vrasjeve të Agatha Christie-t kanë magjepsur audiencat për më shumë se një shekull, por, 50 vjet pas vdekjes së saj, ajo mbetet një enigmë. Një intervistë e rrallë e BBC-së nga viti 1955, zbulon disa nga sekretet e një shkrimtareje që ishte po aq komplekse sa edhe subjektet e saj.

Dame Agatha Christie ishte mjeshtre në fshehjen para syve të të gjithëve. Ajo paraqitej si një zonjë e moshuar e dashur, me pallto gëzofi, që i pëlqente kopshtaria, ushqimi i mirë, familja dhe qentë, por pas asaj pamjeje të ngrohtë ajo kënaqej duke thurur histori bestseller me helmime, tradhti dhe gjak. Dhe ajo jepte pak të dhëna për mekanizmat e brendshëm të mendjes së saj gjeniale. Christie ishte jashtëzakonisht e turpshme, por në vitin 1955 u bind të jepte një intervistë të rrallë në apartamentin e saj në Londër për një profil radiofonik të BBC-së. Në të, ajo zbuloi se si një fëmijëri jokonvencionale i ndezi imagjinatën, pse shkrimi i dramave ishte më i lehtë se shkrimi i romaneve dhe si mund ta përfundonte një libër për tre muaj.

E lindur si Agatha Miller në një familje të pasur në vitin 1890, ajo u arsimua kryesisht në shtëpi. Kur u pyet pse iu përkushtua shkrimit, Christie tha: “Unë ia atribuoj gjithçka faktit se nuk kam pasur kurrë ndonjë arsimim. Ndoshta duhet ta sqaroj këtë duke pranuar se më vonë shkova në shkollë në Paris kur isha 16 vjeç ose aty rrotull. Por deri atëherë, përveçse më ishte mësuar pak aritmetikë, nuk kisha pasur pothuajse asnjë mësim fare.”

Christie e përshkroi fëmijërinë e saj si “mrekullisht të plogët”, por kishte një oreks të pangopur për lexim. “E gjeta veten duke trilluar histori dhe duke luajtur role të ndryshme, dhe nuk ka asgjë si mërzia që të shtyjë të shkruash. Kështu që, kur isha 16 ose

17 vjeç, kisha shkruar mjaft tregime të shkurtra dhe një roman të gjatë e të mërzitshëm.” Ajo tha se e përfundoi shkrimin e romanit të saj të parë të botuar në moshën 21-vjeçare. Pas disa refuzimeve, *Vrasje enigmatike në Stails* u botua në vitin 1920, duke prezantuar krijimin e saj më të famshëm, Hercule Poirot.

Metoda e vrasjes me helm që ajo zgjodhi për tregimin vinte drejtpërdrejt nga përvoja e saj personale gjatë Luftës së Parë Botërore. Ndërsa bashkëshorti i saj i parë, Archie Christie, ishte i dërguar në Francë, ajo punoi në frontin e brendshëm si infermiere vullnetare në një spital për ushtarët e plagosur. Ajo u bë asistente në farmacinë e spitalit, gjë që i dha njohuri për barnat dhe helmet. Në tregimet e saj, helmi përdoret në 41 vrasje, tentativa vrasjeje dhe vetëvrasje.


Formula tipike e Christie-t fillon me një rreth të ngushtë të dyshuarish nga e njëjta botë shoqërore dhe një vrasje që gjeneron pista, të cilat çojnë drejt e në përballjen kulmore. Në qendër është një detektiv privat, si Poirot ose Miss Marple, i cili e zbërthen misterin dhe ua zbulon të vërtetën të gjithëve në një skenë finale dramatike. Kjo strukturë, e njohur por pafundësisht e përshtatshme, është pjesë e asaj që e bën veprën e Christie-t kaq të qëndrueshme në kohë.

Në vitin 1926, ajo botoi *Vrasja e Roxher Akrojdrit*, një libër që e forcoi reputacionin e saj profesional, edhe pse jeta e saj personale po shpërbëhej atë vit. Nëna e saj e dashur vdiq dhe Archie pranoi se ishte dashuruar me një grua tjetër. Ai kërkoi divorc. Duke u përballur me pikëllimin dhe bllokimin krijues, vetë Christie u bë subjekt i një misteri. Në një natë të ftohtë dhjetori, makina e saj e aksidentuar u gjet në një vend të shkretë panoramik në Surrey, e balancuar rrezikshëm mbi një gurore gëlqerore. Policia gjeti pallton e saj prej gëzofi dhe lejen e drejtimit në makinë, por nuk kishte asnjë shenjë të saj.

U nis një nga kërkimet më të mëdha ndonjëherë në Britani për një person të zhdukur. Historia kishte të gjitha elementet e një sensacioni tabloidësh: romancierja e famshme e krimi që ishte zhdukur duke lënë pas një varg gjurmësh joshëse, e bija shtatëvjeçare e lënë pas dhe bashkëshorti simpatik i përfshirë me një të dashur më të re. Madje u përfshi edhe autori i Sherlock Holmes-it, Sir Arthur Conan Doyle, i cili punësoi një medium për t’u lidhur me Agathën përmes njëres prej dorezave të saj.

Udhëtime në Lindjen e Mesme

Dhjetë ditë më vonë, ajo u zbulua 230 milje larg vendit të aksidentit, në një hotel në Harrogate, North Yorkshire. Teoritë u shumuan: a ishte zhdukja e saj rezultat i humbjes



së kujtesës, një përpjekje e llogaritur për ta vënë në siklet bashkëshortin, apo madje një marifet publicitar? Christie zgjodhi të mos e sqaronte misterin në autobiografinë e saj, duke shkruar vetëm: “Pra, pas sëmundjes, erdhën trishtimi, dëshpërimi dhe thyerja e zemrës. Nuk ka nevojë të zgjatemi për këtë.”


Ajo ishte po aq e drejtpërdrejtë edhe për sekretet e stilit të saj të punës, duke i thënë BBC-së në vitin 1955: “E vërteta zhgënjyese është se nuk kam ndonjë metodë të veçantë. I shtyp vetë dorëshkrimet e mia në një makinë shkrimi të vjetër e besnike që e kam prej vitesh, dhe më duket i dobishëm diktafoni për tregime të shkurtra ose për riformulimin e një akti të një drame, por jo për punën më të ndërlikuar të ndërtimit të një romani.”

Në vitin 1930, Christie u martua me Max Mallowan-in, një arkeolog 14 vjet më të ri se ajo, gjashtë muaj pasi e kishte takuar gjatë një udhëtimi në Irak. Me pasionin e përbashkët për kulturat e lashta, udhëtimet e çiftit në Lindjen e Mesme frymëzuan tregime si *Vdekje në Nil*, i botuar për herë të parë në vitin 1937. Lumturia e saj e sapogjetur dukej se pati një ndikim të thellë në punën e saj: gjatë nëntë viteve pasuese, ajo do të shkruante 17 romane të plota.

Për Christie-n, kënaqësia kryesore e shkrimit vinte nga krijimi i subjekteve të saj të zgjuara. Ajo tha: “Mendoj se puna e vërtetë bëhet duke menduar zhvillimin e historisë suaj dhe duke u shqetësuar për të derisa të marrë formën e duhur. Kjo mund të marrë mjaft kohë. Pastaj, kur i keni të gjitha materialet gati, si të thuash, gjithçka që mbetet është të përpigjeni të gjeni kohë për ta shkruar. Tre muaj më duken një kohë krejt e arsyeshme për të përfunduar një libër, nëse mund t’i përkushtohesh plotësisht.”

Në profilin radiofonik të vitit 1955, impresario i teatrit Sir Peter Saunders, i cili prodhoi shfaqjen e saj me sukses të jashtëzakonshëm *The Mousetrap*, tha se Christie kishte një dhunti të jashtëzakonshme për të krijuar në mendje skena dhe histori të plota. “Njëherë i thashë: ‘Si po shkon shfaqja e re?’ ‘Ka mbaruar,’ më tha ajo. Por kur e pyeta nëse mund ta lexoja, ajo u përgjigj kaq çarmatosëse: ‘Oh, nuk e kam shkruar ende.’ Nga këndvështrimi i saj, shfaqja nga fillimi deri në fund ishte e menduar deri në detajin e fundit. Shkrimi i saj ishte thjesht një akt pune fizike.”

Këtë pikëpamje e mbështeti edhe themeluesi i Penguin Books, Sir Allan Lane, i cili tha se gjatë 25 viteve miqësi të ngushtë nuk kishte dëgjuar asnjëherë “klikimin e makinës së saj të shkrimit... pavarësisht sasisë dhe cilësisë mahnitëse që ajo prodhonte vazhdimisht”. Ai tha se, qoftë duke organizuar punën e përditshme të kampit në një ekspeditë në shkretëtirën mesopotamiane apo duke bërë punë dore në mbrëmje,



“ndërsa bënte të gjitha këto gjëra të shumta, ndonjë shfaqje ose roman i ri i Agatha Christie-t po merrte formë në mendjen e saj”.

Ndërsa Christie besonte se një libër mund të përfundohej për tre muaj, ajo thoshte se dramat “është më mirë të shkruhen shpejt”. Në kohën e profilit të BBC-së të vitit 1955 për Christie-n, tri nga shfaqjet e saj po luheshin në West End të Londrës. *The Mousetrap* tashmë po thyente rekorde arkëtimesh, vetëm tre vjet pas premierës së saj. Shfaqja nisi si një dramë radiofonike e BBC-së me titull *Three Blind Mice*, e transmetuar në vitin 1947 si pjesë e një mbrëmjeje programore që festonte 80-vjetorin e Mbretëreshës Mary.

Sipas Christie-t, shkrimi i dramave ishte “shumë më argëtues se shkrimi i librave”. Ajo tha: “Nuk ke pse të shqetësohesh për përshkrime të gjata vendesh dhe njerëzish, apo për të vendosur se si ta shpërndash materialin. Dhe duhet të shkruash mjaft shpejt për të ruajtur gjendjen dhe për ta mbajtur dialogun të rrjedhë natyrshëm.”

Shfaqja me jetëgjatësinë më të madhe në Mbretërinë e Bashkuar

Në vitin 1973, Christie mori pjesë në festimin e 21-vjetorit të *The Mousetrap* në Hotel Savoy të Londrës. I pranishëm ishte edhe protagonistin e saj i parë, Richard Attenborough, i cili parashikoi se ajo “mund të vazhdojë edhe 21 vjet të tjerë”. Ai shtoi: “Nuk do ta vija në të njëjtën kategori me Katedralen e Shën Palit, por sigurisht amerikanët vendosin se gjëja që duhet bërë nëse vijnë në Londër është të shkojnë të shohin *The Mousetrap*.” Pasi u bë shfaqja me shfaqjen më të gjatë në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 1957, e vetmja gjë që mund ta ndalte ishte pandemia e Covid-it në vitin 2020. Në mars 2025, ajo festoi shfaqjen e saj të 30.000-të dhe vazhdon ende të luhet sot.

Attenborough u intervistua gjithashtu në profilin e BBC-së të vitit 1955, ku tha se Christie ishte “pothuajse personi i fundit në botë që do ta mendoje ndonjëherë në lidhje me krimin, dhunën apo diçka që të ngrin gjakun ose dramatike”. Duke përmbledhur misterin e saj të qëndrueshëm, ai tha: “Thjesht nuk e kuptonim dot faktin se kjo zonjë kaq e qetë, e saktë dhe dinjitoze mund të na bënte të na rrëqetëj mishi dhe të magjepste njerëz në mbarë botën me mjeshtërinë e saj të suspansës dhe dhuntinë për të krijuar në skenë dhe në ekran një atmosferë të tillë terrori.”

Ndërsa intervista e Christie-t për BBC-në na jep një vështrim magjepsës mbi metodat e saj të shkrimit – mungesën e një teknike të ngurtë, mbështetjen te imagjinata, kënaqësinë e ndërtimit të subjekteve – enigma e vetë gruas vazhdon të jetojë.

Përkthimi © ExLibris



**Të mërkurën më
datë 28 janar 2026, në ditën
e nëntëdhjetë vjetorit të lindjes
së Kadaresë, hapet platforma
online për shitjen e librave
në gjuhën shqipe
në Amerikën e Veriut**

www.alblibris.al